

Kisha Triumfuese

Një studim me tri pjesë
i shkruar nga
Riçard Vurmbrand
Xhon Pajper
dhe Milton Martin



Originally published in English as *The Triumphant Church*
© 1999 by The Voice of the Martyrs.

©2012 by The Voice of the Martyrs in cooperation with
OM EAST for the Albanian edition.
Translated by permission. All rights reserved.

© 1999 nga Zëri i Martirëve
Për më shumë informacion mbi persekutimin e sotëm të kishës dhe mbi
ndihmën që mund të ofroni, kontaktoni:
The Voice of the Martyrs, Inc.



1

Të përgatitesh për Kishën e Fshehtë

Riçard Vurmbrand





Parathënie

Në kundërshtim me atë që dikush mund të mendojë, ky nuk është ndonjë lloj minimanuali mbi organizimin e disa të krishterëve klandestinë, që janë quajtur kisha e fshehtë. Është thjesht një paraqitje reale e Kishës nga personi, jeta pastorale e të cilit, përvojat e burgut dhe shërbesa gjithëpërfshirëse e lutjes vunë në lëvizje botën mbarë mbi rrezikun e komunizmit ateist. Shkrimet e Riçard Vurmbrandit nuk kanë nevojë për parathënie. Ato janë ta qarta dhe të thella, duke e bërë edhe lexuesin më të rëndomtë të shkundet nga mesazhi që përcjellin. Ka pasur një përpjekje të vogël për të ndërhyrë në këtë dorëshkrim. Disa prej shprehjeve janë karakteristike për një person, që mendon si hebre, lexon si gjuhëtar, lutet si apostull dhe shkruan si profet. Mesazhi është i kthjellët si kristali.

Nëse është e vërtetë, siç pohojnë disa drejtues të krishterë, atëherë herët a vonë Kisha do të vihet përballë dy alternativave: të bëjë kompromis socio-politik me botën jo të krishterë ose të vuajë tërbimin e një hierarkie politiko-fetare ndrydhëse. Në këtë rast, Vurmbrandi ka të drejtë – *Ne duhet të bëhemi gati.*

Meqenëse këto alternativa tanimë kanë pushtuar një pjesë të mirë të botës, nuk ka asnjë arsye të besohet se vendi ku jetojmë nuk do të jetë pjesë e këtij realiteti. Atëherë, si të krishterë, le të



përgatisim veten që tani dhe të sigurohemi që fëmijët tanë të kenë një shembull të qartë për rastet me të cilat do të përballen.

BOTUESI

Të përgatitesh për Kishën e Fshehtë – Tani!

«ATËHERË ANANIA U PËRGJIGJ: “O Zot, nga shumë veta kam dëgjuar për këtë njeri, se sa të këqija u ka bërë shenjtorëve të tu në Jeruzalem.” Por Zoti i tha: “Shko, sepse ai është vegla që kam zgjedhur për ta sjellë emrin tim përpara johebrenjve, mbretërve dhe bijve të Izraelit. *Sepse unë do t’i tregoj atij sa shumë i duhet të vuajë për emrin tim.*”» (Veprat 9:13,15,16).

Për aq njohuri sa kam, nuk di të ekzistojë as edhe një seminar teologjik, shkollë biblike ose universitet në mbarë botën që të ketë në programin e vet një kurs mbi Kishën e Fshehtë. Mund të keni mësuar në seminare mbi Sebalianizmin apo Apolinarianizmin, por me mbarimin e kursit, gjasat më të mëdha janë që t’i keni harruar. Ndoshta s’ka për t’ju rënë kurrë rasti të takoni një sabelian apo apolinarian.

Mësojmë për Kishën Koptike dhe për gjithë sektet e tjera, që ndoshta as që kemi për t’i ndeshur ndonjëherë. Kisha e Fshehtë është kisha e një të tretës së botës, njerëz që as që mund ta kenë kaluar ndonjëherë nëpër mend se do t’i përkisnin kësaj kishe. Kur Amerika ishte përqendruar në skandalin e Uotergeitit, komunizmi pushtoi mbi 50 shtete. Islami dhe humanizmi po fitojnë mjaft fuqi dhe ndikim. Pastorët e krishterë duhet të dinë çfarë është dhe çfarë bën kisha e Fshehtë. Kam folur njëherë më tepër se një orë me një peshkop nga Britania mbi punën e kishës së fshehtë. Në fund, ai u shpreh: «Më fal, por po flisni për hobin

tim; jam shumë i interesuar për arkitekturën e kishës. A mund të më tregosh nëse ndërtesat e kishave të fshehta kanë stile gotike?» Nëse do t'ju tregoja se kush është ky peshkop, nuk do ta besonit se si një njeri me një reputacion kaq të madh mund të bëjë një pyetje të tillë!

Kisha e fshehtë është relativisht e panjohur. E kemi kaq afër, por nuk jemi gati të bëhemi pjesë e saj, nuk jemi të përgatitur për të. Çdo pastor i krishterë sot e sheh botën si të ishte famullia e vet, dhe duhet të jemi të ndërgjegjshëm për këtë, ndërsa përpara kemi rrezikun e përballjes me situata tragjike.

Edhe nëse nuk kalojmë vetë rrethana tragjike, e kemi për detyrë të ndihmojmë dhe të mësojmë ata që kalojnë përmes tyre. Në kombet myslimane, në Kinën Komuniste dhe më tej, shumë besimtarë janë viktimizuar. Shumicën prej tyre i kanë burgosur dhe një numër i konsiderueshëm kanë vdekur nëpër burgje. Por s'mund të jemi krenarë për këtë. Gjëja më e mirë do të ishte të mësonim se si të punonim në fshehtësi në mënyrë që të mos na burgosnin.

Në luftë, më shumë admirohen ata që shkaktojnë vdekjen e armikut sesa ata që vdesin për atdheun. Nuk jam *Unë* ai që duhet të vdesë për atdheun *tim*; ai duhet të vdesë për *të vetin*. I admiroj shumë ata që punojnë me aq kujdes sa nuk kapen rob. Duhet të dimë mbi punën që bëhet në fshehtësi.

Të përgatitesh për të vuajtur

Vuajtja nuk mund të shmanget nga Kisha e Fshehtë, pavarësisht masave që merren, por ajo mund të pakësohet në minimum. Është e pamundur të japësh mësim mbi kishën e fshehtë përmes një kursi të vetëm. Dua t'ju nxis t'i kërkonti pleqësisë apo denominacionit tuaj për të dhënë kurse mbi Kishën e Fshehtë. Çfarë ndodh kur një qeveri tiranike merr pushtetin e një vendi? Në disa vende terrori fillon menjëherë, si në Mozambik dhe Kamboxhia. Në disa të tjerë nis me lirinë e besimit si kurrë më parë. Dhe kështu fillon. Disa regjime vijnë në pushtet duke mos pasur pushtet të vërtetë, sepse nuk e kanë popullin me vete. Është koha kur ende nuk e kanë

organizuar as policinë apo ushtrinë. Në Rusi, komunistët i dhanë liri të madhe kishës protestante me qëllim që të shkatërronte atë ortodokse.

Pasi shkatërruan Kishën Ortodokse, atëherë iu kthyen protestantëve. Situata e fillimit nuk zgjat përgjithmonë. Gjatë kësaj kohe ata depërtuan nëpër kisha, duke vendosur njerëzit e tyre në udhëheqësi. Ata zbulojnë dobësitë e pastorëve. Disa mund të jenë njerëz ambicioz, të tjerë mund të zihen në kurth nga lakmia për para. Dikush mund të ketë ndonjë mëkat të fshehur për të cilin i bëhet shantazh duke i thënë se do ta bëjnë publik në rast se nuk futen njerëzit e tyre në udhëheqësi.

Atëherë, në një moment të caktuar fillon persekutimi. Në Rumani, një shtrëngesë e tillë ndodhi brenda një dite. Të gjithë peshkopët katolikë i burgosën së bashku me një numër të pafund priftërinjsh, murgjish dhe murgeshash. Pastaj u arrestuan shumë pastorë protestantë nga të gjitha denominacionet. Shumë prej tyre vdiqën në burg. Jezusi, Zoti ynë, i tha Ananias: «Tako Saulin e Tarsit. Ai do të bëhet pastori im i fshehtë, punëtori im i fshehtë. Dhe kështu ishte Pali – pastor i një kisha të fshehtë. Jezusi nisi kështu një kurs intesiv për këtë pastor të fshehtë. Ai e filloi me fjalët: «Do t'i tregoj atij sa shumë i duhet të vuajë...»

Përgatitja për punën e fshehtë nis me studimin e vuajtjeologjisë dhe martirologjisë. Në librin e vet, «*Gulag Archipelago*», Solzhenicini tregon se oficerët e policisë në Bashkimin Sovjetik kalonin përmes një kursi të arrestologjisë – shkenca e arrestimit të njerëzve në mënyrë të fshehtë e të pazbulueshme nga të tjerët. Nëse ata kanë krijuar një emërtim të ri, arrestologji, atëherë le të krijojmë edhe ne emërtimin *vuajtjeologji*. Më poshtë do të shohim anën teknike të punës së fshehtë, por si fillim është e nevojshme një lloj përgatitje shpirtërore. Në vendet e lira, mjafton që thjesht të besosh dhe të pagëzohesh për të qenë anëtar i një kisha. Por kjo nuk mjafton që të bëhesh anëtar në kishën e fshehtë. Mund të pagëzohesh dhe të besosh, por nuk do të jesh anëtar i kishës së fshehtë nëse nuk e njeh vuajtjen. Mund të kesh besimin më të madh në botë, por nëse nuk je i përgatitur për të vuajtur, atëherë do të kapesh nga policia. Vetëm dy shuplaka do të mjaftonin që të

hapje gojën, ndaj përgatitja për vuajtje është një prej elementëve të domosdoshëm në përgatitjen për punën e fshehtë.

Një të krishterë nuk e kap paniku nëse burgoset. Për besimtarin e thjeshtë burgu është veç një vend i ri për të dëshmuar për Krishtin.

Për pastorin burgu është një famulli e re; një famulli pa të ardhura financiare, por me mundësi të shumta për punë. Kam folur pak për këtë në librin tim «Me Zotin në Izolim.» Në libra të tjerë kam përmendur kodin Mors, që është një pjesë e trajnimit për Kishën e Fshehtë. Besoj se e dini ç'është – një kod për të dërguar mesazhe. Përmes këtij kodi mund t'u predikosh ungjillin njerëzve që janë rreth e rrotull teje. Të burgosurit ndryshojnë përherë. Disa dalin nga qelia e të tjerë futen brenda. Zoti u ka dhënë shumë të krishterëve të burgosur privilegjin që të sjellin te Krishti, përmes kodit Mors, njerëz që nuk i kanë parë asnjëherë. Midis tyre ka shumë raste, që pas shumë vjetësh, të kenë takuar njerëzit që i kishin sjellë në Krishtin përmes kodit Mors. Ka pasur mjaft raste kur qelitë ku kam qëndruar janë kthyer në kishëza. Në kishat e botës së lirë, gjatë së dielës në mëngjes bie këmbana për të lajmëruar njerëzit. Nëse ndonjëri ka dëshirë të vijë, ai vjen në kishë – nëse nuk ka dëshirë, nuk vjen. Nëse ndonjëri nuk e pëlqen predikimin tënd këtë të Dielë, të dielën tjetër ai nuk vjen. Po ra shi, është e sigurtë se ai nuk do të vijë në kishë. Por, nëse burgu është kisha jote, anëtarët e saj do të jenë me ty gjatë gjithë kohës. Anëtarët e lirë të një kisha shohin orën dhe thonë: «Deri tani ka predikuar për tridhjetë minuta. A ka për ta mbaruar ndonjëherë?» Kur arrestohesh të merren edhe orët; kështu që anëtarët e kishës-qeli do të jenë me ty gjithë javën dhe mund t'u predikosh nga mëngjesi në darkë! Ata s'kanë tjetër zgjedhje. Asnjëherë nuk ka patur në historinë e Kishës Rumune apo Ruse, më shumë të kthyer në Krishtin, sesa ata që janë kthyer përmes burgut. Ndaj mos iu frikësoni burgut! Shihni përtej tij, si një detyrë e re të ngarkuar nga Perëndia. Kur më arrestuan për herë të dytë, ndërsa po përqafoheshim me gruan para se policët të më merrnin, ajo më tha: «Riçard, kujto që është shkruar: “Do të sillësh para krerëve dhe mbretërve për të qenë dëshmi për ta.”»

Kjo mund të duket e pranueshme për çdo njeri. Po për torturat e tmerrshme që u shkaktohen të burgosurve? Çfarë mund të bëjmë për këto? A do të mundemi t'i durojmë? Dhe, nëse nuk do të mundem të rezistoj, atëherë unë do të shkaktoj burgosjen e pesëdhjetë a gjashtëdhjetë njerëzve të tjerë që njoh, sepse kjo është ajo që tirani dëshiron nga unë, të tradhtoj njerëzit rreth meje. Kështu që lind nevoja e domosdoshme të përgatitesh për vuajtjen, që duhet të fillojë tani. *Është shumë e vështirë* ta përgatisësh veten për një gjë të tillë ndërkohë që ndodhesh në burg. Mbjaj mend një rast në Rumani me një pastor që shërbente prej 20 vjetësh, i cili kishte mëkatuar duke shkuar me një grua. Pastorët e tjerë debatuan në lidhje me këtë çështje. U tha se; «Mëkati i tij nuk kishte të bënte shumë me atë që kishte ndodhur atë mbrëmje; rrethanat kishin qenë të tilla sa ai nuk kishte mundur t'i rezistonte tundimit. Por çështja qëndronte në atë që kishte ndodhur njëzetë vjet më parë, kur ai nuk i kishte thënë vetes: “Gjatë jetës sime pastorale do të më ndodhin shumë gjëra. Midis të tjerash, do të ndodhë që të tundohem nga mëkati seksual. Unë nuk kam për ta bërë atë mëkat.”» Duhet ta përgatisni veten para kohe për *gjithçka* që mund të rastisë. Duhet të *përgatitemi* për të vuajtur.

E vërteta mbi Të vërtetën

Shkalla e vuajtjes së dikujt varet nga lidhja që ka ai me kauzën e vet, sa domethënëse dhe sa e shtrenjtë është për të. Në lidhje me këtë kanë ndodhur çudira të mëdha në vendet komuniste. Kanë qenë predikues dhe shkrimtarë të krishterë ata, që janë kthyer në tradhtarë. Kompozitori i himneve më të mira në Rumani u kthye në kompozitorin e himneve më të mira komuniste të vendit. Gjithçka varet nëse kemi mbetur veç në sferën e fjalëve apo jemi bërë një me realitetin hyjnor. Zoti është e Vërteta. Bibla është e vërteta mbi Të vërtetën. Teologjia është e vërteta mbi të vërtetën e së vërtetës. Një predikim i mirë është e vërteta mbi të vërtetën e së vërtetës për të Vërtetën. Nuk është e Vërteta. E vërteta është vetëm Zoti. Rreth kësaj të Vërtete ka një konstruksion të tërë fjalësh, teologjish dhe interpretimesh. Por asnjë prej tyre nuk mund të të

vijë në ndihmë në kohë vuajtjesh. Vetëm e Vërteta të ndihmon, ndaj është e domosdoshme që të shkojmë përtej predikimeve, librave teologjikë dhe gjithçkaje tjetër në kuadrin e «fjalëve» e të kapemi fort pas realitetit të Vetë Zotit. U kam treguar njerëzve në Perëndim se si të krishterët lidheshin në kryq dhe mbaheshin ashtu për katër ditë e katër net rresht. Kryqet vendoseshin në dysheme dhe të burgosurit e tjerë ishin të detyruar të kryenin nevojat e tyre personale mbi fytyrat dhe trupat e atyre që ishin kryqëzuar. Kur më kanë pyetur më pas: «Çfarë vargu i Biblës të ka mbajtur të fortë në të tilla rrethana?», – përgjigjja ime ka qenë dhe është «*Asnjë* varg biblik nuk mund të më ndihmonte.» Është hipokrizi e hapur fetare të thuash, «Ky varg nga Bibla më ka dhënë forcë, ose ky varg biblik më ka ndihmuar.» Vetëm vargjet biblike nuk të ndihmojnë. E njohim Psalmin 23: «Zoti është bariu im; Nuk do të më mungojë asgjë... edhe nëse eci në luginën e hijes së vdekjes...»

Kur kalon përmes vuajtjeve kupton se Psalmi 23 nuk është paracaktuar nga Perëndia për të të forcuar. Perëndia mund të të forcojë, jo psalmi që flet për atë që bën Perëndia. Nuk është e mjaftueshme të kesh një psalm. Duhet të kesh Atë për të cilin flet psalmi. Dimë edhe atë vargun, «Hiri im të mjafton.» (2 Korintasve 12:9). Por vetëm vargu nuk është i mjaftueshëm. Është hiri që mjafton dhe jo vargu. Pastorët dhe dëshmitarët e zellshëm që e trajtojnë Fjalën si një thirrje nga Zoti, rrezikojnë tu japin fjalëve të shenjta më shumë vlerë nga ç'kanë në të vërtetë. Fjalët e shenjta janë vetëm domethënia për të arritur realitetin që shprehet përmes tyre. Nëse je i bashkuar me këtë realitet, Zotin e Plotfuqishëm, i ligu humbet fuqinë mbi ty, sepse nuk mund të përballet me Zotin e Gjithëfuqishëm. Nëse mbahesh vetëm nga fjalët e Zotit të plotfuqishëm, shumë shpejt dhe lehtësisht ke për t'u thyer.

Ushtrime shpirtërore

Përgatitja për punën e fshehtë është ushtrim i thellë shpirtëror. Ashtu si e qërojmë një qepë për ta përgatitur për gatim, ashtu dhe Zoti duhet të «qërojë» prej nesh ato që janë thjesht fjalë, ndjesitë e kënaqësive tona në fe, në mënyrë që të arrijmë në realitetin e besimit

tonë. Jezusi na ka thënë se, «Kushdo që dëshiron ta ndjekë, duhet të marrë kryqin e vet.» Dhe vetë Jezusi e tregoi sa i rëndë ishte ky kryq! Ndaj duhet të përgatitemi për një gjë të tillë. Vini re mënyrën që përdor bota! Një revistë pornografike ose një reklamë mund të na ndezë imagjinatën. Në po të njëjtën mënyrë, ne duhet të nxisim imagjinatën duke pasur para vetes realitetin shpirtëror.

Duhet të bëjmë ushtrime shpirtërore. Sa keq më vjen që ushtrimet shpirtërore janë gati të panjohura për protestanizmin. Duhet t'i vëmë në jetë ato në Kishën e Fshehtë. Ushtrimet shpirtërore duhet të jenë keqpërdorur nga Kisha Katolike përderisa lindi Reformimi. Ka gjithmonë një lëvizje lavjerrësi. Nëse njëri bie në njërin ekstrem, tjetri do të ekuilibrojë duke rënë në ekstremin tjetër.

Ngaqë disa kanë abuzuar në përdorimin e ushtrimeve të rreme shpirtërore, të tjerët as që u janë afruar këtyre ushtrimeve. Nuk duhet të kemi vetëm momentet e lutjes gjatë të cilave flasim, por duhet të kemi edhe momentet e meditimit dhe soditjes shpirtërore. Mund të lexojmë te Hebrenjve 11 një listë të gjatë të atyre që janë sharruar copë e çikë, djegur në turrën e druve dhe gllabëruar nga luanët, por është e nevojshme që këto gjëra edhe të përfytyrohen me sytë e imagjinatës. Ja, gjendem para luanëve, jam i rrahur, jam gati të digjem, etj. Si duhet të sillem në këtë situatë?

Mbaj mend orën e fundit të shkollës së të dielës para se të largohesha nga Rumania. Mëngjesin e së dielës, mora një grup 10-15 djemsh dhe vajzash dhe e çova jo në kishë, por në kopshtin zoologjik. Kur u gjendëm para kafazit të luanëve u tregova: «Paraardhësit tuaj në besim i kanë hedhur para këtyre bishave të egra për shkak të besimit të tyre. Duhet të dini që edhe ju do të vuani një ditë. Nuk do t'ju hedhin para luanëve, por do të duhet të vuani në duart e njerëzve që janë më të këqij se vetë luanët. Vendosi këtu dhe tani nëse doni t'i qëndroni besnik Krishtit.» Ata kishin lot në sytë e tyre kur thanë «Po.»


Duhet të përgatitemi tani, përpara se të burgosemi. Në burg humbet gjithçka. Edhe rrobat e trupit, të cilat zëvendësohen me uniformën e të burgosurit. Nuk ka mobilje të mira, tapete të bukur apo perde të mira. As gruan nuk e ke pranë dhe as fëmijët e tu. Nuk ke as bibliotekë dhe s'mund të shohësh as një lule. S'mbetet

asgjë nga ajo që e bën jetën të bukur. Askush nuk do të mund të rezistojë, nëse nuk ka i ka braktisur që më parë kënaqësitë e jetës. Është një varg te Kolosianëve mbi vdekjen e gjymtyrëve, që veprojnë mbi tokë. Katolikë të paditur dhe të zellshëm kanë imponuar disa besëtytni dhe ndëshkime të vetvetes. Ndërkohë që protestantët kanë hequr tërësisht dorë nga sakrifikimi. Por është një lloj sakrifice e krishterë, «të heqësh dorë» nga gëzimet e botës. I krishteri që përgatitet tani nuk do ta ndiejë mungesën e këtyre gjërave kur të futet në burg. Duhet t'i përdorësh gjërat e kësaj bote, por të mos lidhesh pas tyre. Personalisht përdor këtë ushtrim. Tani jetoj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. A mund ta imagjinoni si duket një supermarket amerikan? Aty mund të gjeni gjithçka që ju pëlqen. I kaloj me sy të gjitha dhe i them vetes: «Mund të bëj pa këtë apo pa atë; kjo është shumë e mirë, por mund të bëj edhe pa të, edhe pa këtë tjetrën.» Sapo kalova përmes gjithë supermarketit dhe nuk shpenzova as edhe një dollar të vetëm. Kam ndjesinë e të parit të shumë gjërave të bukura, por edhe gëzimin e të diturit që mund të bëj edhe pa to.

Ne kemi patur edhe teologë modernë liberalë, por asnjë prej tyre nuk i ka rezistuar qoftë një torture të vetme. «Pse duhet të vdes për një Zot të vdekur dhe një Bibël problematike? Po nëse historia e Adamit dhe Evës nuk është e vërtetë, nëse Jozueu nuk e ndali diellin, nëse profecitë janë shkruar shumë vite më vonë pasi ishin përmbushur, nëse Jezusi nuk u lind nga një virgjëreshë dhe nuk u ringjall trupërisht prej së vdekurish – atëherë ka më shumë gënjeshtër në Bibël se në gazetën sovjetike “Pravda”. Pse duhet të vdes për një gjë që s’është e vërtetë ose së paku mbetet problematike?»

Dyshimi krijon tradhtarë

Unë jam hebre. Në hebraisht, në gjuhën që Jezusi foli dhe me të cilën është dhënë zbulesa e parë, fjala «dyshim» nuk ekziston. Të dyshosh është po aq e gabuar sa ta bësh një njeri të ecë me katër këmbë – ai nuk është bërë për të ecur me katër këmbë. Një njeri ecën drejt; ai nuk është bishë. Të dyshosh nuk është njerëzore.



Për secilin nga ne vjen dyshimi, por mos lejo që dyshimet për doktrinën thelbësore të Biblës – si ekzistenca e Zotit, ringjallja e Jezu Krishtit ose ekzistenca e jetës së përjetshme – të të bëjnë fole në mendje. Çdo dyshim teologjik apo filozofik rrezikon të të kthejë në tradhtar. Ti fillon t'i lejosh vetes dyshime gjatë një studimi cilësor, përgatitjes së një predikimi, gjatë një vakti të shijshëm apo të shkruarit të një libri. Pastaj u lë vend gjithfarëlloj dyshimesh apo idesh të rrezikshme në veten tënde. Dhe kur të torturohesh, dyshimet kthehen në tradhti, sepse duhet të vendosësh nëse do të jetosh ose të vdesësh për këtë besim. Një prej gjërave më të rëndësishme mbi përgatitjen shpirtërore të një punëtori të fshehtë është zgjidhja e dyshimeve të tij. Në matematikë, nëse nuk e gjen zgjidhjen e një ushtrimi, patjetër që ke gabuar diku, ndaj vazhdon derisa të gjesësh gabimin. Mos jeto me dyshimet, por kërko zgjidhjen e tyre!

Prova e Torturës

Tani të vijmë te momenti i vërtetë i torturës. Tortura është diçka shumë e dhimbshme. Torturuesit përdorin hekur të skuqur. Ndonjëherë është thjesht rrahje. Të gjithë, kemi ngrënë ndonjë shuplakë kur kemi qenë fëmijë dhe rrahja mund të krahasohet me këtë. Një rrahje e thjeshtë mund të durohet. Jezusi ka thënë se duhet të shkojmë tek Ai si fëmijë, gjë që nënkupton pak a shumë se je kandidat edhe për t'u disiplinuar. Njëherë, një mjeke erdhi tek unë dhe më pyeti: «Çfarë të bëj? Më vjen të hidhem nga dritarja. Ata nuk po reshtin së telefonuari, dhe duan që unë të bëhem informatorja e tyre për kishën e fshehtë. Më kërcënuan se do më rrihnin nëse nuk pranoja. Çfarë të bëj? Është e tmerrshme të mendosh se mund të bie në duart e tyre. S'mund ta duroj. Dy alternativa kam; ose të bëhem informatorja e tyre ose të hidhem nga dritarja.» Dhe unë i thashë: «Ke një alternativë tjetër. Jepi burrit një shkop dhe kërkoji të të rrahë paq dhe atëherë do ta kuptosh se sa mund të mbash.» Mos kini frikë nga të rrahurit! Gjithsesi, me ne, komunistët nuk u mjaftuan me të rrahurat – ata përdorën tortura shumë të rafinuara. Torturat mund të funksionojë

në të dy kahet. Ka hajdutë, që u rezistojnë të gjitha torturave dhe nuk do t'i tradhtonin në asnjë rast bashkëpunorët e tyre. Sa më shumë t'i rrahësh, aq më shumë kokëfortë bëhen ata. Ose tortura mund të të thyejë vendosmërinë. Më lini t'ju tregoj një prej rasteve shumë interesante, që është publikuar në shtypin komunist çek.

Nën regjimin e Dubçekut, për shkak të lirimit të disa masave, në Çekosllovakia mund të publikoheshin disa lloj artikujsh. Atë kohë u botua ky artikull. Novotni, i cili ishte diktator komunist, paraardhësi i Dubçekut, kishte arrestuar njërin prej miqve të tij më të ngushtë, një ateist të bindur dhe anëtar të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste. (Jo vetëm të krishterët, hebrenjtë apo patriotët ishin në burg. Komunistët arrestuan edhe shokët e tyre dhe i torturuan po aq sa armiqtë e tyre të betuar.). Ata e arrestuan këtë udhëheqës komunist dhe e vunë vetëm në qelinë e burgut. Instaluan rreze elektromagnetike, të dëmshme për trurin, që të kalonin përmes qelisë së tij. Një altoparlant përsëriste ditë e natë: «E ke emrin Jozef apo nuk e ke Jozef?» (Ai nuk quhej Jozef) «Mendoje mirë. E ke emrin Jozef apo nuk e ke Jozef? Krimineli më i madh në Amerikë quhej Dillinger, por ti je më i madh se ai. Atëherë, si e ke emrin? E ke emrin Jozef apo nuk e ke Jozef? Ti je një kundërrevolucionar, je një spiun, por a e ke emrin Jozef apo nuk e ke Jozef?» Gjithë përpjekja e tyre ishte që ta çmendnin. Ditën dhe natën. Arriti në kufirin sa të humbiste mendjen. Në një çast, diçka i ndriçoi mendjen. «Tani kam takuar të ligun. Nëse komunistët torturojnë një të krishterë, nuk është aspak ligësi, sepse komunistët besojnë se do të ndërtojnë parajsën në tokë. Të krishterët i pengojnë, ndaj është e drejtë t'i torturosh. Por, kur një komunist torturon një komunist tjetër, atëherë është torturë për hir të torturës. Dhe për këtë, nuk ka asnjë justifikim. Por prit pak! Çdo monedhë ka dy anë, çdo kablo elektrike ka dy pole. Nëse ekziston një i lig i paepur, atëherë kundër kujt po lufton ai?. Duhet të ekzistojë një e mirë e paepur. Ky është Perëndia dhe ata luftojnë kundër Tij.»

Kur u thirr në hetuesi, ai hyri duke buzëqeshur dhe u tha atyre ta hiqnin altoparlantin, sepse ia kishin arritur qëllimit. «Jam bërë i krishterë.» Oficeri e pyeti, «Si ndodhi?» Dhe ai i tregoi të gjithë

historinë. Atëherë oficeri tha: «Prit pak!» Thirri disa prej shokëve të tij dhe tha: «Të lutem, përsërite këtë histori para shokëve.» Ai e përsëriti dhe kapiteni iu kthye njërit prej oficerëve, «Të thashë që kjo metodë nuk do të funksionojë. E keni tepruar.»

Djalli nuk është i gjithëpushtetshëm dhe i gjithëdijshëm si Zoti. Ai bën gabime. Torturat e dëmshme janë teprim, që mund të ndikojnë shumë mirë shpirtërisht.

Momenti i krizave

Tortura ka një moment shpërthimi dhe torturuesi pret pikërisht këtë moment kritik. Mëso si të mposhtësh dyshimin dhe të mendosh drejt. Vjen gjithmonë një çast kur je i gatshëm të shkruash a të pohosh emrin e bashkëpunëtorit tënd në kishën e fshehtë apo të tregosh ku është vendi sekret, ku printohen materialet apo gjëra të këtij lloji. Aq shumë të kanë torturuar sa asgjë tjetër nuk ka më rëndësi, vetëm të shpëtosh nga dhimbja. Por kur e di që mund të kesh ende energji dhe forcë për ta kaluar këtë moment krize, një ndjenjë e brendshme gëzimi të jep jetë. Është momenti kur kupton se Krishti ka qenë pranë teje në këtë çast vendimtar. Rojet e burgjeve në ditët e sotme janë të mirëtrajnuar dhe shumë të rafinuara, të vetëdijshëm për këtë moment krize. Nëse nuk nxjerrin asgjë nga ti në atë moment, atëherë ata e braktisin torturën, sepse e dinë që nuk ka më vlerë të vazhdosh. Më kanë thënë kur isha i krishterë në hapat e parë se duhej të lexoja çdo ditë; e kam praktikuar këtë edhe me tim bir, Mihain, që kur ai ishte 3-4 vjeç duke i lexuar nga një faqe nga Bibla dhe jeta e ndonjë shenjtori a martiri të krishterë. I kam lexuar «*Foxe's Book of Martyrs*», gjë që jua këshilloj për fëmijët tuaj. Mësojini si fitojnë martirët mbi momentet e krizës.

Janë edhe disa çaste të tjera në lidhje me torturën. Është e rëndësishme të kuptosh çfarë ka thënë Jezusi: «Mos u shqetësoni për të nersërmën, sepse e nesërmja do të shqetësohet vetë për veten» (Mateu 6:34). Kam kaluar katërmbëdhjetë vite në burg. Vëlla Hrapovi ka kaluar njëzet e gjashtë, Uong Ming-Dao ka qenë për njëzet e tetë vjet në burg. Duket e pamundur të durosh

kaq vite në burg. Nuk po të kërkohet të durosh gjithë këtë kohë njëherësh. Madje, as edhe një ditë të tërë—por një orë të vetme po. Një orë dhimbjesh çdokush mund ta durojë. Kemi pasur raste me dhimbje dhëmballe, aksident me makinë apo një situatë ankthi të patreguar. Nuk je destinuar që të durosh dhimbje më shumë se në këtë moment. Ajo që e bën dhimbjen më të madhe dhe të rëndë është kujtimi që jam rrahur dhe torturuar aq herë dhe se, kur të vijë dita e nesërme, çdo gjë do të fillojë nga e para e kështu çdo ditë me radhë. Nesër ndoshta mund të mos jem më gjallë, ose ndoshta as ata, torturuesit, nuk do të jenë gjallë. E nesërmja mund të vijë me një përmbysje, ashtu siç ndodhi edhe në Rumani. Të rrahurat e një dite të mëparshme kanë shkuar, tortura e së nesërme nuk ka mbërritur ende. Unë jam bërë tanimë profesor në torturologji. Si fillim, tortura është një traumë e tmerrshme me dhimbje të padurueshme. Por nuk vazhdon kështu. Kardinal Mindcentin nuk e lejuan të flinte për njëzet e nëntë ditë dhe net rresht. Pas kësaj, ai pohoi gjithçka për të cilën u pyet. Atëherë, çfarë ndodhi? Pas disa ditësh dhe netësh pa gjumë ose pas disa ditësh torturash të rënda intensive vjen një moment kur asgjë tjetër nuk ka më rëndësi për ty. Harron përgjegjësitë e tua karshi gruas dhe fëmijëve të tu, karshi emrit tënd të mirë dhe vetë Perëndisë. Kthehesh në një person krejtësisht indiferent mbi gjithçka që ekziston. Ky është momenti i krizës kur ti ke nevojë vetëm të marrësh frymë pa dhimbje. Ushtrohu të marrësh frymë siç duhet.

Arti i frymëmarrjes ka një domethënie të veçantë në fenë Hindu dhe Budiste ndërsa praktikojnë Yoga. Le të shohim në Bibël mbi mënyra të ndryshme frymëmarrjeje. Jezusi «Fryu – u dha frymë» apostujve. Jezusi fryu mbi ta Frymën e Shenjtë. E pra, ja ku është një mënyrë e veçantë frymënxjerrje që përçon Frymën e Shenjtë. Në kishën Ortodokse gjatë pagëzimit, prifti dhe kumbarët «fryjnë» tri herë mbi fëmijën. Kur Jezusi nxori frymë, Ai kishte në të Frymën e Shenjtë. Është shkruar në Veprat 9 që Sauli shfrynte «kërcënime dhe kërdi.» Ka vrasës në frymën e të cilëve përçohet krim. Është shkruar në librin e profetit Jeremia mbi ata «që turfullojnë pas grave të të tjerëve.» Është fryma e tradhtisë. Ka një frymë të një lloji tjetër, që përçon emocione të forta. Provo

të përballësh me dikë tjetër, ndërsa po merr frymë qetësisht, në mënyrë ritmike dhe të thellë. Do ta shohësh që është e pamundur të grindesh. Të marrësh frymë siç duhet është një prej mënyrave për t'u rezistuar torturave. Tradhti do të thotë thyerje me të gjithë kishën. Je një i krishterë në të cilin Perëndia dhe shumë të tjerë kanë vënë besimin. Të janë besuar sekretet e kishës së fshehtë. Tradhtia është emocion i fuqishëm. Ti nuk mund të grindesh me dikë dhe t'i bërtasësh atij nëse po merr frymë në mënyrë ritmike dhe të thellë. Madje, nuk mund të kalosh as përmes një emocioni të fuqishëm si tradhtia nëse e ruan frymëmarrjen me të njëjtin ritëm. Nën torturë, mbushu me frymë ndryshe nga si merr frymë një tradhtar. Përpiqu të marrësh frymë ritmiksht, qetësisht, aq thellësisht sa të të përshkojë të tërin. Oksigjeni të jep rezistencë në të gjithë trupin, gjë që ekuilibron veprimet dhe të jep një qëndrim drejtpeshimi. Një gjë tjetër që një punëtor i kishës së fshehtë duhet ta ketë të qartë jo vetëm në mendje, por deri edhe në majën e thoit, është se i përket trupit të Krishtit. Ai i përket një trupi, që është fshikulluar për gati 2000 vjet. Dhe përherë është fshikulluar, jo vetëm në Golgotë, por edhe nën perandoritë romake dhe nga shumë persekutues të tjerë. Është përndjekur në kohën e nazistëve, si edhe në Rusi për më shumë se shtatëdhjetë vjet. Kur u bëra i krishterë, isha i vetëdijshëm se isha pjesë e një trupi të fshikulluar; të tallur, të nëpërkëmbur; të kurorëzuar me kurora me gjemba, me gozhda të ngulura në këmbë e duar. Dhe e pranova këtë si një të ardhme të mundshme të jetës sime. Nuk mund ta mendoj kurrë që vetëm Jezus Krishti do të kryqëzohej 2000 vjet më parë. Vuajtjet e Jezusit në trupin e tij mistik duhej të ishin realitet edhe tek unë.

Dashuri e Epërme

Bibla na mëson disa fjalë shumë të rënda për të marrë mbi vete: «Ai që e do të atin ose nënën më shumë se mua, nuk është i denjë për mua; dhe ai që e do birin ose bijën më shumë se mua, nuk është i denjë për mua.» (Mateu 10:37). Këto fjalë gati nuk kanë asnjë kuptim në vendet e lira.

Ndoshta keni dëgjuar përmes literaturës së Zërit të Martirëve që mijëra fëmijë janë marrë nga gjiri i prindërve të tyre në ish-Bashkimin Sovjetik, sepse u mësonin mbi Krishtin. Duhet ta doni Krishtin më shumë se familjen që keni. Dhe ja ku mund të jeni në një gjyq, ku gjykatësi ju vë përballë dilemës se, nëse mohon Krishtin do të mund të mbash fëmijët. Në të kundërt, është hera e fundit që i sheh me sy. Zemra mund të të shqyhet vendit, por përgjigja duhet të jetë «Unë dua Perëndinë.»

Nadia Sloboda u burgos për katër vjet. Asaj ia morën fëmijët, por ajo u largua nga shtëpia e saj duke kënduar. Fëmijët, të cilët ishin të detyruar të prisnin kamionin t'i merrte nën mbikëqyrjen e policisë i thanë: «Mos u shqetëso për ne! Kudo që të na çojnë nuk kemi për ta braktisur besimin tonë.» Dhe kështu bënë. Kur Jezusi ishte në kryq, ai nuk vuajti vetëm fizikisht, para vetes pati nënën e tij që po vuante. Dhe e ëma kishte para të birin që po vuante. Ata e donin shumë njëri tjetrin, por aty, në atë kryq, ishte edhe lavdia e Perëndisë, ndaj edhe çdo ndjenjë njerëzore kalon në plan të dytë. Vetëm kur kemi një qëndrim të tillë mund të bëhemi pjesë e shërbesës së fshehtë. Vetëm Krishti, Vuajtësi i madh, Njeriu i Dhimbjes, duhet të jetojë në ne. Ka pasur raste në vendet komuniste, kur torturuesit komunistë kanë flakur tutje shkopinjtë e gomës me të cilët kanë rrahur për vdekje të krishterët duke pyetur: «Çfarë është ajo kurorë drite që ke mbi kokë? Çfarë është kjo që të ndriçon fytyrën? S'mundem më të të rrah.» Tregohet në Bibël për Stefanin që «fytyra e tij shkëlqente.» Dimë raste të torturuesve komunistë, që u kanë thënë të burgosurve të tyre: «Bërtit, ulërij me të madhe sikur po të rrah që shokët e mi të mendojnë se po e bëj, sepse nuk mundem të vë dorë mbi ty.»

Ndaj edhe do të të duhet të bërtasësh pa të ndodhur gjë. Megjithatë, ka pasur raste kur të burgosurit janë torturuar keqas, për vdekje. Duhet të zgjedhësh midis vdekjes për Krishtin dhe me Krishtin ose tradhtisë. Por çfarë vlere do kishte të vazhdoje të jetoje nëse do të të vinte turp nga vetja kur të shihesh në pasqyrë, pasi do shihje fytyrën e një tradhtari?

Kjo mënyrë të menduari është gjëja e parë e nevojshme e një punëtori të fshehtë, sidomos për një pastor të shërbesës së fshehtë

-dhe akoma edhe më e rëndësishme për një grua pastori të fshehtë. Ajo luan një rol të jashtëzakonshëm. Ajo duhet t'i japë kurajo dhe forcë që ai të përballojë gjithçka. Nëse e ka mendjen te kinemaja apo kënaqësi të tjera të jetës, ai nuk mundet të jetë në pozicionin e drejtë si luftëtar i kishës së fshehtë. Ajo duhet ta inkurajojë të shërbejë, të luftojë dhe sakrifikojë veten.

Mëso të jesh i heshtur

Gjëja tjetër që duhet të mësojmë në Kishën e Fshehtë është të jesh i heshtur. Pastorët, edhe për shkak të profilit të tyre, janë njerëz muhabetçinj. Por nuk është e thënë që një pastor të flasë gjithë kohën. Askush nuk mund të predikojë mirë nëse të paktën nuk dëgjon mirë. Kur kthej kokën pas në shërbesën time me njerëzit, shoh se kam fituar më shumë shpirta duke i dëgjuar sesa duke u folur vetë. Njerëzit kanë shumë barrë në zemrat e tyre dhe s'ka asnjë që t'i dëgjojë me durim. Madje, as bashkëshorti a bashkëshortja dhe fëmijët tuaj nuk kanë durim t'ju dëgjojnë. S'ka asnjë që të mund t'ju dëgjojë. Nëse dikush gjen dikë që ta dëgjojë, ai fitohet pa shumë fjalë. Heshtja në kishën e fshehtë është një prej rregullave të para.

Çdo fjalë e tepërt që mund të thuash mund ta çojë dikë në burg. Një miku im, një kompozitor i njohur i krishterë, u burgos për shkak të krishterëve të tjerë, që e kishin për zakon të thoshin: «Sa e bukur është kjo kënga e kompozuar nga vëlla...» Ata e lavdëronin për talentin e tij, por pikërisht për këtë ai u burgos për 15 vjet. Këndoje këngën, por nuk ke pse të përmendësh emrin e atij që e ka shkruar. Nuk mund të mësosh të jesh i heshtur në momentin kur vendi pushtohet. Duhet të mësosh të jesh i heshtur që në çastin e kthimit tënd në besim. Një i krishterë është një njeri që flet pak, por fjala e të cilit ka peshë. Ai mendon para se ta thotë fjalën, nëse është e dëmshme apo jo. Në Kishën e Fshehtë, çdo fjalë e tepërt mund të jetë e dëmshme.

Solzhenicini, Fituesi i Çmimit Nobel, tha në një intervistë se personi që e kishte persekutuar dhe dënuar më shumë kishte qenë ish-gruaja e tij. Është shkruar në librin e Predikuesit të mos i

tregosh sekretet e zemrës, madje as gruas tënde. Kjo është Fjala e Perëndisë. Perëndia e ka ditur që do të ishte një Kishë e Fshehtë dhe ai e di që në një moment të caktuar, gruaja mund të irritohet kundër teje. Sekretarja e Solzhenicinit ishte vënë nën presion nga komunistët (e raportuar edhe ajo nga gruaja e Solzhenicinit) dhe për këtë vari veten. Nëse Solzhenicini do të kishte heshtur, kjo gjë nuk do të kishte ndodhur. Një gjë tjetër shumë e rëndësishme: I jam falënderues Zotit për vitet që kalova në izolim të plotë. Kam qenë për tre vjet 30 këmbë/10 metra nën tokë. S'kam dëgjuar asnjë fjalë. Nuk kam folur asnjë fjalë. Nuk kishte libra. As zëra nga jashtë. Edhe këpucët e rojave ishin bërë të atilla që të mos ndjeheshin hapat kur afroheshin. Me kalimin e kohës edhe zërat e brendshëm u shuan. Na droguan, na rrahën. E harrova gjithë teologjinë time. E harrova edhe Biblën. Një ditë kuptova që kisha harruar edhe lutjen «Ati ynë.»

S'mundja ta thosha lutjen. Dija vetëm që fillonte me «Ati ynë...» Por s'dija si të vazhdoja më tutje, u ndjeva i lumtur që mund të thosha: «Ati ynë, e kam harruar lutjen. Me siguri që e dëgjon këtë lutje me mijëra herë në ditë, ndaj ti do caktosh një engjëll ta thotë lutjen për mua, ndërsa unë do të rri kështu në heshtje.» Për njëfarë kohe, lutja ime ishte vetëm «Jezus, të dua.» Dhe pak më vonë «Jezus të dua, Jezus të dua.» Më pas, e kisha të vështirë ta thosha edhe këtë, sepse na kishin droguar rëndë me qëllim që të na shkatërronin mendjen. Ishim shumë të uritur. Na jepej vetëm një fetë shumë e hollë buke në javë. Ndërkohë më rrihnin, torturonin, linin në errësirë dhe shumë gjëra të tjera që pasonin. M'u bë e pamundur të përqendrohesh, s'mund të thosha as «Jezus të dua.» Hoqa dorë edhe nga kjo. Forma më e lartë e lutjes është rrahja e qetë e zemrës që e do Atë. Jezusi mund të dëgjojë vetëm tik-takun dhe ta dijë që çdo rrahje zemre është për Të.

Kur dola nga izolimi i plotë dhe u bashkova me të burgosurit e tjerë, çuditëshe pse flisnin ata. Shumë prej fjalëve që nxjerrim nga goja janë të padobishme. Në ditët e sotme, njerëzit mund të njihen me njëri-tjetrin vetëm duke thënë «Ç'kemi?» Po ku qëndron dobia e kësaj? Njëri prej tyre mund të thotë: «Mendon se moti po mban mirë?» dhe tjetri që ia kthen: «Po, mendoj se po.» Pse

u dashka të flasim për motin? Nuk e marrim aq seriozisht fjalën e Jezusit kur thotë se njeriu nuk do të gjykohet për çdo fjalë të keqe, por për çdo fjalë të padobishme. Pra, është e shkruar në Bibël. Fjalë të padobishme në disa vende do të thotë burgosje për vëllanë që ke në krah. Një kompliment për vëllanë tënd, nëse nuk është i nevojshëm, mund të përbëjë katastrofë për të. Për shembull, dikush ju vjen për vizitë dhe ju i thoni: «Oh, më vjen keq që nuk ishit pak më parë, vëlla Filani sapo iku.» Por vizitori mund të jetë edhe ndonjë spiun i policisë sekrete. Kështu që merret vesh prej tij që vëlla Filani është në qytet. Mbage gojën të mbyllur! Mëso ta bësh që tani!

Manovra të lejueshme

Nuk mund të bëhesh pjesë e shërbesës së fshehtë nëse nuk di të përdorësh manovra të caktuara. Di një rast që ka ndodhur në Rusi. Komunistët dyshonin që të krishterët mblidheshin diku, ndaj kishin filluar të vëzhgonin rrugën. Ata e dinin që takimi do të ishte diku në atë lagje. Vunë re një djalosh të shkonte drejt një shtëpie, ku ishte planifikuar të bëhej takimi. Policia ndali djaloshin dhe e pyeti: «Ku po shkon?» Me një pamje të trishtuar, ai u përgjigj: «Më vdiq vëllai i madh dhe po mblidhemi si familje për të lexuar testamentin e tij.» Oficerit të policisë i bëri përshtypje, ndaj e lejoi të shkonte. Djaloshi nuk kishte gënjyer.

Një vëlla u mor në polici dhe u pyet: «A vazhdoni të mblidheni nëpër takime?» Ai u përgjigj: «Shoku komandant, takimet e lutjes janë të ndaluara tani.» Për këtë komandanti i tha: «Shumë mirë që pajtohesh. Ik tani!» Por vëllai nuk tha se pajtohej me të; as nuk tha se nuk shkonte nëpër takime. Një korrier i Zërit të Martirëve shkoi në një vend komunist. U ndal në kufi dhe u pyet: «Çfarë librash ke me vete?» Ai u përgjigj: «Kam librat e Shekspirit dhe të Jehovait.» Oficeri i policisë nuk donte ta jepte veten para tij si i paditur. Jehovai mund të ishte për të një poet i njohur anglez dhe të pyeste se kush ishte ky Jehovai mund ta bënte me turp. Ai tha vetëm: «Në rregull, mund të kalosh.» Pra, ka manovra të lejueshme. Nuk kam nevojë për engjëjt e përrallave të fëmijëve,

sepse ata janë realë; secili prej nesh ka një engjëll mbrojtës. Aty ku mblidhen të krishterët, gjithmonë do të gjenden edhe djajtë. Duhet të besojmë në engjëjt dhe në Frymën e Shenjtë. Nuk jemi të detyruar t'i tregojmë një tirani ateist të vërtetën. S'jemi të detyruar të themi çfarë po bëjmë. Është e papërshtatshme që ai të më pyesë paturpësisht.

A nuk do të ishte e palejueshme dhe e papërshtatshme nëse të pyes: «Sa para ke futur në bankë?» ose «Sa e ke pagën?». Këto pyetje nuk duhen bërë. S'ke pse ta pyesësh një vajzë: «A ke të dashur? A je e dashuruar?» Sepse ajo mbase s'ka qejf të ta bëjë të ditur. Kështu që askush nuk ka pse të më bëjë presion mbi aktivitetin tim fetar nëse unë vetë nuk dua t'i tregoj. Kjo do të thotë të fusësh hundët në çështjet e mia private. Qeveria ateiste nuk ka të drejtë të më bëjë pyetje të tilla, ndaj dhe ne nuk kemi pse të përgjigjemi. Gjatë marrjes në pyetje vihesh përballë lloj lloj pyetjeve. Komunistët më kanë thënë: «Je i krishterë dhe pastor. Duhet të thuash të vërtetën. Ndaj na trego, cilët janë drejtuesit e Kishës së Fshehtë? Ku mblidheni? Me kë takoheni? Cilët janë drejtuesit e qyteteve të tjera?» Nëse do të kisha zbuluar të vërtetën, do të ishin bërë arrestime të panumërta të njerëzve, të cilët, të vënë në të njëjtën pozitë, do të kishin treguar të vërtetën e kështu me radhë. Ndaj duhet t'i rezistojmë kësaj gjëje. Atje ku rezultatet e të kundërshtuarit janë rrahjet dhe torturat, atëherë duhet ta mbash gjithçka mbi veten tënde edhe nëse kjo të kërkon të sakrifkohesh deri në vdekje.

Njoh një pastor që sot ka të njëjtat dhimbje që kam patur unë për shkak të torturave, sepse ka luajtur regbi. Diçka ndodhi me këmbën e tij gjatë lojës, dhe kjo i shkakton dhimbje të padurueshme. Për lojën regbi, mund t'i mbaj dhimbjet për vete dhe kur ato të kalojnë mund ta rifilloj lojën, edhe pse e di që të tjera incidente mund të pasojnë. E pra, ne mbajmë mbi vete dhimbje që mund të na i shkaktojë një lojë sportive, që na bën mirë për shëndetin fizik dhe emocional. Po njësoj mund të marrësh mbi vete rrezikun e dhimbjeve fizike të torturës për të mbrojtur vëllezërit e tu nga arrestimi dhe burgosja. Gjëja më e keqe që mund të të ndodhë është të vdesësh gjatë torturave. Por vdekja është gjëja më e natyrshme në botë.

Një lypës ndaloi para shtëpisë së një të pasuri dhe kërkoi: «A mund të fle një natë këtu, ju lutem? S'kam ku të fle.» I pasuri ia ktheu: «Shporru që këtej, lypsar! Nuk është hotel këtu!» I varfëri tha: «Më fal, po iki.» Pastaj shtoi: «A mund t'ju pyes për diçka para se të iki? E pashë këtë shtëpi dhe ishte shumë e bukur. Kush e ka bërë?» Tani i pasuri u ndje disi i përkëdhelur në sedër dhe i tha: «Këtë shtëpi e ka ndërtuar gjyshi im.» «Po ku është ai tani?» «Ka vdekur kohë më parë» «Kush jetoi në këtë shtëpi pasi ai vdiq?» «Im atë» «A jeton ai?» «Jo, edhe ai ka vdekur.» «Po kush banon tani në këtë shtëpi?» «Unë.» «Po edhe ti do të vdesësh një ditë.» «Po.» «Dhe kush do të jetojë në shtëpi pasi të vdesësh ti?» «Shpresoj që fëmijët e mi.» Pastaj lypësi tha: «Pse më bërtite atëherë? Më the që nuk është hotel, por në fakt, hotel është. Ti paketon gjërat e tua dhe një tjetër vjen.» Realiteti i vdekjes është i dukshëm; mbaje si një pamje të përgjithshme të jetës tënde. Nëse Perëndia do që unë të vdes sot, Ai nuk ka nevojë për një torturues. Mund të vdes nga një infarkt në zemër pa praninë e një torturuesi. Pra, nuk është torturuesi ai që ma shkurton jetën, qoftë edhe një ditë. As edhe restoranti më i mirë nuk ma shton jetën me menynë më të mirë dhe të shëndetshme që mund të ofrojë. Unë vdes kur Perëndia më thërret.

Grindjet tradhtare

Në kishën e fshehtë nuk lejohet as edhe grindja më e vogël. Çdo grindje në Kishën e Fshehtë do të thotë arrestime, rrahje dhe ndoshta vdekje. Kundërshtarët tanë vëzhgojnë dhe përgjojnë. Ata kanë vënë spiunët e tyre brenda kishës. Kurdo që ndodh një grindje, bëhen akuza të ndërsjella. Njëri mund t'i thotë tjetrit: «Kur ishe me vëllanë Smith, bëre këtë e atë...» Kështu që policia kap Smithin. Grindjet gjithmonë nxjerrin në pah emra dhe fakte. Prandaj dhe është shkruar në Bibël: «Sepse shërbëtori i Zotit nuk duhet të grindet, por të jetë i butë me të gjithë...» (2 Timoteut 2:24).

Unë di një qytet në Rumani ku pati një grindje të tmerrshme midis dy kongregacioneve. Njëri prej tyre ishte Baptist dhe tjetri një Kongregacion Vëllezërisht Eksluziv (të Veçuar). Grindja e tyre

ishte aq e tmerrshme sa çoi në arrestimin e drejtuesve të të dy kongregacioneve. Është më mirë të fillosh që sot për të qenë shenjtor. Do të ishte shumë vonë kur të shkosh në qiell! Nuk do të dije nga t'ia filloje. Ndaj duhet t'ia nisësh që tani. Pastaj, në rastin e ndonjë pushtimi nuk është zgjedhje e zgjuar grindja, gjëja më e mirë është të mos grindesh që prej këtij momenti. Fatkeqësisht, ka grindje midis organizatave që punojnë në rrethana të rrezikshme. Ato duhen shmangur sa më shumë të jetë e mundur. Edhe një grindje familjare mund të nënkuptojë vdekjen. Kam qëndruar në të njëjtën qeli me një të ri, i cili kishte një të dashur. Siç edhe ndodh në moshë të re, ai takoi një vajzë tjetër të cilën e pëlqente më shumë se vajzën e parë. Por të dashurës së parë ai i kishte treguar sekrete të ndryshme, dhe ajo njoftoi Policinë Sekrete. Ai u dënua më burgim të përjetshëm. Gjatë kohës në burg ai u çmend. Përgatitja për shërbesën e fshehtë është thelbësore për një punëtor të zakonshëm të krishterë, vetëm se është më e thellë dhe duhet të bëhet më reale – pjesë e jetës. Unë njoh shumë kongregacione në shtete të ndryshme, që janë shkatërruar nga një grindje mes dy pastorëve apo dy anëtarëve të pleqësisë së kishës. Kjo gjë ndodh kudo, por në një vend të shtypur kjo gjë do të thotë burgosje dhe ndoshta vdekje.

T'i rezistosh «shpëlarjes së trurit»

Një prej metodave më të njohura përveç torturave fizike është edhe ajo e quajtur «shpëlarja e trurit.» Duhet të dimë si t'i rezistojmë. Kjo metodë ekziston edhe në vendet e lira. Shtypi, radioja dhe televizioni na e shpëllajnë trurin. Nuk ekziston asnjë motiv në botë për të pirë Coca-Cola. Ti thjesht e pi atë sepse të është larë truri. Uji i thjeshtë është me siguri më i mirë se Coca-Cola.. Por askush nuk reklamon «Pini ujë, pini ujë!» Nëse do të reklamohet uji, atëherë do të pinim ujë.

Disa e kanë përdorur metodën e shpëlarjes së trurit në mënyrë ekstreme. Metodat janë të ndryshme, por shpëlarja e trurit në burgun rumun konsiston në këtë: Ne duhej të uleshim për shtatëmbëdhjetë orë në një mënyrë të tillë që nuk na lejonte të

anoheshim dhe pa mbyllur sytë. Dhe për shtatëmbëdhjetë orë rresht, gjithë ditën dhe natën duhej të dëgjonim «Komunizmi është i mirë, komunizmi është i mirë, komunizmi është i mirë. Krishterimi është i vdekur, Krishterimi është i vdekur, Krishterimi është i vdekur, hiq dorë, hiq dorë.» Do të mërzhiteshe që në minutën e parë me këtë, por të duhej të dëgjoje shtatëmbëdhjetë orë rresht për javë të tëra, muaj deri edhe vite pa ndërprerje. Ju siguroj se nuk ishte aspak e lehtë. Është një prej torturave më të këqija, madje më e keqe se vetë tortura fizike. Por Krishti i parashikoi të gjitha këto gjëra sepse me Të nuk ka kohë. E ardhmja, e shkuara dhe e tashmja janë për Të një dhe njësoj: Ai njih gjithçka që prej fillimit.

Komunistët e shpikën metodën e shpëlarjes së trurit me shumë vonesë! Krishti e kishte shpikur tashmë të kundërtën e shpëlarjes së trurit- larjen e zemrës. Ai ka thënë: «*Lum ata që janë të pastër në zemër, sepse ata do ta shohin Perëndinë.*» (Mateu 5:8).

Stefani, martiri i parë në Krishtin, ishte i rrethuar nga qindra kundërshtarë me gurë në duar për t'i hedhur kundër tij. Ai tha: «Ja, unë po shoh...» Dhe gruaja e Stefanit patjetër ka menduar se ai e kishte vënë re rrezikun që i kanosej dhe do të largohej duke vrapuar. Por ai tha: «Shoh Jezusin të ulur në të djathtë të Perëndisë.» Ndoshta ajo i ka thënë (por kjo nuk është e shkruar) «Nuk e sheh gjithë këtë turmë rreth vetes gati për të të qëlluar me gurë?» «Oh po! Shikoj ca milingona të vogla atje poshtë që nuk ia vlen të përmenden. Unë po shoh *Jezusin.*» Ai nuk pa drejt atyre që dëshironin ta vrisnin. Lum ata që janë të pastër në zemër! Kam kaluar në procesin e shpëlarjes së trurit për dy vjet. Komunistët mund të kenë thënë që truri im ishte ende i ndotur. Me të njëjtin ritëm që ata thoshin se «Krishterimi ka vdekur», unë dhe të tjerët duhet ti përsërisnim vetes: «Edhe Krishti ka vdekur. Edhe Krishti ka vdekur.» Por ne e dinim që ai ishte ringjallur. Ne sillnim ndër mend që po jetonim në një bashkësi me shenjtorët. Zakonisht besojmë që shenjtorët që kanë shkuar te Zoti janë diku në qiej midis yjeve. Bibla na tregon ku janë. «Duke qenë të rrethuar nga një re kaq e madhe dëshmitarësh...» (Hebrenjve 12:1). Pse duhej të uleshin ata midis yjeve? Ata janë aty ku ndodhen luftëtarët e

vuajtësit e vërtetë. Në botën e Frymës nuk ekziston koncepti këtu dhe atje. Nocionet e kohës dhe hapësirës nuk ekzistojnë në botën e Frymës. Ne ishim të izoluar në burg, por ata ishin rreth nesh.

E kemi ndier praninë e shenjtorëve gjatë gjithë kohës. Unë personalisht kam patur shumë ndjesinë e pranisë së Maria Magdalenës. Kam menduar gjatë procesit të shpëlarjes së trurit: «Çfarë po më thonë, që Krishterimi ka vdekur? Të supozojmë se kanë të drejtë, çfarë ndryshimi do të kishte? Edhe sikur të hamendësoj se nuk ka mbetur as edhe një i krishterë tjetër në botë përveç meje, çfarë ndryshimi do të kishte? Maria Magdalena thjesht e donte Jezusin. Nëse Jezusi ishte i vdekur, ajo sërish e donte Jezusin, edhe pse i vdekur. Ajo qëndroi pranë varrit të Jezusit të vdekur që s'mund të bënte asgjë për të. Ai nuk mund të ngrinte qoftë edhe gishtin e vogël për të, Ai nuk mund të bënte asnjë mrekulli, Ai nuk mund të fliste asnjë fjalë ngushëllimi për të Ai nuk mund të fshinte as edhe një lot nga sytë e saj, asgjë. Ai ishte Shpëtimtari. E çfarë pastaj se ti po më thua se Ai është i vdekur? Unë e dua Atë njëlloj sikur të ishte i gjallë. Edhe nëse e gjithë Kisha të vdesë apo të humbasë besimin e saj, nuk ka arsye për mua që të humbas besimin tim.»

Duhet të arrijmë bindjen e plotë të besimit. Ju kam treguar pak më parë që fjala «dyshim» nuk ekziston në hebraisht. Kjo fjalë nuk përmendet asnjëherë në Dhjatën e Vjetër. A mund të përmend edhe një fjalë tjetër, që nuk ekziston po ashtu në hebraisht? Jam akuzuar shpesh nga drejtuesit e Këshillit Botëror të Kishave. Ata shkruan kundër meje: «Vurmbrandi e përshkruan situatën pas Perdes së Hekurt vetëm bardh e zi. Por nuk është plotësisht kështu. Ka edhe pjesë gri. «Dhe ua kam kthyer përgjigjen se, do ta pranoja atë që thoshin ata nëse do të më tregonin qoftë edhe një herë të vetme të përmendur në Dhjatën e Re fjalën «gri.» Ka shumë ngjyra që përmenden në Dhjatën e Re, por ngjyra «gri», një përzierje, nuk ekziston. Një gjë është e vërtetë ose jo; është e drejtë ose e gabuar. Është e bardhë ose e zezë. Duhet të shkosh pas botës ose pas Krishtit. Në Dhjatën e Vjetër, në hebraisht, nuk ekziston fjala «dyshim.» Duhet të jemi të sigurt mbi këto probleme të besimit, ashtu siç jemi të sigurt mbi tabelën e mbledhjes dhe shumëzimit

në aritmetikë. Dy dhe dy bëjnë katër. Kjo është e vërtetë. Nëse familja ime jeton ose e kanë rrahë, nëse kam mjaftueshëm ose po vdes urie, nëse jam i lirë ose jam i burgosur, nëse jam i rrahur ose i përkëdhelur, e vërteta në matematikë nuk ndryshon. Dy përkëdhelje edhe dy përkëdhelje bëjnë katër përkëdhelje, ashtu sikurse dy rrahje plus dy rrahje bëjnë katër rrahje. Siguria e së Vërtetës dhe një dashuri si ajo e Maria Magdalenës të ndihmojnë t'i rezistosh shpëlarjes së trurit. Të rezistosh deri në ekstrem. Nuk dua të hiqem si hero. Unë jam një njeri, dhe si çdo njeri, kam të metat dhe dobësitë e mia. Për këtë arsye, ne ekzistojmë si Kishë, që të inkurajojmë njëri-tjetrin në momente dobësie.

Nën një presion të tillë të tmerrshëm, një moment i kam pëshpëritur vëllait pranë meje – një shërbëtor Presbiterian dhe një i Krishterë shumë i mirë,: «Vëlla, më duket se kam humbur besimin tim. Nuk mendoj se jam më besimtar.» Me një buzëqeshje që nuk i largohej kurrë nga buza, ai më pyeti: «Por a ke besuar ndonjëherë?» Dhe unë i thashë: «Po, sigurisht.» Ai më tha: «Atëherë kujto këtë varg nga Bibla. Kur virgjëresha Mari shkoi tek Elizabeta, kjo i tha: «*Tani, e lumur është ajo që besoi*», dhe *besoi* është në kohën e shkuar. Nëse ke *besuar* në të shkuarën, ti je i bekuar. Jeto nën këtë bekim.» Nuk mund t'jua përshkruaj se çfarë ndikimi patën këto fjalë tek unë në ato rrethana.

Nuk e di sa e shëndoshë është kjo teologji, por ne nuk jetonim nën teologji në atë kohë. Ne jetonim me kujtime të shkuara. Prandaj Bibla na mëson se duhet ta bekojmë Zotin dhe të mos i harrojmë bekimet e së kaluarës. Kujto bekimet e së shkuarës edhe kur je duke kaluar një moment të errët shpirtëror.

Të mposhtësh vetminë

Një prej problemeve më të mëdha për një luftëtar të fshehtë është të dijë si të mbushë vetminë. Ne nuk kishim absolutisht libra për të lexuar. Jo vetëm s'kishim Bibla, por as libra të tjerë, asnjë copë letër apo laps. Nuk dëgjonim asnjë zhurmë dhe s'kishte asgjë që të mund të na tërhiqte vëmendjen. Shihnim vetëm mure, dhe kaq. Normalisht, në të tilla rrethana mendja të çoroditet. Lexoni

libra mbi jetën në burg (*Papillon ose libra të tjerë të vlefshëm për t'u lexuar nga një punëtor i ardhshëm në kishën e fshehtë*) thjesht për të rrokur atmosferën e një burgu aq sa mund të kapë një njeri i lirë jashtë burgut. Do të vëreni ndikimin marrosës të të qëndruarit vetëm për vite të tëra pa pasur asgjë që të të heqë mendjen...

Mund t'ju tregoj nga përvoja ime si ia kam dalë të mos çmendem, por edhe kjo duhet të vijë si rezultat i një jete parapërgatitore shpirtërore. Sa gjatë mund të qëndrosh vetëm pa pasur Biblën pranë? Sa gjatë mund të qëndrosh vetëm pa ndezur radion apo magnetofonin, etj? Unë dhe shumë të burgosur të tjerë kemi bërë kështu. Nuk flinim asnjëherë natën, por vetëm gjatë ditës. Qëndronim zgjuar gjithë natën. E dini atë psalmin që thotë: «Ja, bekonit Zotin, ju, të gjithë shërbëtorët e Zotit, që e kaloni natën në shtëpinë e Zotit.» (Psalmi 134:1).

Një lutje e natës është baraz me dhjetë lutje të ditës. Të gjitha mëkatet dhe krimet e rënda zakonisht bëhen gjatë natës.

Të gjitha grabitjet, tradhtitë, dehjet me alkool dhe argëtimet e shfrenuara – e gjithë kjo jetë mëkati është jetë nate. Gjatë ditës, gjithkujt i duhet të punojë në fabrikë, të shkojë në shkollë apo diku tjetër. Forcat demonike janë forca të natës, ndaj është kaq e rëndësishme t'i kundërshtojmë gjatë natës. Të qenët vigjilent është shumë e rëndësishme. Në botën e lirë, vigjilentët janë pak ose aspak të njohur. Në vendin tim, madje edhe para se komunistët të vinin në pushtet, ekzistonin vigjilentë. Im bir, Mihai, që kur ishte tre apo katër vjeç e dinte çfarë ishin vigjilentët, sepse ne e kalonim natën duke u lutur. Fëmijët e vegjël të moshës tre a katër vjeçare, gjatë kohës së lutjes do të bënin një lutje të shkurtër dhe më pas do t'i gjuanin njëri-tjetrit me shaka. Ne u tërhiqnim vëmendjen për zhurmën dhe ata do të vazhdonin në lutjen e tyre edhe pak derisa t'i zinte gjumi nën ndonjë tavolinë. Kështu janë rritur këta fëmijë, duke mësuar për vigjilencën.

Gjatë izolimit, ne zgjoheshim kur të burgosurit e tjerë binin për të fjetur. E mbushnim kohën me një program aq të ngjeshur sa që e kishim të vështirë ta përmbushnim. E fillonim me një lutje, gjatë së cilës udhëtonim në të gjithë botën. Luteshim për çdo shtet, për

vendet që ua dinim emrat e qyteteve dhe të njerëzve, dhe luteshim që Zoti të ngrinte predikues të mëdhenj. Do të kalonim kështu një a dy orë të mira. Luteshim për pilotët dhe ata që gjendeshin në det, si dhe për ata që ishin të burgosur. Bibla na tregon për një nga gëzimet më të mëdha që mund të marrim, qoftë edhe kur jemi në burg: «Gëzohuni me ata që gëzohen. (Romakëve 12:15) Gëzohesha duke ditur që diku kishte familje që mblidheshin tok me fëmijët, lexonin Biblën, tregonin histori gazmore dhe ishin të lumtur me njëri-tjetrin. Diku një djalosh kish rënë në dashuri me një vashë dhe kishte filluar të kalonte kohë me të, unë mund të gëzohesha për ata të dy. Dhe ka të tjerë që mblidhen në takimin e lutjes, dhe dikush tjetër që ishte duke studiuar apo dikush tjetër diku, po shijonte ushqim të mirë, etj. Ne mund të gëzoheshim me ata që gëzoheshin. Pasi kisha udhëtuar nëpër të gjithë botën, lexoja Biblën përmes vargjeve përmendsh. Është një gjë tepër e rëndësishme për një punëtor të fshtë të mësojë vargje përmendsh nga Bibla.

Thjesht sa për të qeshur pak, po ju tregoj diçka që më ka ndodhur. Njëherë, ndërsa shtrihesha në ato pak dërrasa që përbënin shtratin tim, kujtova predikimin në mal sipas Lukës. Arrita në një pjesë ku thuhej: «Kur të persekutoheni... për shkak të Birit të Njeriut, gëzohuni atë ditë dhe hidhuni nga gëzimi.» (Luka 6:22,23a *Lum ju, kur njerëzit do t'ju urrejnë, do t'ju mallkojnë dhe do t'ju fyejnë, do ta shpallin emrin tuaj si të keq, për shkak të Birit të njeriut.* ²³ *Gëzohuni atë ditë dhe hidhuni nga gëzimi, sepse ja, shpërblimi juaj është i madh në qiell!;*) E mbaja mend të ishte shkruar tamam kështu. Ndaj mendova: «Si mund të kryej mëkat duke neglizhuar? Krishti ka thënë se duhet të bëjmë dy gjëra të ndryshme. Njëra që të gëzohemi, gjë që unë e kam bërë. Tjetra, “të hidhemi nga gëzimi”, gjë që nuk e kam bërë.» Kështu që kërcëva. Zbrita nga shtrati im dhe nisa të hidhesha përpjetë. Dyert e qelive të burgut janë të pajisura me një vrimë përgjimi nga ku mund të shohin rojat. Qëlloi që roja e turnit të më shihte kur unë po kërcëja. Ai mendoi se isha çmendur. Rojat kishin urdhër të silleshin mirë me të çmendurit në mënyrë që të mos shkaktoheshin turbullira që do të thyenin rregullat e burgut.

Kështu, ai hyri në qeli dhe butazi kërkoi të më qetësonte duke më thënë: «Mos u shqetëso, gjithçka do të rregullohet! Vetëm qetësohu! Po të sjell diçka për të ngrënë.» Dhe më solli një copë të madhe buke. Racioni ynë ishte vetëm një fetë e hollë buke në javë ndërkohë që para vetes kisha një copë goxha të madhe, si edhe *një copë djathi*. Djathë i bardhë. Mos e ha djathin menjëherë, në fillim vëreji bardhësinë! Sa bukur dukej! Madje, ai më solli edhe pak sheqer. Më tha edhe disa fjalë të këndshme dhe u largua pasi kyçi derën pas vetes. Mendova: «Do t'i ha të gjitha gjërat pasi të përfundoj kapitullin nga Luka.» U shtriva sërish dhe u përpoqa të kujtoja aty ku kisha mbetur. «Po, te “kur të persekutoheni për shkak të emrit tim, gëzohuni”... dhe hidhuni nga gëzimi, se i madh do të jetë shpërblimi juaj.» Pashë nga copa e bukës dhe e djathit. Vërtet, shpërblimi *ishte* i madh!

E pra, detyra tjetër është të mendoni rreth Biblës dhe të meditoni mbi të. Çdo natë, krijoja nga një predikim që fillonte me «të dashur vëllezër dhe motra», dhe mbaronte me «amen!» Pasi e përfundoja, e shpërndaja. Më pas i vendosja në rimë të shkurtër që të mund t'i mbaja mend. Librat «*Me Perëndinë në izolim të plotë*» dhe «*Nëse muret e burgut do të flisnin*» përmbajnë disa pjesë të këtyre predikimeve. Kam arritur të mbaj mend tre qind e pesëdhjetë prej tyre. Kur dola nga burgu, disa i hodha në letër. Rreth pesëdhjetë u publikuan në dy librat e mësipërm. Janë predikime që i drejtoheshin Perëndisë dhe engjëjve. Engjëjt kanë krahë dhe mund t'i shpërndajnë mendimet në njerëz të tjerë. (Tanimë këto predikime janë përkthyer në disa gjuhë dhe janë përdorur nga të tjerë) Kështu e mbushnim kohën në burg. Kam krijuar libra dhe poezi. Kam menduar për gruan dhe fëmijët e mi. Çdo natë i tregoja vetes anekdota, por çdo herë anekdota të reja që nuk i dija më parë, në mënyrë që të ishin të gjitha optimiste. Në fakt, vetë këto anekdota ishin një pasqyrë e gjendjes sime në atë kohë. P.sh, një prej tyre ishte: «Një grua i thotë burrit të vet: “Pjetër, çfarë duhet të bëj? U ula mbi protezën e dhëmbëve dhe e theva.” Dhe burri ia kthen: “Epo, gëzohu! Mendo si do të dukej sikur të ishe ulur mbi dhëmbë natyralë.” Kështu shihja anën e mirë të gjërave.»

Me copa buke bëra gurë shahu, disa të bardhë të lyer me shkumës dhe të tjerët gri. Luaja shah me veten. Asnjëherë mos besoni se Bob Fisher është mjeshtri më i madh botës në shah. Ai fitoi në ndeshjen e fundit me Spaskin. Fitoi tetë lojë dhe humbi dy. Por unë, në tre vjet nuk humba asnjë lojë. Kam fituar gjithmonë, qoftë me të bardhët, qoftë me gritë! Jua tregova të gjitha këto gjëra, sepse u përkasin sekreteve të një punëtori të fshehtë në vuajtjet e tij. Mos e lini kurrë mendjen tuaj të bjerë në dëshpërim, sepse atëherë komunistët ju kanë tërësisht në dorë. Duhet ta ushtroni vazhdimisht mendjen. Mendja juaj duhet të jetë vigjilente, duhet të mendojë, duhet që, secili sipas aftësive të veta, të jetë në gjendje të krijojë gjëra të ndryshme, etj.

Identitet i Vërtetë

Kisha e Fshehtë nuk është diçka e re. Pasi kisha punuar në Kishën e Fshehtë e lexova Dhjatën e Re me të tjerë sy. Lexova në Veprat e Apostujve shembuj ku apostujt dhe dishepujt mbajtën emra «të tjerë» nga emrat e mëparshëm, shembuj që janë të shumtë në Dhjatën e Re (Zbulesa 2:17 është një shembull madhështor)


- «JOZEFI, i quajtur BARSABA, që ishte i mbiquajtur JUST» (Veprat 1:23).
- «IOSE, që u quajt edhe BARNABA nga apostujt» (Veprat 4:36).
- «SIMEONI që u quajt NIGER» (Veprat 13:1).
- «JUDA që u quajt edhe BARSABA» (Veprat 15:22).
- «JEZUSI që është quajtur JUST» (Kolosianëve 4:11).

Pse duhej të quheshin Jakobi dhe Gjoni «Bijtë e Bubullimës» dhe Simoni «Pjetër»? Nuk e kam ditur asnjëherë shpjegimin e kësaj. Gjejmë shumë shembuj të emrave, që janë ndryshuar në Dhjatën e Re. Tani, kjo është ekzaktësisht ajo që ndodh në Kishën e Fshehtë. Unë vetë kam pasur shumë emra. Kur shkoja në ndonjë qytet a fshat nuk thoshin që erdhi vëlla Vurmbrandi. Në një qytet isha Vasili, në tjetrin quhesha Georgesku, në një tjetër Ruben e kështu me radhë. Kur më arrestuan isha Riçard Vurmbrandi i thirrur në shumë emra. Unë personalisht besoj jo vetëm në

frymëzimin e fjalëve në Bibël, por edhe në atë të shkronjave. Atëherë, pse janë përdorur fjalë në dukje të «panevojshme»? Është shkruar te Luka: «Jezusi u lut në një vend të caktuar.» Në fakt duhet të jesh diku saktësisht kur lutesh. Atëherë, pse u dashka të përdoren fjalët «në një vend të caktuar»? Është shkruar sërish: «Ai erdhi në një qytet të caktuar.» Çdo qytet është një qytet i caktuar, por kjo është pikërisht gjuha e Kishës së Fshehtë.

Kur kthehesha nga ndonjë udhëtim, i tregoja gruas: «Isha në një qytet dhe në një vend të caktuar ku takova një vëlla. Vendosi që të takoheshim në një orë të caktuar në një prej shtëpive atje.» Jezusi deshi të hante darkë me dishepujt e vet (Luka 22:7-13). Në këtë rast, ai normalisht duhet të kishte thënë: «Shkoni në këtë adresë rruge dhe lagje dhe kërkoni zotin XYZ dhe atje përgatisni darkën.» Por në fakt, Ai tha: «*Ja, kur të hyni në qytet, do t'ju dalë përpara një njeri që mban një brokë uji; ndiqeni në shtëpinë ku ai do të hyjë.*» (Duhet të ketë qenë diçka e rrallë që një burrë të «mbante një brokë uji», duke qenë se ishte detyrë e grave të shkonin për të mbushur ujë në pus.) Kështu veprimi edhe ne saktësisht; kur zhvillojmë takimin e lutjes, nuk japim kurrë adresën e vendit, sepse asnjëherë nuk e dimë kush mund të jetë informatori. Kështu që themi: «Qëndro në qosën e “asaj” rruge ose ulu në parkun publik dhe do të shohësh të kalojë një burrë me kravatë blu ose me ndonjë shenjë tjetër. Nëse ndokush e pyet tjetrin «Si e ke emrin?» atëherë mund ta kuptojmë që ky është informator i policisë sekrete.

Kisha e Fshehtë ishte diçka që ekzistonte tashmë në kohën kur është shkruar Dhjata e Re. Ka kritikë që na kanë thënë se është e paligjshme para Perëndisë të punosh në këtë mënyrë. Duhet t'u bindemi autoriteteve. Këshilli Botëror i Kishave na akuzon, por ata u japin donacione guerrillasve që nuk u binden autoriteteve. Në Bibël është shkruar që autoriteti është kreu që ndëshkon të keqin dhe shpërblen të mirin. Autoriteti që pengon fjalën e Perëndisë e vendos veten jashtë sferës njerëzore. Asnjë varg i Biblës nuk aplikohet dot në këtë situatë. Çdo autoritet ka ligjet, padrejtësitë dhe abuzimet e veta, sepse asnjë qeveri, shtet nuk përbëhet nga shenjtorë. Përbëhet nga mëkatarë. Kryesorja është që ata të mos



pengojnë larvën të kthehet në një flutur. Ata nuk duhet ta pengojnë një gonxhe të kthehet në lule; dhe as mëkatarin të kthehet në shenjtor. Për aq kohë sa ma lejojnë këtë, nuk i konsideroj si shenjtorë të rënë nga qielli. Ajo që pres prej tyre është të bëjnë disa gjëra të mira, dhe nëse kanë ligje të gabuara të kenë dëshirën e mirë për t'i ndryshuar brenda dy apo tre vjetësh. Kështu, unë do t'i respektoja si autoritet. Por kur ata më marrin edhe vetë thelbin e jetës sime, që është të përgatitem për një jetë më të mrekullueshme në qiell, atëherë nuk ndjehem aspak përgjegjës ndaj këtij lloji autoriteti. Misioni ynë thjesht vazhdon punën e vet të fshehtë për të ndihmuar Kishën e Fshehtë në vendet komuniste dhe ato myslimane.

Ju kam dhënë vetëm një paraqitje të shkurtër të problemeve që ka Kisha e Fshehtë që në njëfarë mënyre të krijoni një ide se si duket si shërbesë.

Zoti ju bekoftë!

Literaturë tjetër nga Riçard Vurmbrandi:

Të Torturuar për Krishtin
Nga Vuajtja në Triumf
Në Kufijtë e Dorëzimit
Në Fshehtësinë e Zotit
Nëse Muret e Burgut do të të Flisnin
Me Perëndinë në Izolim të Plotë
Krishti dhe Udha Hebreje
Përgjigjja ndaj Manualit Ateist
Marksi dhe Satani
I Vetëm me Zotin
Të Arrish Lartësitë
Kisha Triumfuese



2

Vuajtja: Sakrifica e Hedonizmit të krishterë

Xhon Pajper



Shkëputur nga *I etur për Zotin*, © 1996 nga Xhon Pajper
(Sisters, Oregon: Multnomah Books).

I përdorur me lejen e Multnomah Publishers, Inc.

E kërkuar vetëm për këtë përdorim dhe jo për t'u kopjuar për qëllime të tjera.

Të ulesh në këmbët e një shenjtori të vuajtur

Nuk kam qenë më njësor si më parë, pasi u ula në këmbët e Riçard Vurmbrandit. Në këmbët e tij, me plot kuptimin e fjalës. Ai hoqi këpucët dhe u ul në një karrige në platformën pak të ngritur të kishës Baptiste të Hirit, në Mineapolisin e Jugut. (Më vonë, mësova që kishte të bënte me plagët që kishte marrë gjatë torturave në burgjet Rumune) Para tij – dhe poshtë tij – u ulën një duzinë pastorësh. Ai na foli për vuajtjen. Përsëri e përsëri tha se Jezusi «zgjodhi» vuajtjen. Ai e «zgjodhi.» Nuk është se thjesht ndodhi dhe kaq. Ai e «zgjodhi.» «Askush nuk mund të ma heqë, por e lë nga vetja. Unë kam pushtet ta lë dhe ta marr përsëri...» (Gjoni 10:18). Ai na pyeti nëse do të zgjidhnim vuajtjen për hir të Krishtit. Në librin e tij të kushtimit «Të Arrish Lartësitë», paraqitet kështu: Riçard Vurmbrand është pastor ungjillor Lutheran me origjinë hebreje, i lindur në Rumani, në vitin 1909. Kur komunistët pushtuan vendin e tij në vitin 1945, ai u bë një drejtues i kishës së fshehtë. Në vitin 1948, së bashku e gruan e vet, Sabinën, u arrestuan dhe ai kaloi plot katërmbëdhjetë vjet në burgjet e kuqe, përfshirë këtu edhe tre vjet izolimi të plotë në një qeli të nëndheshme pa parë dritën e diellit, as yjet apo lulet, përveç rojeve dhe torturuesve të tij. Miqtë e krishterë nga Norvegjia e blenë lirinë e tij me një çmim prej 10.000 \$ në vitin 1964.¹

Sa e bukur është sakrifika?

Një prej historive të treguara prej tij është edhe ajo e intervistës së Abatit Cistercian dhënë në televizionin italian. Gazetari ishte më tepër i interesuar për mënyrën e jetesës së tyre në vetmi dhe qetësi. Diku e pyet abatin: «Po nëse në fund të jetës kuptoni që ateizmi është i vërtetë dhe se nuk ka Perëndi? Po sikur kjo të ishte e vërtetë?» Abati iu përgjigj: «Shenjtëria, heshtja dhe sakrifika janë të bukura në vetvete edhe pa e pasur premtimin e shpërblimit. Jeta ime do ishte sërish e përdorur mirë.» Një vështrim i shkurtër në kuptimin e jetës ka ndikuar thellë në botëkuptimin tim mbi vuajtjen. Përshtypja e parë e përgjigjes së

abatit ishte një ndjenjë sipërfaqësore, një valë romantike lavdie. Por më pas, diçka ngeci. Nuk dukej se ishte në vendin e duhur. Diçka nuk shkonte mirë. Në fillim nuk arrita ta kuptoj. Pastaj u ktheva te vuajtësi i madh i krishterë, apostulli Pal dhe u shushata nga humnera që e ndante me abatin. Përgjigjja e Palit ndaj pyetjes së gazetarit mund të kishte qenë krejtësisht e ndryshme nga përgjigjja e abatit. Gazetari kishte pyetur: «Po sikur mënyra jote e të jetuarit të jetë bazuar mbi një falsitet dhe sikur Perëndia të mos ekzistonte?» Në thelb, përgjigjja e abatit ishte «Gjithsesi, ka qenë jetë e bukur dhe fisnike.» Pali e jep përgjigjen e tij tek 1 Korintasve 15:19, «*Në qoftë se shpresojmë në Krishtin vetëm në këtë jetë, ne jemi më të mjerët e të gjithë njerëzve.*» Kjo është saktësisht e kundërta e përgjigjes së abatit. Pse nuk ishte dakord Pali me murgun? Përse Pali nuk tha: «Edhe nëse Krishti nuk është ringjallur, edhe në qoftë se nuk ka Perëndi, një jetë plot dashuri, punë, sakrifica dhe vuajtje është një jetë e mirë» Pse nuk tha ai se «edhe pa shpërblimin e ringjalljes, ne nuk jemi për t'u mëshiruar»? Përse në vend të kësaj tha: «Nëse shpresa jonë në Krishtin rezulton në fund e rreme, ne jemi për t'u mëshiruar më shumë se kushdo tjetër në këtë botë?»

A bëhet jeta më e mirë me Krishtin?

Kjo është një pyetje tërësisht vendimtare për Kishën e Krishterë, sidomos në ato vende të begata dhe të rehatshme si Amerika dhe Evropa Perëndimore. Sa herë kemi dëgjuar dëshmi të Krishtera, ku është thënë se Krishterimi e bën jetën më të lehtë? Së fundmi kam dëgjuar qendërmbrojtësin e një skuadre të mirënjohur futbollit të thotë që, pasi ishte lutur dhe kishte pranuar Krishtin, ishte ndjerë aq mirë në lidhje me lojën dhe ishte shumë krenar për rekordin e tyre 8 me 8, sepse kishte pasur mundësinë të dilte në fushë çdo të diel dhe të luante në mënyrë të shkëlqyer.

Duket se shumë të krishterë në Perëndimin e begatë i përshkruajnë përfitimet e Krishterimit në termat e një jete të mirë, edhe nëse nuk do të kishte ekzistuar Perëndia dhe ringjallja. Mendo për të gjitha përfitimet psikologjike dhe relative. Patjetër që edhe

këto janë të vërteta dhe biblike: Frytet e Frymës së Shenjtë janë dashuria, gëzimi dhe paqja. Pra, nëse marrim dashuri, gëzim dhe paqe duke besuar në këto gjëra, a do të ishte sërish jeta e bukur edhe nëse e gjithë kjo ka qenë falsitet? Përse jemi për të ardhur keq? Çfarë nuk shkon te ajo që thotë Pali atëherë? Apo ai vetë nuk po jetonte një jetë në bollëk? Përse i është dashur të shprehej se, nëse nuk ka pasur ringjallje, atëherë ne jemi për të ardhur keq më shumë se çdokush tjetër? Nuk duket shumë për të ardhur keq po të jetosh në një iluzion të kënaqshëm dhe të gëzueshëm nëse ky i fundit nuk bën ndonjë ndryshim në të ardhmen. Nëse iluzioni e kthen boshllëkun dhe gjërat pa kuptim në lumturi, atëherë pse të mos jetosh në iluzion?

Duket se përgjigjja mbi jetën e krishterë për Palin nuk është ajo e ashtuquajtura jetë e mirë e begatë dhe e lehtë. Përkundrazi është një jetë, që zgjedh lirshëm vuajtjen përtej çdo gjëje tjetër të zakonshme të jetës së përditshme. Besimi i Palit në Perëndinë, siguria në ringjalljen dhe shpresa në marrëdhënien e përjetshme me Krishtin nuk prodhonin një jetë të rehatshme dhe të qetë njësoj si kënaqësia e jetës edhe pa faktin e ringjalljes. Jo, shpresa e tij prodhon një jetë, që zgjedh vuajtjen. Po, ai e dinte kuptimin e gëzimit të patregueshëm, por kjo ishte «të ngazëllesh në shpresën» (Romakëve 12:12). Dhe kjo shpresë e shtyu të përqafoje vuajtjen që ai vetë nuk do ta zgjidhte kurrë pa pasur shpresën e ringjalljes së vet dhe të atyre për të cilët vuajti. Nëse nuk do të kishte ringjallje, zgjedhjet sakrifikuere të Palit përmes dëshmisë së tij, ishin të mjera, të mëshirueshme. Po, kishte gëzim dhe një ndjesi të një kuptimi të madh në vuajtjen e tij. Por gëzimi ishte aty vetëm për shkak të shpresës ngazëllyese që ishte përtej vuajtjes. Ky është thelbi i Romakëve 5:3,4: «por mburremi edhe në shtrëngimet, duke ditur që shtrëngimi prodhon këmbënguljen, këmbëngulja përvojën dhe përvoja *shpresën*.»

Pra, ka gëzim në mundime. Por ky gëzim vjen për shkak të shpresës që përmes vetë vuajtjes sigurohet, forcohet dhe rritet. Pra, nëse nuk ka shpresë, Pali rezulton një i çmendur që zgjidhte vuajtjen dhe më tepër se kaq, që ngazëllente në të. Por kishte shpresë. Dhe Pali zgjodhi një mënyrë jete, që do të ishte marrëzi

dhe për të ardhur keq pa patur shpresën e gëzimit përtej varrit. Ai i përgjigjet pyetjes së Riçard Vurmbrandit: Po, ai zgjodhi vuajtjen.

A ka ndonjë dallim midis Konfliktit dhe Kancerit?

Le të bëjmë një devijim të shkurtër për një çast. Dikush mund të pyesë: «Po për vuajtjen që unë nuk e zgjedh vetë? Si kanceri, ose vdekja e fëmijës nga një aksident me makinë? Ose një depresion i thellë? A bën fjalë ky kapitull edhe për një temë të tillë? «Përgjigja ime është se pjesa më e madhe e këtij kapitulli flet për vuajtjen që të krishterët pranojnë si pjesë e zgjedhjes së tyre për të qenë haptazi të krishterë në situata të rrezikshme. Në fakt, të gjitha situatat në vetvete mbartin rrezik në një mënyrë a një tjetër. Ndryshimi më domethënës midis persekutimit dhe një sëmundjeje është se persekutimi është një armiqësi e qëllimshme nga dikush për shkak se njihemi si të krishterë, ndërkohë që sëmundja nuk ka aspak lidhje me këtë.

Prandaj, në disa situata, zgjedhja për të qenë publikisht i krishterë është të zgjedhësh një mënyrë jete, që pranon vuajtjen, nëse është ky vullneti i Perëndisë (1 Pjetrit 4:19). Por vuajtja mund të rezultojë në jetën e një të krishteri edhe atëherë kur nuk ka armiqësi të qëllimshme nga jobesimtarët. Për shembull, një i krishterë zgjedh të shkojë për të shërbyer në një fshat, ku ka rënë një epidemi dhe bie pre e kësaj sëmundjeje. Kjo është vuajtja si i krishterë, por nuk është «persekutim.» Është zgjedhje për të vuajtur nëse është vullneti i Perëndisë dhe jo për shkak të armiqësisë së të tjerëve. Por nëse ndalon një moment për të menduar, e gjithë jeta, nëse është jetuar sinqerisht përmes besimit duke kërkuar lavdinë e Perëndisë dhe shpëtimin e të tjerëve, ngjason me të krishterin që shkoi në fshatin me epidemi. Vuajtja që pason është pjesë e çmimit të jetës kudo ndodhesh ndërsa i bindesh thirrjes së Perëndisë. Në vendimin tonë për të ndjekur Krishtin, në rrugën që na drejton Ai, zgjedhim gjithçka që përfshin kjo rrugë nën Sovranitetin e Tij (*providencën sovranë të Tij*). Ndaj, gjithë vuajtja që vjen gjatë kësaj rruge të bindjes është vuajtje me Krishtin dhe për Krishtin

–qoftë kancer apo konflikt. Dhe kjo rrugë «zgjidhet» – që do të thotë se ne vullnetarisht ndërmarrim shtegun e bindjesku do të ketë vuajtje dhe nuk do të murmurojmë kundër Perëndisë. Mund të lutemi – siç u lut dhe Pali – që vuajtja të hiqet (2 Korintasve 12:8); Por nëse Perëndia vendos, ne e përqafojmë atë në fund, si pjesë e çmimit të të qenët dishepull në shtegun e bindjes përgjatë rrugëtimit për në qiell.

Gjithë vuajtja në thirrjen e krishterë është me Krishtin dhe për Krishtin

Të gjitha përvojat e vuajtjes në shtegun e bindjes, qoftë nga persekutimi, sëmundja apo aksidenti, kanë një gjë të përbashkët: kërcënojnë besimin tonë në mirësinë e Perëndisë dhe na tundojnë të braktisim shtegun e bindjes. Prandaj, çdo triumf i besimit dhe çdo këmbëngulje në bindje është dëshmi ndaj mirësisë së Perëndisë dhe dashurisë së Krishtit – pavarësisht nëse kundërshtari ynë në një çast të jetës sonë është sëmundja, Satani, mëkati apo sabotazhi. Për këtë arsye, të gjitha përjetimet e vuajtjes, pavarësisht të ç'loji janë, të cilat i përballim në shtegun e thirrjes së krishterë, janë vuajtje «me Krishtin» dhe «për Krishtin.» *Me të*, në kuptimin që përballemi me vuajtjen ndërsa ecim në besim me të dhe në forcën që ai na jep përmes shërbesës më të lartë priftërore, ndërsa ka përjetuar njësoj dhimbjet tona. (Hebrenjve 4:15) *Për të*, në kuptimin që vuajtja provon besnikërinë tonë mbi mirësinë dhe pushtetin e tij dhe zbulon vlerën si çmimi më i lartë dhe shpërblimi i gjithëmjaftueshëm.

Qëllimi i Satanit dhe i Perëndisë për të njëjtën vuajtje

Jo vetëm kaq, vuajtja në sëmundje dhe vuajtja në persekutim kanë edhe diçka tjetër të përbashkët: të dyja vijnë nga Satani me qëllim për të shkatërruar besimin tonë, si edhe e mbikëqyrur nën sovranitetin e Perëndisë për ta përsosur besimin tonë. Le të marrim rastin e parë të persekutimit. Tek 1 Thesalonikasve 3:4,5

Pali tregon merakun e vet për besimin e thesalonikasve përballë persekutimit:

«Kur ishim midis jush, ju parashikuam se do të heqim vështirësi, pikërisht sikurse ndodhi, dhe ju këtë e dini. Për këtë arsye, edhe unë, mbasi nuk rezistoj më, dërgova të marr vesh për besimin tuaj, se mos ju kishte tunduar tunduesi, dhe mundimi ynë të kishte shkuar dëm.»

Duket qartë se qëllimi i «tunduesit» gjatë këtyre mundimeve është të shkatërrojë besimin. Por nuk është vetëm Satani projektuesi i gjithë kësaj. Perëndia sundon mbi Satanin duke i lëshuar pe' atij aq sa për të përmbushur qëllimet e veta, sepse qëllimet e Perëndisë janë e kundërta e qëllimeve të Satanit edhe në të njëjtat përvoja vuajtjesh. Për shembull, autori i letrës së Hebrenjve, në kapitullin 12 u tregon lexuesve të vet se si nuk duhet t'i lëshojë zemra në persekutim për shkak të qëllimeve të dashurisë së Perëndisë.

Konsiderojeni Krishtin si *atë*, që duroi armiqësinë e mëkatarëve kundrejt tij, në mënyrë që të mos shqetësoheni dhe t'ju lëshojë zemra. Sepse nuk keni ardhur ende në momentin kur gjaku t'ju kullojë në betejën kundër mëkatit; dhe ndoshta ju ka dalë nga mendja porosia e dhënë ju dhe fëmijëve tuaj: «Biri im, mos e përçmo ndëshkimin e Zotit dhe mos urre qortimin e tij, sepse Zoti qorton atë që do, si një baba djalin që i pëlqen.» (Fjalët e Urta 3:11,12) Për shkak të disiplinës duhet të duroni... E gjithë kjo disiplinë për momentin nuk duket aq e këndshme, për më tepër e dhimbshme; por sërish ata që janë ushtruar në të, shumë shpejt do të vjelin frytet e paqta të drejtësisë...

Ja ku është vuajtja që buron nga «kundërshtimet e mëkatarëve.» Kjo do të thotë që vetë Satani ka dorë në të, njësoj si në vuajtjen e Jezusit (Luka 22:3). Sidoqoftë, një lloj i tillë vuajtjeje është përshkruar si i drejtuar nga Perëndia, si një mënyrë e planifikuar nga një dorë e dashur atërore për të të përsosur

në disiplinë. Kështu, Satani ka një plan për vuajtjen tonë në persekutim dhe nga ana tjetër është Perëndia që ka një plan krejt të ndryshëm për të njëjtën përvojë. Megjithatë nuk është vetëm persekutimi. Sepse kjo është e vërtetë edhe në rastin e sëmundjeve. Edhe në këtë rast, plani i Perëndisë dhe Satanit tregohet qartë në 2 Korintasve 12:7-10:

«... m'u dha një gjemb në mish, një engjell i Satanit, për të më rënë me grushte, që të më mbante larg forcimit tim. Lidhur me këtë, iu luta tri herë Zotit që ta largonte nga unë. Por ai më tha: «Hiri im të mjafton, sepse fuqia ime përsoset në dobësi.»

Prandaj, tepër i ngazëllyer do të mburresha më shumë në dobësitë e mia në mënyrë që fuqia e Krishtit të banojë në mua. Ndaj dhe ndihem aq rehat edhe në dobësitë, lëndimet, dhimbjet, persekutimet, vështirësitë, pikërisht për hir të Krishtit: sepse kur unë jam i dobët, atëherë jam edhe i fortë. Ja pse vuajtja fizike e Palit – gjembi në mish – është quajtur «engjelli i Satanit.» Ky plan vuajtjeje ishte që «ta mbante [Palin] larg përlëvdimit [të vetes]», gjë që kurrsesi nuk do të ishte pjesë e qëllimit të Satanit. Në këtë pikë mund të thuhet se Krishti përmbush qëllimin e vet të dashurisë dhe përsosurisë duke shkatërruar të gjitha përpjekjet rrënuese të Satanit. Satani është përherë në kërkim të mënyrave për të shkatërruar besimin tonë; Por Krishti lartëson fuqinë e vet në dobësitë tona.

A dallojnë vuajtja nga persekutimi dhe sëmundja?

Një arsye tjetër që pengon dallimin e qartë mes persekutimit dhe sëmundjes, është fakti se dhimbja nga persekutimi dhe dhimbja e sëmundjes jo gjithmonë janë të dallueshme. Dekada pas torturave të marra për shkak të Krishtit në burgjet Rumune, Riçard Vurmbandi vazhdon të vuajë fizikisht. A mos vallë po vazhdonte të «persekutohej» ndërsa duronte dhimbjet në shputën e këmbës

edhe pas tridhjetë vjetësh? Ose shih shembullin e apostullit Pal. Midis vuajtjeve që ai radhiste si «shërbëtor i Krishtit» ishte edhe rasti i mbytjes tri herë dhe kalimi i një dite dhe një nate në ujë. Ai përfshinte gjithashtu në vuajtjet e tij për Krishtin edhe «punën dhe guximin përmes shumë netëve pa gjumë në kohë urie dhe etjeje në shumicën e rasteve pa ushqim, në të ftohtë dhe i zhveshur.» (2 Korintasve 11: 25,27).

Mendo sikur Pali të sëmurej nga pneumonia për shkak të gjithë kësaj pune dhe ekspozimit ndaj këtyre kushteve. A do të konsiderohej pneumonia si pjesë e «persekutimit»? Pali nuk bëri ndonjë dallim midis rrahjes me thupër, aksidentit të varkës apo qoftë edhe ftohjes ndërsa udhëtonte nëpër qytete të ndryshme. Për të, çdo vuajtje që përjetonte ndërsa i shërbente Krishtit ishte pjesë e çmimit të dishepullizimit. Kur fëmija i ndonjë misionari sëmuret me diarre, e mendojmë këtë si pjesë të çmimit të besnikërisë. Por, edhe për çdo prind tjetër, që ecën në shtegun e bindjes ndaj Perëndisë konsiderohet e njëjta gjë. Vuajtja «me» dhe «për» Krishtin nuk ka të bëjë më shumë me qëllimet e armiqve tanë se sa me besnikërinë tonë. Nëse jemi të Krishtit, gjithçka që na ndodh është për lavdinë e tij dhe për të mirën tonë, pavarësisht se shkaktarët vijnë nga armiqtë apo enzimat, që shkaktojnë sëmundje fizike.

A është lakmia një alternativë për rilindje?

Kthehemi nga ky vështrim i shkurtër në deklaratën mahnitëse të Palit në 1 Korintasve 15:19, që jeta që ai ka zgjedhur do të kishte qenë për t'u mëshiruar nëse nuk do të kishte pasur ringjallje. Me fjalë të tjera Krishterimi, sipas të kuptuarit të Palit, nuk është mënyra më e mirë për të pasur maksimumin e kënaqësisë nëse jeta këtu (në tokë) është e vetmja që kemi. Pali na tregon mënyrën më të mirë për të marrë maksimumin e kënaqësive në këtë jetë. «Nëse të vdekurit nuk do të ringjallen, atëherë le të hamë e të pimë, sepse nesër do të vdesim.» (1 Korintasve 15:32) Ai nuk ka ndër mend diçka naive si epikurianizmi (*parimi i lumturisë së*

*madhe**) dhe pangopësia e dukshme. Nuk është kjo mënyra më e mirë për t'u përmbushur me kënaqësitë, siç e dinë më së miri ata që kanë qenë të alkoolizuar apo lakmitarë. Pijanecët dhe lakmitarët do të mëshiroheshin njësoj si të krishterët nëse nuk do të kishte ringjallje.

Por me shprehjen «le të hamë dhe të pimë» ai ka dashur të thotë që, pa shpresën e ringjalljes, njeriu duhet të rendë pas kënaqësive të jashtëzakonshme dhe të shmangë vuajtjet e pazakonta. Kjo është jeta që Pali e refuzoi si i krishterë. Ndaj, nëse të vdekurit nuk do të ringjallen, nëse nuk ka Perëndi dhe jetë të përjetshme në qiell, as ai nuk do ta kishte ndëshkuar trupin e tij ashtu siç bëri. Nuk do ta kishte refuzuar pagesën e bërjes së çadrave dhe as të duronte rrahjet me kamxhik. Nuk do të kishte rrezikuar jetën e vet nga grabitësit, duke kaluar në shkretëtirë dhe lumenj e dete, as nga turmat e zemëruara. Nuk kishte pse të pranonte të kalonte net pa gjumë në të ftohtë dhe i pa veshur. Nuk kishte pse të duronte përgjatë gjithë jetës së vet të krishterë hipokritë dhe të pabesë. (2 Korintasve 11:23-29) Në të kundërt, mund të kishte zgjedhur të jetonte një jetë të rehatshme dhe pa telashe si një hebre i respektueshëm me privilegjin e nënshtetësisë romake.

Kur Pali thotë: «Nëse të vdekurit nuk ringjallen, atëherë le të hamë dhe të pimë», ai nuk po thotë «Le të shthuremi!» Pali po thotë se ekziston një jetë normale, e thjeshtë, e qetë dhe me plot kënaqësi njerëzore, të cilat mund t'i shijojmë pa patur mendime shqetësuese mbi mëkatën apo shenjtërinë, për parajsën a ferrin apo për Perëndinë – *nëse* nuk ka ringjallje prej së vdekurish. Dhe ajo që më lë gojëhapur nga gjithë ky kalvar mendimesh është se shumë të ashtuquajtur të krishterë duket sikur fokusohen pikërisht te kjo gjë, dhe e quajnë Krishterim.

Pali nuk e konsideroi lidhjen e tij me Krishtin si çelësin për të rritur komoditetin dhe kënaqësinë fizike *në këtë jetë*. Jo, lidhja e Palit me Krishtin ishte thirrja për të zgjedhur vuajtjen – një vuajtje që shkon përtej asaj që e bën ateizmin të duket «kuptimplotë,

* Shënim i redaktorit- Epikurianizmi – Një sistem filozofik i mbështetur në mësimet e Epikurit, i cili besonte se *kënaqësia është e mira më madhore në jetë*.

«të mrekullueshëm» apo «heroik.» Vuajtja që zgjodhi Pali do të ishte krejtësisht marrëzi dhe e mjerueshme nëse nuk do të kishte ringjallje në praninë e gëzueshme të Krishtit.

Një akuzë gati e pabesueshme ndaj Krishterimit Perëndimor

Kjo ishte gjëja më e habitshme që vura re në historinë plot peshë të Vurmbrandit mbi abatin Cistercian. Në pikëpamjen rrënjësisht të ndryshme të Palit vura re një akuzë gati të pabesueshme ndaj krishterimit perëndimor. A mos po e teproj me këtë? Gjykoje vetë veten tënde! Sa të krishterë që një do të thoshin: «Jeta që kam zgjedhur si i krishterë do të ishte absolutisht marrëzi dhe e mëshirueshme nëse nuk do të kishte ringjallje?» Sa të krishterë ka që mund të thonë: «Vuajtja që kam zgjedhur vullnetarisht të përqafoj për shkak të Krishtit do të ma kishte bërë jetën të mjerë nëse nuk do të kishte ringjallje»? Nisur nga këndvështrimi im, këto janë pyetje tronditëse.

Krishterimi: Një jetë e zgjedhur për të vuajtur

Nëse shpresojmë në Krishtin vetëm në këtë jetë, jemi më të mjerët e të gjithë njerëzve.» (1 Korintasve 15:19) Jeta e krishterë për Palin ishte zgjedhje për sakrificë mbi këtë tokë në mënyrë që të fitojmë gëzimin e përbashkësisë me Krishtin në epokën që do vijë. Ja si e shihte ai:

«Por ato që më ishin fitim, i konsiderova humbje për shkak të Krishtit. Po me të vërtetë i konsideroj të gjitha humbje për madhështinë e njohjes së Krishtit Jezus, Zotit tim, për shkak të të cilit i humba të gjitha këto dhe i konsideroj si pleh, që të fitoj Krishtin. Dhe, që të gjendem në të, që ta njoh atë dhe fuqinë e ringjalljes dhe bashkësinë në vuajtjet e tij, duke u barazuar me vdekjen e tij, që në ndonjë mënyrë të mund t'ia arrij ringjalljes prej së vdekurish. «(Filipianëve 3:7-11)

Po e përsëris: thirrja e Krishtit është thirrja për të jetuar një jetë sakrifice, humbje dhe vuajtje, që do ish marrëzi ta jetoje nëse nuk do të kishte ringjallje prej së vdekurish. Kjo ishte zgjedhje e ndërgjegjshme e Palit. Dëgjoje «protestën» e tij: «Nëse vërtet të vdekurit nuk ringjallen... përse jam në rrezik në çdo orë? Përditë unë po vdes për shkak të mburrjes për ju, vëllezër, që ju kam në Krishtin Jezus, Zotin tonë.» (1 Korintasve 15:29–31). Këtë ka zgjedhur Pali. Ai «proteston», sepse nuk ka pse të jetojë në këtë mënyrë. Por tashmë e ka zgjedhur: «të rrezikojë çdo orë!» «Të vdesë çdo ditë!» Ja pse thotë se do të ishte i mjerë nëse nuk do të kishte ringjallje prej së vdekurish. Ai ka zgjedhur shtegun, që e çon në dhimbje dhe telashe pothuajse çdo ditë të jetës. «Përditë po vdes.»

Pse? Pse e bën ai këtë?

Kjo nuk është aspak normale. Njerëzit përpiqen t'i shmangen vuajtjes. Shpërngulemi në lagje më të sigurta. Zgjedhim zona me klimë më të përshtatshme. Blejmë kondicionerë. Marrim paracetamol. I largohemi shiut. Shmangim rrugicat me errësirë. Sterilizojmë ujin. Normalisht nuk zgjedhim një stil jete që do të na vinte «në rrezik çdo orë.» Jeta e Palit është larg zgjedhjeve të zakonshme të njerëzve. Në të vërtetë nuk ka asnjë slogan apo reklamë që të na joshë drejt vdekjes së përditshme. E pra, çfarë e shtyn apostullin Pal «të teprojë në vuajtjet e Krishtit» (2 Korintasve 1:5) dhe të bëhet «I marrë për hir të Krishtit» (1 Korintasve 4:10)? Përse Palit vendosi të duhej të zgjidhte që të ekspozohej ndaj «urisë, etjes, ... të zhveshurit, ...trajtimit të ashpër... të qenët pa shtëpi, ...fyerjes, ... përndjekjes, ... si pislleku i botës, porsì plehurat e të gjithëve deri më sot?» (1 Korintasve 4:11-13)?

«Do t'i tregoj sa shumë i duhet të vuajë»

Ndoshta ishte vetëm një mënyrë e thjeshtë bindjeje ndaj porosisë së Krishtit e shprehur në Veprat 9:15-16. Kur Jezusi dërgoi Ananian t'i hapte sytë Palit kur ai u verbua rrugës për në Damask, i tha:

«Shko, sepse ai (Pali) është zgjedhur si instrumenti im, për të treguar emrin tim para paganëve dhe mbretërve e bijve të Izraelit; sepse *do t'i tregoj atij sa shumë i duhet të vuajë për hir të emrit tim*. Me fjalë të tjera, vuajtja ishte pjesë e thirrjes së Palit. Dhe që të mbetej besnik me thirrjen e tij, Palit iu desh të përqafohte atë që i kishte dhënë Krishti, shumë vuajtje.

«Dhënë» është fjala e duhur. Sepse kur u shkroi Filipianëve, Pali çuditërisht e ka quajtur vuajtjen dhuratë, ashtu siç edhe besimi është një *dhuratë*. «Ju është dhënë (*echaristhë* = dhënë falas) për hir të Krishtit jo vetëm që të besoni në të, por edhe të vuani për shkak të tij.» (Filipianëve 1:29) Por kjo mund të kuptohet se «dhurata» e dhënë si pjesë e apostullimit të Palit nuk konsiderohet prej tij si diçka e dhënë vetëm atij dhe jo apostujve të tjerë. U është «dhënë» besimtarëve të Filipisë, të gjithë kishës.

Edhe të tjerë kanë bërë këtë zbulim të çuditshëm, se vuajtja është një dhuratë që duhet përqafuluar. Aleksander Solzhenitsi ka treguar për kohën që ka kaluar në burg si një dhuratë, që i ishte dhënë pavarësisht vuajtjeve të kaluara. «Vetëm atëherë kur shtrihesha në rrogazin e burgut ndieja brenda vetes trazimet e para të së mirës. Gradualisht, mu zbulua se kufiri mes së mirës dhe së keqes zhduket, jo përmes deklaratave, as përmes ligjëratave apo fushatave politike, por pikërisht përmes zemrës njerëzore – dhe përmes të gjitha zemrave njerëzore. ... Qofsh i bekuar o burg që u bërë pjesë në jetën time!»² Solzhenitsini bie dakord me apostullin Pal që vuajtja është – ose mund të jetë – një dhuratë jo vetëm për apostujt, por për çdo të krishterë.

Për të treguar që ai ishte i krishterë i zakonshëm

Lind pyetja: A e përqafoi Pali vuajtjen e tij sepse kjo do të konfirmonte që ai ishte thjesht një dishepull besnik i Krishtit? Jezusi ka thënë: «Nëse dikush dëshiron të më ndjekë, le ta mohojë veten, të marrë kryqin e tij çdo ditë e të më ndjekë. Sepse kushdo që do ta shpëtojë jetën e vet duhet ta humbasë, por kushdo që e humbet për shkakun tim, ka për ta gjetur. «(Luka 9:23.

24) Pra, nuk ka Krishterim të vërtetë pa mbajtjen e kryqit dhe «vdekjen» e përditshme, gjë që të sjell ndër mend atë që thotë Pali: «Vdes përditë» (1 Korintasve 15:31) Veç kësaj Jezusi u tha dishepujve, «Shërbëtori nuk është më i madh se i zoti. Nëse ata më persekutuan mua, do t'ju persekutojnë edhe ju. «(Gjoni 15:20) Ndaj do të ishte e pavend nëse Pali nuk do t'i kishte treguar vuajtjet e tij për shkak të Krishtit. Jezusi u dha dishepujve të tij një pamje ogurzezë të shërbesës së tyre. «Ja, po ju dërgoj si dele mes ujqërve. «(Luka 10:3) Ndaj dhe u premtoi: Dhe ju do t'ju tradhtojnë edhe prindërit, dhe vëllezërit, dhe farefisi e miqtë, dhe disa prej jush do t'i vrasin, dhe të gjitha kombet do t'ju urrejnë për shkak të emrit tim.» (Luka 21:16; Mateu 24:9).

Pa dyshim që Pali nuk i konsideroi këto premtime për vuajtjen si të kufizuara vetëm për të dymbëdhjetë apostujt, sepse në fakt ai ua kaloi ato kishave të tij. Për shembull, Pali forconte të sapoardhurit në besim duke u thënë: «Edhe përmes shumë vuajtjesh duhet të hyjmë në Mbretërinë e Perëndisë.» (Veprat 14:22) Ai inkurajoi bashkëvuajtësit besimtarë thesalonikas duke i këshilluar që «të mos shqetësoheshin nga mundimet që po hiqnin, sepse duhej ta dinin që kjo ishte parashikuar.» (1 Thesalonikasve 3:3). Kur i shkroi Timoteut, ai e bëri vuajtjen parim të përgjithshëm: «Në të vërtetë, kushdo që dëshiron të jetojë perëndishëm në Jezus Krishtin do të persekutohet.» (2 Timoteut 3:12) Ndërsa tregonte vuajtjet e tij, ai nuk i trajtoi si të vetmet, por u tha kishave: «Më imitoni mua» (1 Korintasve 4:16) E pra, duket më se e qartë që, duke përqafuar një jetë me vuajtje, Pali konfirmonte thjesht të qenët i Krishterë. «Nëse ata më persekutuan mua, do t'ju persekutojnë edhe ju!»

T'i çlirosh të krishterët nga ndjenja e vetëbesimit.

Meqënëse besonte se vuajtja ishte pjesë e jetës së një të Krishterit besnik, ai iu vu kërkimit të arsyes se, përse duhej të ishte ashtu. Përvoja e tij në vuajtje e çoi drejt mënyrave që përdor Perëndia në dashurinë për bijtë e tij. Për shembull, ai mësoi që Perëndia e përdor vuajtjen për të na çliruar nga ndjenja e vetëbesimit, duke

na afruar më shumë pranë vetes. Pas vuajtjes që pësoi në Azi, ai tha: «Sepse nuk duam, o vëllezër, që të mos dini për vështirësinë që na ngjau në Azi, që u rënduam përtej fuqive tona, aq sa u dëshpëruam edhe për vetë jetën. Për më tepër ne e kishim në veten tonë vendimin e vdekjes, që të mos besonim në veten tonë, por në Perëndinë që ringjall të vdekurit» (2 Korintasve 1:8,9). Ky është qëllimi universal i Perëndisë në lidhje me vuajtjen e të krishterëve. Më shumë kënaqësi në Perëndinë dhe më pak në veten dhe botën. Nuk kam dëgjuar askënd të thotë ndonjëherë: «Mësimin më të madh në jetën time e kam marrë në kohë rehatie dhe të qeta.» Përkundrazi, kam dëgjuar të thuhet nga goja e shenjtorëve të guximshëm: «Çdo përparim domethënës që kam bërë në rrokjen e dashurisë së thellë të Perëndisë dhe në rritjen e marrëdhënies me të ka kaluar përmes vuajtjes.» Samuel Radherfordi ka thënë dikur se, sa herë kishte qenë i zënë rob në bodrumet e vuajtjes, kujtonte që Mbreti i Madh e mbante gjithmonë verën në atë vend. Ndërsa Çarls Spurxhëni ka thënë se ata që zhyten në detin e vuajtjes zbulojnë vetëm perla të rralla.

Të lartësohet Krishti si kënaqësia më e mrekullueshme

Perla e çmimit më të lartë është lavdia e Krishtit. Ndaj edhe Pali thekson se në vuajtjet tona lartësohet lavdia e Krishtit përmes hirit të gjithëmjaftueshëm. Nëse besojmë tek ai në kohën e fatkeqësisë sonë dhe ai e mbështet «gëzimin tonë në shpresë», atëherë Ai, e tregon veten se është Perëndia i gjithë kënaqshëm i hirit dhe fuqisë. Nëse kapemi fort pas tij «kur gjithçka rreth shpirtit tonë ka hequr dorë tashmë», atëherë tregojmë që ai është më i dëshirueshëm se gjithçka tjetër që kemi humbur. Krishti u tha apostujve që vuanin: «Hiri im ju mjafton, sepse *fuqia (ime) përsoset në dobësi.*» Pali iu përgjigj kësaj: «Prandaj, me kënaqësi të madhe do të krenohem më tepër për dobësitë e mia, *që fuqia e Krishtit të banojë tek unë.* Ndaj, unë kënaqem në dobësi, në fyerje, në nevoja, në përndjekje, në ngushtica për shkak të Krishtit, sespe, kur jam i dobët, atëherë jam i fortë.» (2 Korintasve 12:9,10) Kështu pra vuajtja është

përcaktuar nga Perëndia jo vetëm si një mënyrë për të larguar të krishterët nga vetja dhe për t'i çuar drejt hirit, por edhe si mënyrë për ta ndriçuar këtë hir dhe ta bëjë të shkëlqejë. Kjo është pikërisht ajo që bën besimi: lartëson hirin e ardhshëm të Krishtit.

Gjërat më të thella në jetën me Perëndinë janë zbuluar përmes vuajtjes. Kështu ndodhi edhe me Jezusin. Edhe pse ishte Biri, Jezusi mësoi bindjen përmes vuajtjes që kaloi (Hebrenjve 5:8) Në të njëjtën letër na thuhet që Jezusi nuk mëkatoi (Hebrenjve 4:15). «Të mësosh bindjen» s'do të thotë thjesht të ndryshosh nivelin nga mosbindja në bindje. Do të thotë të rritesh sa më shumë në përvojën tënde të bindjes në jetën me Perëndinë.; Do të thotë të përjetosh thellësitë e nënshtrimit ndaj Perëndisë, që ndryshe nuk do të të kërkoheshin.

Fjalët e Patregueshme të Vuajtjes së krishterë

Ndërsa Pali sillte ndër mend shtegun e Zotit të tij, hodhi hapat e parë ta ndiqte. Por edhe në këtë pikë, jam çuditur shumë me fjalët e tij. Kur përshkruan marrëdhënien e vuajtjeve të Krishtit me vuajtjet e tij, thotë atë që duket e patregueshme. Ai i thotë kishës së Kolosianëve: «Tani gëzohem në vuajtjet e mia, të cilat po i heq për shkakun tuaj dhe po e plotësoj në mishin tim atë që u mungon mundimeve të Krishtit për trupin e vet, që është kisha»(Kolosianëve 1:24). Ky mund të ketë qenë motivi më i fuqishëm që Pali të zgjidhte jetën me vuajtje. Këto fjalë më kanë mbushur me dëshirën e madhe për Kishën e Jezus Krishtit. O sikur të mund t'i përfaqonim vuajtjet e nevojshme të caktuara për përparimin e mbretësisë së Krishtit në botë!

Si mund t'i plotësojmë vuajtjet e Krishtit?

Çfarë ka dashur të thotë Pali me, «po e plotësoj atë që u mungon vuajtjeve të Krishtit?» A mos është një nënvlerësim i patregueshëm i vlerës shlyese dhe gjithëmjaftuese të vdekjes së Jezusit? A nuk e tha vetë Jezusi kur vdiq «U krye!» (Gjoni 19:30)? A nuk është e vërtetë që «me një ofertë të vetme, ai i bëri të përsosur për

gjithnjë ata që shenjtërohen»? (Hebrenjve 10:14) Dhe që «hyri *përgjithmonë* në shenjtërore, jo me gjakun e cjepve dhe të viçave, por me gjakun e vet, dhe fitoi një shpëtim *të amshuar*» (Hebrenjve 9:12)? Pali e dinte, dhe për këtë mësoi edhe të tjerët që mundimet e Krishtit ishin baza e plotë dhe e mjaftueshme e shfajësimit tonë. Ne jemi «të shfajësuar përmes gjakut të tij» (Romakëve 5:9). Pali na mëson se Krishti zgjodhi vuajtjen duke qenë «I bindur deri në vdekje» (Filipanëve 2:8) Kjo bindje për vuajtje ishte baza e gjithëmjaftueshme për drejtësinë tonë para Perëndisë. «Në fakt, ashtu si nga mosbindja e një njeriu të vetëm (Adamit), të shumtët u bënë mëkatarë, ashtu edhe nga bindja e një të vetmi (Krishtit) të shumtët do të bëhen të drejtë» (Romakëve 5:19) Pra, Pali nuk do të thotë që vuajtjet e tij plotësojnë vlerën shlyese të vuajtjeve të Jezusit.

Ja dhe një interpretim më i mirë. Vuajtjet e Palit plotësojnë vuajtjet e Krishtit *jo* duke u shtuar gjë vlerës së tyre, por duke i shtrirë ato drejt njerëzve që ato (*vuajtjet e Krishtit*) janë paracaktuar të shpëtojnë. Ajo që i mungon vuajtjeve të Krishtit nuk është pamjaftueshmëria në vlerë, sikur nuk do ia arrinin të mbulonin mëkatet e të gjithë atyre që besojnë. Ajo që mungon është se vlera e pafund e vuajtjeve të Krishtit nuk është njohur dhe pranuar në mbarë botën. Këto vuajtje dhe ajo që nënkuptojnë në të vërtetë janë akoma të fshehura për shumicën e njerëzve. Qëllimi i Perëndisë është që misteri t'u zbulohet mbarë kombeve. Kështu pra, vuajtjet e Krishtit kanë «mungesë» në kuptimin që nuk janë njohur dhe pranuar në mbarë njerëzimin. Ato duhet të mbarten nga shërbyesit e fjalës. Dhe këta shërbyes të fjalës «plotësojnë» atë që mungon në vuajtjet e Krishtit duke e shpërndarë atë tek të tjerët.

Çelësi është tek Epafroditi

Këtë interpretim na e konfirmojnë edhe fjalët e përdorura te Filipianëve 2:30. Në kishën e Filipisë ishte një njeri i quajtur Epafroditi. Kur kisha mblodhi ndihma për Palin (ndoshta para, libra ose ushqime) vendosën t'ia dërgonin në Romë me Epafroditin.

Gjatë udhëtimit të tij me gjithçka që kishte me vete, Epafroditit pothuajse humbi jetën. U sëmur për vdekje, por Perëndia e kurseu. (Filipianëve 2:27)

Ndaj Pali i thotë kishës në Filipi që ta nderonin Epafroditin kur të kthehej (v 29) duke e shpjeguar këtë me të njëjtat fjalë që thotë te Kolosianëve 1:24: «Sepse për veprën e Krishtit ai qe shumë afër vdekjes, duke vënë në rrezik jetën e vet për të *përmbushur* (fjalë e ngjashme me atë të përdorur te Kolosianëve 1:24) *zbrazëtitë* (e njëjta fjalë e përdorur edhe te Kolosianëve 1:24) e shërbesës suaj ndaj meje.» Në origjinal, fjalia «për të përmbushur zbrazëtinë e shërbesë suaj ndaj meje është gati e njëjtë me «për të përmbushur atë që u mungon vuajtjeve të Krishtit.»

Atëherë çfarë nënkuptonte «zbrazëtia» e shërbesës së Filipianëve ndaj Palit dhe si e «përmbushi» këtë Epafroditit? Njëqind vjet më parë, një komentues bible i quajtur Marvin Vincent e ka shpjeguar kështu:

«Dhurata që iu dha Palit ishte dhurata për gjithë kishën si një trup i vetëm. Ishte ofertë sakrifikuese e dashurisë. Ajo që mungonte dhe për të cilën Pali dhe vetë kisha do t'i ishin mirënjohës, ishte shfaqja e kishës në këtë lloj oferte përmes një personi. Por kjo dukej e pamundur, ndaj edhe Pali e paraqet Epafroditin si atë, që e plotësonte këtë mungesë përmes shërbesës së tij të zellshme dhe plot dhembshuri.³

Mendoj se të njëjtin kuptim mbartin fjalët te Kolosianëve 1:24. Krishti kishte përgatitur një ofertë dashurie për botën përmes vuajtjes dhe vdekjes së tij për mëkatarët. Është e plotë dhe nuk i mungon asgjë – përveç diçkaje, shfaqjes personale të Krishtit ndaj kombeve të mbarë botës. Përgjigjja e Perëndisë ndaj kësaj mungese është t'i thërrasë njerëzit e Krishtit (sikurse Palin) për të dhënë një prezantim personal të vuajtjeve të Tij para botës. Duke bërë kështu, ne «plotësojmë atë që mungon në vuajtjet e Krishtit», kryejmë atë që është përcaktuar, duke ua treguar personalisht njerëzve, që nuk e njohin vlerën e pafund të vuajtjeve të Krishtit.

Të mbushësh mundimet me mundime të tjera

Por gjëja që të mahnit më shumë mbi Kolosianëve 1:24 është se si Pali plotëson mungesën e mundimeve të Krishtit. «Gëzohem në vuajtjet e mia për shkakun tuaj dhe plotësoj në mishin tim atë që u mungon mundimeve të Krishtit.» Kjo nënkupton që Pali i shfaq mundimet e Krishtit duke vuajtuar për shkak të atyre që kërkon të fitohen, që në vuajtjet e tij ata të shohin vuajtjet e Krishtit. Ja edhe përfundimi që të lë pa frymë: *Perëndia do që vuajtjet e Krishtit të paraqiten para botës përmes vuajtjeve të njerëzve të vet.* Është e vërtetë që Perëndia do që trupi i Krishtit, Kisha, të përjetojë disa prej vuajtjeve të Tij në mënyrë që kur të shpallë kryqin si rrugën e jetës, njerëzit t'i dallojnë plagët e kryqit në ne dhe të ndiejnë dashurinë e kryqit përmes nesh. Thirrja jonë është që të bëjmë reale te njerëzit mundimet e Krishtit përmes vuajtjeve që kalojmë, për t'u përçaruar atyre mesazhin e shpëtimit. Meqë Krishti nuk qëndroi gjatë mbi tokë, ai do që trupi i vet, Kisha, të zbulojë vuajtjet e tij në vuajtjet e veta. Dhe, meqë ne jemi trupi i tij, vuajtjet tona janë vuajtjet e tij. Pastori rumun, Jozef Tsoni, e thotë në këtë mënyrë: «Unë jam një shtesë e Jezus Krishtit. Kur jam rrahur në Rumani, ai vuajti në trupin tim. Nuk ishte vuajtja ime: unë vetëm pata nderin t'i mbartja vuajtjet e tij.»⁴

Prandaj vuajtjet tona dëshmojnë dashurinë që ka Krishti për botën.

«Unë mbaj në trupin tim shenjat e Jezusit»

Ja pse Pali foli për plagët e tij si «shenjat e Jezusit.» Në plagët e tij, njerëzit mund të shihnin plagët e Jezusit. «Unë mbaj në trupin tim shenjat e Jezusit» (Galatasve 6:17) Arsyeja e bartjes së shenjave të Jezusit është që Ai të bëhet i njohur dhe dashuria e tij të punojë fuqishëm tek ata që shohin. «Kurdo e mbajmë në trupin tonë vdekjen e zotit Jezus, që edhe jeta e Tij të shfaqet në trupin tonë. Ne që jetojmë, jemi vazhdimisht të dorëzuar në vdekje për Jezusin, që edhe jeta e Tij të shfaqet në mishin tonë të vdekshëm. Dhe kështu te ne vepron vdekja, ndërsa te ju jeta.» (2 Korintasve 4:10-12)

«Gjaku i martirëve është Fara (e mesazhit)»

Historia e përhapjes së krishterimit ka provuar që «gjaku i martirëve është fara» – fara e jetës së re në Krishtin që përhapej nëpër botë. Për afërsisht treqind vjet, krishterimi është rritur në një tokë të vaditur me gjakun e martirëve. Në librin e tij, «*Historia e misioneve të krishtera*», Stefan Nejl i përmend vuajtjet e të krishterëve të hershëm si një prej gjashtë arsyeve të rritjes së menjëhershme të kishës.

Për shkak të situatës së rrezikshme përballë ligjit ekzistues të kohës, të krishterët ishin të detyruar të takoheshin në mënyrë të fshehtë ... Çdo i krishterë e dinte me siguri që herët e vonë do t'i duhej të dëshmonte besimin e vet duke rrezikuar jetën ... Kur shpërtheu persekutimi ndaj të krishterëve, martirizimi do të shoqërohej me publicitetin më të madh të mundshëm. Publiku romak ishte i ashpër dhe mizor, por jo pa asnjë pikë dhemshurie. Dhe s'kishte dyshim që qëndrimi i martirëve, sidomos i grave që vuajtën krahas burrave, e preku thellë këtë publik. Në të dhënat e hershme, gjejmë një sjellje të qetë, plot dinjitet e të hijshme të të krishterëve. Kurajë të lartë përballë torturave çnjerëzore, mirësjellje përballë armiqve dhe një miratim të gëzueshëm të vuajtjeve si një mënyrë e caktuar prej Zotit drejt mbretërisë së tij qiellore. Ka një numër të vërtetuar më së miri të rasteve të kthimit në besim të paganëve, pikërisht në momentin e ndëshkimit dhe vdekjes së të krishterëve, Duhet të kenë qenë akoma dhe më shumë ata që mbartën mbresa të këtyre dëshmimeve që gjatë rrjedhës së kohës do të ktheheshin në besimin e gjallë.⁵

«Si mund të blasfemoj Mbretin tim që më shpëtoi?»

Një prej shembujve më të fuqishëm të dëshmisë përmes vuajtjes ishte martirizimi i Polikarpit (Polycarp), peshkopit të Smirnës, i

cili vdiq në vitin 155 pas Krishtit. Nxënësi i tij, Irenaeus, ka thënë se Polikarpi ka qenë nxënës i apostullit Gjon. Ai vdiq shumë i vjetër në moshë dhe për këtë na dëshmon fakti, që kur Prokonsulli e urdhëroi të hiqte dorë dhe të mallkonte Krishtin, ai iu përgjigj: «Tetëdhjetë e gjashtë vjet i kam shërbyer atij dhe nuk më ka bërë asnjë gjë të keqe, ndaj si mund të blasfemoj mbretin tim që më shpëtoi?»⁶

Gjatë sezonit të persekutimit, turma e tërbuar në Smirnë bërtiste me të madhe kundër Polikarpit. Ai u shpërngul në një fshat jashtë qytetit dhe tri ditë para se të vdiste pati një ëndërr prej së cilës nxori këtë përfundim: «Duhet të digjem i gjallë.» Kështu që kur e kapën, në vend që t'ia mbathte, tha: «Le të bëhet vullneti i Perëndisë.» Nga të dhënat e lashta të martirizimit vjen kjo dëshmi:

«Pasi dëgjoi hapat të vinin për ta marrë, ai zbriti poshtë dhe foli me ta ndërkohë që të gjithë të pranishmit u mrekulluan me plakun, që nuk kishte ndryshuar qëndrim edhe pse kundër tij bëhej një potere e madhe. Më pas, plaku urdhëroi që t'u shërbehej me diçka për të pirë dhe ngrënë mysafirëve të ardhur, sipas dëshirës së tyre. Ndërkaq u kërkoi ta lejonin përreth një orë që të mund të lutej i qetë dhe i lirë. Pasi e lejuan, ai u ul dhe u lut, duke qënë kaq i mbushur me hirin e Perëndisë saqë për dy orë vazhdoi të rrezatonte një paqe që nuk mundte ta mbante mbi vete, ndërsa ata që e dëgjonin u mahnitën dhe u penduan që kishin ardhur të arrestonin një njeri të nderuar si ai plak i urtë.»⁷

Kur u mor dhe u dënua të hidhej në zjarr i gjallë, ata u përpoqën ta gozhdonin pas drurit, por ai kundërshtoi duke thënë: «Më lini siç jam. Ai që do lejojë të duroj këtë zjarr mbi vete, do të bëjë që edhe të duroj pa u gozhduar pas turrës së druve.»⁸ Kur u duk sikur trupi i tij nuk po konsumohej nga zjarri, një prej xhelatëve e qëlloi me thikë. Nga raporti i lashtë thuhet; «Gjithë turma e mbledhur e njerëzve u mahnit nga ndryshimi i thellë midis jobesimtarëve dhe të zgjedhurit»⁹. Ne këtë shkallë të gjerë shpjegohet triumfi i Krishterimit në shekujt e parë. Ata triumfuan përmes vuajtjeve

që hoqën. Këto vuajtje jo vetëm shoqëruan dëshminë e tyre, por u bënë guri vulosës i tyre. «Dhe ata e mundën atë (Satanin) me anë të gjakut të Qengjit dhe me anë të fjalës së dëshmisë së tyre; dhe nuk e deshën jetën e tyre deri në vdekje.» Zbulesa 12:11)

Nuk kryhet derisa numri i martirëve të plotësohet

Nuk është thjesht një shtojcë e historisë që kisha u përhap dhe u forcua përmes vuajtjes dhe martirizimit. Është mënyra si e kishte menduar vetë Perëndia. Një prej evidencave më domethënëse mbi atë çka Perëndia ka caktuar për të përmbushur qëllimet e tij të shpëtimit të botës përmes vuajtjes gjendet në librin e Zbulesës. Pamja që na jepet është vizioni i qiellit, ku shpirtrat e martirëve bërtasin, «Dhe sa gjatë o Zot? «Me fjalë të tjera, “Kur do të plotësohet historia dhe të përmbushen qëllimet e tua të shpëtimit dhe gjykimit?’ Dhe përgjigjja është ogurzezë për të gjithë ne që duam të jemi pjesë e përmbushjes së Porosisë së Madhe. «Dhe secilit prej tyre iu dha një petk i bardhë dhe iu thanë që të preheshin edhe për pak kohë, derisa të plotësohej numri edhe i bashkëshërbëtorëve dhe vëllezërve të tyre, që duhej të vriteshin porsia ata.» (Zbulesa 6:11)

Kjo do të thotë që Perëndia ka planifikuar të përmbushë qëllimet e veta, duke parashikuar një numër të caktuar martirësh. Dhe kur të plotësohet ky numër, atëherë do të vijë fundi. Xhorxh Otisi e tronditi shumicën e të pranishmëve në Kongresin e dytë të Lausanës për Ungjillëzimin e Botës të organizuar në Manila në vitin 1989 kur i pyeti: «A mos vallë kemi dështuar në vendet myslimane, sepse nuk kemi më martirë? «A mund të forcohet një kishë e maskuar? A ka nevojë një kishë e re për modelë martirësh? «Dhe ai e jep përgjigjen e duhur në përfundim të librit të vet «*I fundit i Gjigantëve*», në kapitullin «Siguri e rrezikshme.»

A duhet të qëndrojmë e maskuar kisha para politikës dhe shoqërisë për të shmangur çrrënjosjen e mundshme nga armiqtë e krishterimit? Apo duhet të përballim më haptazi

me injorancën shpirtërore aktuale pasojë e së cilës është humbja – edhe nëse kjo do kërkonte martirë të krishterë, të cilët me siguri do të çonin në zbulime të fuqishme ungjillëzuese? Fundamentalistët islamikë pretendojnë që revolucioni i tyre shpirtëror e merr burimin e fuqisë nga gjaku i martirëve. A mund të jetë e besueshme që dështimi i të krishterëve në botën myslimane ndodh për shkak të mungesës së martirëve? Dhe, a mund ta marrë seriozisht komuniteti mysliman pretendimin e një kishe që qëndron në fshehtësi?...Pyetja nuk është nëse është gjë e mençur të mbahet adhurimi dhe dëshmia në fshehtësi, por sa gjatë do vazhdojmë në këtë gjendje para se të bëhemi fajtorë që po e fshehim dritën tonë nën «babunë»? ...Nga dëshmia që na vjen nga historia prej Jeruzalemit deri në Damask dhe prej Efesit në Romë, apostujt u rrahën, u përzunë me gurë, u organizuan komplete kundër tyre dhe u burgosën për dëshminë e tyre. Ftesat ishin të rralla, dhe asnjëherë nuk përbënin bazën e misionit të tyre.¹⁰

Otisi pa dyshim që nuk binte dakord me Gregorin e Madh (Papa në kohën e viteve 590 – 604) kur u shpreh: «Vdekja e martirëve lulëzon në jetët e atyre që janë besnikë.»¹¹

Gjaku u derdh nga plagët tona si një shatërvan

Në ditët tona ka shembuj të panumërt të atyre, që *zgjodhën* vuajtjen sipas qëllimit të Kolosianëve 1:24 – për të plotësuar atë që mungon në mundimet e Krishtit, duke e paraqitur Atë të të tjerët përmes vuajtjes.¹² Ndërsa po shkruaja këtë kapitull në fund të vitit 1955, më tërhoqi vëmendjen një letër e një misionari, ku përshkruheshin vuajtjet e tij. I dërgova një email të shpejtë atij misionari në Afrikë për të konfirmuar faktet. Ai foli personalisht me Dansën, personin që kishte qenë i burgosur, dhe i mori leje që ta përdorja historinë e tij.

Rreth viteve 1980, erdhi një kohë e rëndë persekutimi nga zyrtarët lokalë të qeverisë komuniste në zonën e *Wolayta*. Punoja në një zyrë shteti, si edhe shërbeja si drejtues i një shoqate të rinjsh të krishterë, që mbulonte gjithë kishat e asaj zone. Zyrtarët komunistë vinin vazhdimisht tek unë për të më kërkuar t'i ndihmoja t'u mësonin doktrinën e revolucionit të rinjve. Shumë të krishterë ishin dorëzuar duke ndihmuar me këtë gjë, sepse presioni ishte i madh, por unë vetëm sa i përcillja me një "jo". Në fillim, ata m'u afruan pozitivisht duke më joshur me ngritje në detyrë dhe page. Por më pas, gjërat ndryshuan duke filluar me burgime. Dy të parat ishin të shkurtra në kohë. Burgimi i tretë zgjati një vit të tërë. Gjatë kësaj kohe, kuadrot komunistë përdornin metodën e shpëlarjes së trurit për nëntë ne besimtarët, (gjashtë burra dhe tre gra – njëra prej të cilave do të bëhej më vonë bashkëshortja ime) të cilët ishin burgosur në një qeli. Por kur njëri prej policëve u kthye në Krishtin, ne u rrahëm dhe u detyruam të punonim në punë të rënda, si të mbartnim ngarkesa të rënda me ujë në distanca të largëta, si edhe të spastronim fushat e fermave nga gurët e rëndë.

Periudha më e vështirë ka qenë gjatë një kohe prej dy javësh, kur oficeri do na zgjonte shumë herët pa gdhirë dhe do na detyronte të ecnim me gjunjët e zhveshur për 1.5 kilometra në një rrugë me zhavorr. Kjo gjë zgjaste për tri orë rresht. Pas ditës së parë, gjaku na vërshoi nga plagët si shatërvan, por ne nuk ndjemë gjë. Në një rast tjetër, një prej oficerëve më të egër na detyroi të shtriheshim me kurriz përballë diellit zhuritës për gjashtë orë. Nuk e mbaj mend se pse i thashë atij, por kur mbaruam i thashë: «Ti bëre që rrezet e diellit të na theknin dhe të na godisnin, por Perëndia ka për të të goditur ty.» Nuk kaloi shumë dhe oficeri pati probleme të rënda me diabetin dhe vdiq. Disa vjet më vonë, kur qeveria komuniste ra, kryeoficeri na ftoi të shkonim dhe të predikonim në burg. Atë kohë, dymbëdhjetë të burgosur për vrasje pranuan Krishtin. Ne vazhduam të shërbenim

në burg dhe tani janë bërë 170 besimtarë. Edhe shumica e oficerëve në burg janë kthyer në besim.

Vetëm Perëndia mund t'i bashkojë të gjithë faktorët që kanë rezultuar në kohë të pashlyeshme në të korrat e burgut, midis të burgosurve dhe oficerëve të burgut. Sigurisht që do të ishte pa vend të mendohet se vuajtja e Dansës nuk ishte pjesë e shfaqjes së realitetit të Krishtit në jetët e atyre që besuan.

Të rënë në pozitë për Krishtin dhe Shpëtimin

Jozef Tsoni ka menduar thellë në lidhje me çështjen e vuajtjes mënyra për ta shfaqur Krishtin para botës. Ai ishte pastor i Kishës së Dytë Baptiste në Oradea të Rumanisë deri në vitin 1981, kohë kur u dëbua nga vendi nga qeveria në fuqi. E kam dëgjuar të interpretojë Kolosoanëve 1:24 se vuajtjet e Krishtit janë për *pajtim*, ndërsa vuajtjet tona janë për *shumim*. Ai vë në dukje që, jo vetëm te Kolosianëve 1:24, por edhe te 2 Timoteut 2:10 vuajtja dallohet si një mënyrë ungjillëzimi:

«Pra, unë i duroj të gjitha për shkak të të zgjedhurve, që ata të kenë shpëtimin që është në Krishtin Jezus, bashkë me lavdi të përhjetshme.» Sipas Jozef Tsonit, Pali ka dashur të thotë se; nëse do të kisha qëndruar pastor në Antioki, në atë vend të begatë dhe të paqtë, në atë kishë të mrekullueshme me aq shumë profetë dhe bekime të panumërta, atëherë askush në Azinë e vogël ose Evropë nuk do të ishte shpëtuar. Që ata të shpëtoheshin, m'u desh të pranoja të rrihesha me thupër, të fshikullohesha, të përzihesha me gurë, të trajtohesha si llumi i botës duke u kthyer në një hije vdekjeje që ecte. Por duke ecur kështu, i plagosur dhe gjakosur, njerëzit mundën të shihnin dashurinë e Perëndisë, të dëgjonin mesazhin e kryqit dhe të shpëtoheshin. Sa të tjerë nuk janë shpëtuar për shkak se ne nuk i dorëzohemi kryqit?¹³

Ai na ilustron se si vetë vuajtja e të krishterëve mund të shërbejë shpesh si një mënyrë e frytshme ungjillëzimi. Ishte një njeri me një pozitë të lartë shoqërore, që e kisha pagëzuar dikur, i cili erdhi një ditë tek unë dhe më pyeti:

«Çfarë duhet të bëj? Do të mblidhen tre a katër mijë njerëz për të më vënë para dhe për t'u tallur me mua. Do më japin vetëm 5 minuta kohë që të mund të mbroj veten. Çfarë duhet të bëj?» «Vëlla,» – i thashë – «të mbrosh veten është e vetmja gjë që nuk mund ta bësh. Ky është çasti i vetëm që t'u tregosh se kush ke qenë në fillim dhe kush u bëre për shkak të Krishtit. Kush është Krishti për ty tani? Fytyra e tij ndriçoi dhe ai tha: «Vëlla Jozef, tani e di se çfarë duhet të bëj.» Dhe ai ashtu bëri – aq mirë e bëri sa që e zbritën shumë në detyrë. Humbi gati gjysmën e pagës. Megjithatë, erdhi më pas tek unë dhe më tha: «Vëlla Jozef, mund ta marrësh me mend që nuk mund të eci më në atë fabrikë pa u ndalur nga dikush. Kudo që të shkoj, do të jetë dikush që do më tërheqë në ndonjë qoshe duke parë andej-këtej se mos e vë re njeri, duke folur me mua dhe të më pëshpërisë, “Më trego ku është kisha jote”, “më trego më shumë për Jezusin”, ose “a ke ndonjë Bibël për mua?”» Çdo lloj vuajtjeje mund të kthehet në shërbesë për shpëtimin e të tjerëve.¹⁴

Të zgjedhësh të vuash për hir të Kombeve

Si konkluzion, kur Pali tha: «Nëse shpresojmë vetëm në këtë jetë në Krishtin, atëherë jemi më të mjerët», ai kuptonte që krishterim do të thotë të zgjedhësh dhe të përqafosh një jetë në vuajtje për Krishtin, që do të ishte e mjerueshme nëse Krishti do të ishte mashtrim. Krishterimi nuk është ajo lloj jete, që dikush do ta zgjidhte, një jetë me bollëk dhe kënaqësi pa shpresën e bashkimit me Të në ringjallje. Nuk ka të bëjë vetëm me dëshminë tonë në Krishtin, por është një shprehje e dukshme e saj. Vuajtjet tona i bëjnë të dukshme dhe të njohura vuajtjet e Krishtit në mënyrë që njerëzit të mund të shohin dashurinë që Ai u ofron. Ne i plotësojmë

këto mundime të Krishtit duke siguruar atë që u mungon, një njohje personale, jetësore atyre që nuk e njohin vuajtjen e Krishtit. Nënkuptimi befasues është se qëllimet e shpëtimit të Krishtit për kombet, ashtu si edhe për lagjen ku jetojmë, nuk kanë për t'u përmbushur, derisa të krishterët të zgjedhin të vuajnë në emër të tij. Fundi ekstrem i kësaj vuajtjeje nuk ka ardhur ende, derisa të plotësohet numri i martirëve (Zbulesa 6: 11) Pa përmbushjen e kësaj, s'do të mund të mbulohet e gjithë bota me ungjillëzimin. Nga ana tjetër, duhet të jetë më pak e kushtueshme në kohë, para dhe lehtësira të tjera, si edhe në përpjekjet për të zëvendësuar kohën e lirë me veprat e një dashurie që di të shërbejë. «Le të shkëlqejë drita jote dhe njerëzit të mund të shohin veprat e mira që ke bërë dhe t'i japin lavdi Atit tonë në qiell.» (Mateu 5:16)

A është ky hedonizëm i krishterë?

E titullova këtë kapitull «Vuajtja: sakrificë e hedonizmit të krishterë» edhe pse (diku tjetër) kam cituar David Livingstonin, që thoshte se vuajtjet e tij gjatë shërbesës misionare nuk mund të quheshin «sakrificë.» Nuk ka ndonjë kontradiktë me Livingstonin. Edhe pse fjalët duken si të tilla, konteksti është kryesor. Kur ai thotë që vuajtja nuk është sakrificë, nënkupton që bekimet janë më të mëdha se humbjet. Kur unë them që vuajtja nuk është sakrificë, kam ndër mend që ka humbje, shumë humbje. Ndërkaq, në nënkuptimin e fjalëve të mia, përfshij bekimet si më të mëdha.

Do ta ruaj fjalën sakrificë për më vonë. Dhimbja është shumë e madhe, humbjet janë aq reale që të mund të pretendojmë se mund të flasim në termat e jo- sakrificës. Duhet t'i mbajmë përcaktimet të qarta. Dhe përgjigjja ime është po, ky është hedonizmi i krishterë. I gjithë Testamenti i Ri e trajton vuajtjen në kontekstin e hedonistit të krishterë. A kishte Pali gëzim të thellë dhe të qëndrueshëm kur zgjodhi të vuante aq shumë, sa ndryshe do të ishte konsideruar tërësisht i marrë dhe i mjerë nëse nuk do të kishte ringjallje prej së vdekurish? Vetë pyetja e jep dukshëm përgjigjen. Nëse është vetëm ringjallja ajo që e shtyn Palin të bëjë këtë lloj zgjedhjeje të dhimbshme jetësore e jo të mëshirshme, por për t'u lavdëruar

(dhe të realizueshme!), atëherë është pikërisht shpresa e tij dhe kërkimi për këtë ringjallje, që e bëjnë të qëndrueshëm dhe të fortë në vuajtje. Në fakt, pikërisht këtë thotë: «Ai i konsideron të gjitha privilegjet e zakonta njerëzore si humbje "që të njoh atë (Krishtin), fuqinë e ringjalljes së tij dhe pjesëmarrjen në mundimet e tij, duke u bërë vetë i ngjashëm me të në mundimet e tij, që në ndonjë mënyrë të mund t'ia arrij ringjalljes prej së vdekurish."»(Filipianëve 3:10,11) Qëllimi i tij është të jetojë dhe vuajë për të siguruar ringjalljen prej së vdekurish.

Të japësh gjithçka për të fituar Krishtin

Pse? Sepse ringjallje do të thotë bashkësi e plotë, e përjetshme me Krishtin. Ky është thelbi i shpresës së Palit: «Dhe me të vërtetë i konsideroj të gjitha këto humbje në krahasim me vlerën e lartë të njohjes së Jezu Krishtit (Filipianëve 3:8) Të fituarit e Krishtit ishte pasioni më i lartë i Palit dhe qëllimi i tij në gjithçka që bëri. «Sepse për mua, të jetuarit është Krishti dhe të vdekurit fitim» (Filipianëve 1:21) Fitim! Fitim! Ky ishte qëllimi i jetës së tij në vuajtje. Pali «dëshironte të ikte nga ajo çadër dhe të ishte bashkë me Krishtin, *gjëja më e mirë*» (Filipianëve 1:23). «Gjëja më e mirë» nuk është një motiv altruist. Pali dëshironte atë që do t' i sillte kënaqësinë më të thellë dhe më të qëndrueshme të jetës së vet, që të bënte pjesë në lavdinë e Krishtit.

Por jo i vetëm në lavdinë e Krishtit!

Asnjë që njeh dhe e do Krishtin nuk është i kënaqur që të jetë i vetëm me të. Kulmi i lavdisë së tij është: «... ti u there dhe me gjakun tënd na bleve te Perëndia nga çdo fis, gjuhë, popull dhe komb.» (Zbulesa 5:9). Nëse ky është kulmi i faljes së lavdishme të Krishtit, atëherë ata që e llogarisin fitoren e pafund nuk mund ta jetojnë si kënaqësi private. Kur Pali tha që çdo gjë e konsideronte si humbje në mënyrë që të fitonte Krishtin, gjithçka ishte për hir të shpirttrave të fituar për Krishtin. «Por, edhe sikur unë të jem derdhur si flijim dhe shërbesë të besimit tuaj, gëzohem dhe

ngazëllohem me ju të gjithë.» (Filipianëve 2:17). Derdhja e jetës së tij në sakrificë ishte bërë që «të mund të fitonte Krishtin», por edhe *besimin* e kombeve që lartësojnë mëshirën e Krishtit.

Gëzimi im, kurora e triumfit!

Ja pse Pali i quan njerëzit, që kishte fituar në besim «*gëzimi i tij*.» «Prandaj o vëllezër të dashur dhe fort të dëshiruar, gëzimi dhe kurora ime, qëndroni kështu në Zotin, o shumë të dashur.» (Filipianëve 4:1). «Cila është shpresa jonë, a gëzimi, a kurora e lavdisë? A nuk jeni pikërisht ju, përpara Zotit tonë, Jezus Krisht, në ardhjen e tij? Ju jeni gëzimi dhe lavdia jonë.» (1 Thesalonikasve 2:19,20). Kisha ishte gëzimi i tij, sepse në gëzimin e tyre në Krishtin rritej edhe gëzimi i tij në Krishtin. Lartësohej kështu më shumë dashuria e Krishtit me shumëfishimin e të kthyerve në kryq. Kur Pali zgjodhi vuajtjen me qëllim ungjillëzimin e botës dhe tha se dëshira e tij ishte «të fitonte Krishtin», nënkuptonte që gëzimi i tij personal në bashkësi me Krishtin do të bëhej përjetësisht më i mrekullueshëm për shkak të shumimit të gëzimit të faljes së Krishtit. Edhe pse vetë nuk gjendem aq larg sa shkoi Pali në dashurinë e tij pasionante për kishën, falënderoj Perëndinë që ka pasur pika kyçe në jetën time, ku Ai më ka çliruar nga ferri i cinizmit. Kujtoj ditët kur po përfundoja kolegjin dhe po bëhesha gati të filloja seminarin. Gjendja shpirtërore e viteve 60-të ishte e shkretë në kishën lokale. Mbaj mend që ecja rrugëve të Pasadenës në mëngjeset e së dielës së vjeshtës së vitit 1968, duke menduar nëse kishte një të ardhme për kishën – ashtu siç dyshon një peshk për vlerën e ujit ose si një zog që vë në dyshim arsyen e tij për erën dhe ajrin. Ishte hiri i Perëndisë ai që më çliroi nga kjo marrëzi që më kishte kapluar, më dha një strehë me njerëzit e Perëndisë në Kishën e Rrugës së Liqenit për tre vjet, dhe më lejoi të shihja në zemrën e Rei Ortlëndit, pastorit tim, një njeri në të cilin rridhte i njëjti pasion si ai i Palit, kur shihte grigjën e vet ndërsa e konsideronte; «gëzimi im, kurora ime e triumfit!»

Dhjetë vjet më vonë pata një moment tjetër krize, ndërsa rrija në tavolinë duke shkruar në ditar një natë të vonë të tetorit të

vitet 1979. Pyesja veten nëse do të vazhdoja të jepja mësim biblik si profesor në Kolegjin Bethel apo duhej të hiqja dorë dhe të konsideroja të merrja detyrën e pastorit? Në ato ditë Perëndia po punonte tek unë duke më dhënë një dashuri të thellë për kishën – trupin e njerëzve të mbledhur, që rriteshin dhe shërbenin javë pas javë duke u bërë më shumë të ngjashëm me krishtin. Nga ana tjetër, edhe të mësuarit më jepte një lloj tjetër gëzimi. Është një thirrje e madhe edhe kjo. Atë natë triumfoi tek unë një tjetër pasion dhe Perëndia më drejtoi edhe në muajt në vazhdim në Kishën Baptiste të Betlehemit. Që atëherë kanë kaluar më shumë se pesëdhjetë vjet. Nëse do ta lëshoja edhe pak veten, do të lotoja lehtë duke menduar sa të rëndësishëm janë për mua ata njerëz.. Shpresoj ta kenë vënë re që pasioni im më i madh ishte «të fitoja Krishtin.» S’besoj që gaboj kur them se ata e dinin që jetoja për «përparimin dhe gëzimin e besimit të tyre.» (Flipianëve 1:25) Si shkrimi dhe predikimi, të dyja këto kanë një qëllim të përbashkët. Fitoj më shumë nga Krishti në vetëm një person të kthyer në besimin e krishterë dhe në rritjen e shenjtoreve se sa qindra përgjegjësi në punë të zakonshme të përditshme.

Të them se Krishti është gëzimi im dhe Betlehemi është gëzimi im, kjo nuk është e folur e dyfishtë.

Nëse gëzimi në vuajtje është i mrekullueshëm, ndiqe atë!

S’duhet të befashemi edhe pse mund të duket tërësisht e panatyrshme që Pali thotë te Kolosianëve 1:24 «Gëzohem në vuajtjet e mia për shkakun tuaj dhe plotësoj në mish atë që u mungon mundimeve të Krishtit. «Me fjalë të tjera, kur plotësoj mundimet e Krishtit duke i shfaqur personalisht përmes vuajtjeve të mia dhe dhimbjes, gëzohem. Gëzohem. Hedonizmi i krishterë thjesht thotë se është diçka e mirë dhe e admirueshme ajo që bënte Pali dhe ne duhet të jemi imituesit e tij. Ta trajtosh gëzimin e mrekullueshëm shpirtëror të vuajtjes si një gjë të vogël, të rastësishme dhe jo për t’u ndjekur është shumë afër blasfemisë.

Më duhet të jem i kujdesshëm me këtë. Kur vetë Fryma e Shenjtë bën një gjë të tillë, dhe kështu lartëson gjithëmjaftueshmërinë e Krishtit në vuajtje, është gati blasfemi të thuash: «Është e lejueshme të vuash për të tjerët, por jo të ndjekësh vazhdimisht gëzimin.» Mrekullia lavdëruese e Krishtit nuk ka të bëjë vetëm me vuajtjen, por me gëzimin e vuajtjes. Dhe nënkuptohet që duhet ta ndjekim këtë gëzim. Në 1 Thesalonikasve 1:6,7 Pali thotë: «Dhe ju...pranuat fjalën në mes të një pikëllimi të madh, *me gëzimin e frymës së Shenjtë për t'u bërë kështu shembull për të gjithë besimtarët e Maqedonisë dhe të Akaisë.*» Vini re dy çështje thelbësore: së pari, gëzimi në pikëllim është puna e Frymës së Shenjtë dhe së dyti, është një shembull që të tjerët ta ndjekin. Ruhuni nga ata që e zvogëlojnë vlerën e mrekullive të Frymës së Perëndisë duke thënë se janë dhurata të mira, por jo qëllime të mira.

Gëzohu në përsekutim se shpërblimi yt është i madh!

Hedonizmi i krishterë thotë se ka mënyra të ndryshme për t'u gëzuar në vuajtjet si i krishterë. Dhe këto duhet të ndiqen si shprehje e gjithëmjaftueshmërisë, gjithëkënaqësisë së hirit të Perëndisë. Njëra prej mënyrave është shprehur prej Jezusit në Mateu 5:11,12. «Lum ju kur do t'ju shajnë dhe do t'ju përndjekin dhe, duke gënjyer, do të thonë të gjitha të zezat kundër jush për shkakun tim. *Gëzohuni dhe hidhuni nga gëzimi, sepse shpërblimi juaj në qiell është i madh.*» (Edhe te Luka 6.22,23) Një mënyrë e gëzimit në vuajtje vjen kur fiksojmë mendjet në madhësinë e shpërblimit, që do të na dhurohet në ringjallje. Si pasojë e kësaj, dhimbja që kalohet në të tashmen bëhet e papërfillshme krahasuar me atë që pritët të vijë. «Vuajtjet e kohës së tanishme nuk vlejnjë aspak krahasuar me lavdinë që do të shfaqet te ne.» (Romakëve 8:18; 2 Korintasve 4:16-18) Duke e lehtësuar vuajtjen, gëzimi për shpërblimin e bën edhe dashurinë të mundur, siç e pamë edhe në kapitullin katër. «Por ju t'i doni armiqtë tuaj, bëni të mira dhe jepni hua pa pasur shpresë për asgjë dhe *shpërblimi juaj do të jetë i madh.*» (Luka 6:35) Jini bujarë me të varfërit «dhe do të jini të

lumë, sepse ata nuk kanë si ta kthejnë shpërblimin dhe *shpërblimi do t'ju jepet në ringjallje të të drejtëve.*» (Luka 14.14)

Gëzohu në mundime, të thellon bindjen!

Një mënyrë tjetër e gëzimit në vuajtje vjen prej sigurisë që kemi në shpresën tonë. Gëzimi në mundime është rrënjosur në shpresën e ringjalljes dhe përvoja jonë e vuajtjes i thellon rrënjët e kësaj shprese. Për shembull, Pali thotë: «Mburremi edhe në shtrëngimet, duke ditur që shtrëngimi prodhon këmbënguljen, këmbëngulja përvojën dhe përvoja shpresën.» (Romakëve 5:3,4) E pra, gëzimi i Palit nuk është rrënjosur thjesht në shpërblimin e madh që do të ketë, por pasoja e vuajtjes do ta forcojë shpresën e tij për këtë shpërblim. Mundimet prodhojnë këmbënguljen dhe këmbëngulja sjell kuptimin se besimi ynë është i sinqertë dhe real, dhe kjo forcon shpresën tonë që në të vërtetë ne do fitojmë Krishtin.

Riçard Vurmbrandi përshkruan se si mund t'u mbijetosh momenteve kulminante të dhimbjes prej torturave për shkak të Krishtit.

Jeni torturuar aq shumë sa asgjë tjetër nuk ka më rëndësi. Nëse asgjë nuk llogaritet më, as fakti që të mbijetoj s'ka më rëndësi. Nëse asgjë nuk vlen më, edhe fakti që nuk do të kem më dhimbje nga torturat nuk llogaritet. Nxirrni këtë përfundim në fazën ku keni arritur dhe do shihni se do ta kaloni momentin e krizës. Kur ta kaloni këtë moment kyç krize, do të ndjeni një gëzim të brendshëm të papërmbajtshëm. Keni për ta ndjerë fuqishëm që Krishti ka qenë me ju në atë moment vendimtar.¹⁵

«Gëzimi i brendshëm» vjen nga fakti që keni rezistuar me ndihmën e Krishtit. Ju u provuat në zjarr dhe keni dalë të pastruar. Ju nuk u tërhoqët prapa. Krishti është i vërtetë në jetën tuaj. Ai është për ju Perëndia i gjithëkënaqshëm ashtu siç ka thënë. Ja, pikërisht këtë kanë përjetuar apostujt sipas asaj

që përshkruhet në veprat 5;41 pasi ishin rrahur, «Kështu ata u larguan nga sinedri, duke u gëzuar, sepse qenë çmuar të denjë të fyhen për emrin e Jezusit.» Gëzimi buroi nga mendimi se besimi ishte ruajtur nga Perëndia po aq i vërtetë dhe gati për t'u provuar në zjarrin e mundimit.

Gëzohu në vuajtjen me Krishtin, të çon në lavdi!

Një mënyrë tjetër gëzimi në vuajtje ndizet nga e vërteta që gëzimi ynë është shtegu që të çon në lavdi. Gëzimi në vuajtje nuk vjen vetëm përmes 1) përqendrimit në shpërblimin tonë dhe 2) efektin forcues të vuajtjes në sensin tonë të vërtetësisë dhe pastërtisë, por edhe 3) premtimit që gëzimi në vuajtje do të sigurojë gëzimin e përjetshëm në të ardhmen. Apostulli Pjetër e shpreh kështu: «Por gëzohuni, duke qenë pjesëtarë të mundimeve të Krishtit, që edhe në zbulesën e lavdisë së tij të mund të gëzoheni dhe të ngazëlloheni.» (1 Pjetrit 4:13) E pra, gëzimi në vuajtje është një shteg për në gëzimin final në zbulesën e Krishtit. Pjetri na bën thirrje që ta ndjekim këtë gëzim që tani (në fakt ai urdhëron për këtë!) në mënyrë që edhe ne të gjendemi midis atyre që gëzohen pa masë në ardhjen e Krishtit.

Gëzohu kur vuan për të tjerët, Ata shohin Krishtin!

Tashmë e kemi parë edhe mënyrën e katërt të të gëzuarit në vuajtje, e cila vjen përmes të kuptuarit që vuajtjet tona do t'i ndihmojnë të tjerët të shohin vlerën e Krishtit dhe të qëndrojnë në këtë besim të palëkundur për shkak të besimit tonë që ka kaluar provën e zjarrit. Pali u thotë Thesalonikasve: «Sepse tani ne jetojmë me të vërtetë, në qoftë se ju qëndroni të patundur në Zotin, sepse çfarë falënderimi mund t'i dërgojmë Perëndisë për ju për gjithë gëzimin që ndiejmë për shkakun tuaj përpara Perëndisë sonë» (1 Thesalonikasve 3:8,9) ky është gëzimi i Kolosianëve 1:24, «Gëzohem në vuajtjet që kaloj për shkakun tuaj.»

Kur ne vuajmë që t'u tregojmë të tjerëve dashurinë e Krishtit dhe vlerës e Tij të çmuar, kjo ndodh sepse çdo person i kthyer në Krishtin që qëndron në besimin e tij bëhet një prizëm i ri, unik ku përthyer lavdia e gjithkënaqshme e Krishtit. Gëzimi që ndiejmë për ta është i ngjashëm me atë që ndiejmë në Krishtin. Lavdia e Krishtit është «fitorja jonë më e madhe.» Pikërisht për këtë do vuajmë humbjen e çdo gjëje dhe gjithçkaje. Dhe gjithkush që sheh në vuajtjet tona vlerën superiore të Krishtit, dhe beson, bëhet një imazh tjetër ashtu si edhe një evidencë më tepër e vlerës më të lartë – dhe kështu një arsye tjetër për t'u gëzuar.

Njerëzit më të lumtur në botë

Rruga e kalvarit me Jezusin nuk është një rrugë pa gëzim. Edhe pse ka dhimbje ende në të, është rrugë që të fal thellësisht lumturi. Kur zgjedhim rehatinë dhe kënaqësitë jetëshkurtra para sakrificave dhe vuajtjeve të misioneve, ungjillëzimit, shërbesës dhe dashurisë, kemi zgjedhur kundër gëzimit. Ne refuzojmë burimin, ujërat e të cilit nuk shterojnë kurrë. (Isaia 58:11) Njerëzit më të lumtur në botë janë ata që përjetojnë misterin e «Krishtit në ta, shpresë lavdie» (Kolosianëve 1:27) që përmbush përmallimin e tyre të thellë dhe i çliron ata për të përhapur mundimet e Krishtit përmes vuajtjeve të tyre në botë. Perëndia na thërret për të jetuar për hir të Krishtit dhe ta bëjmë këtë përmes vuajtjes. Krishti vetë zgjodhi të vuante: nuk është se thjesht ashtu i ndodhi. Ai e zgjodhi vuajtjen si një mënyrë për të krijuar dhe përsosur kishën. Dhe tani është ai që na thërret drejt vuajtjes. Ja pra, ai na thërret që të marrim kryqin tonë dhe ta ndjekim në rrugën e kalvarit, të mohojmë veten e të sakrifikojmë për hir të shërbesës ndaj kishës dhe njohjes së botës me vuajtjet e tij. Vëlla Andrea, i cili drejton shërbesën Dyert e Hapura dhe që u bë shumë i njohur me librin e tij të botuar në vitin 1967 «*Kontrabandisti i Perëndisë*» (*God's Smuggler*), e përshkruan thirrjen e Krishtit në mes të viteve '90-të kështu:

«S'ka as edhe një derë të mbyllur në botë kur ti do të dëshmosh për Krishtin... Më tregoni një derë të mbyllur dhe unë do ju tregoj se si të hyni në të. Megjithatë, nuk mund t'ju premtoj një rrugë për të dalë që aty...»

Jezusi nuk tha: «Shkoni nëse dyert janë hapur,» sepse, në fakt, ato nuk ishin. Ai nuk tha as: «Shkoni nëse ju ftojnë ose ju kanë shtruar një banket.» Ai tha: «Shkoni!», sepse njerëzit kishin nevojë për fjalën e tij... Duhet të kemi një mënyrë tjetër të të bërit të misioneve – një mënyrë agresive, eksperimentale, ungjillëzuese, jo të kufizuar..., një shpirt pionier ...kam frikë se do na duhet të përshkojmë një luginë të thellë me situata kërcënuese, por të nevojshme dhe gjakderdhje, por duhet ta përshkojmë. Perëndia do largojë çdo pengesë nëse ne jemi serioz në këtë punë. Nëse themi: «Zot, me çdo lloj çmimi...» – dhe njerëzit nuk duhet të luten asnjëherë kështu, vetëm nëse duan me të vërtetë që Perëndia t'i çojë atje – ai do t'u përgjigjet. Kjo është e frikshme, por duhet të kalojmë përmes kësaj rruge. Kështu ka ndodhur edhe në Bibël për këta dy mijë vitet e fundit. Ne përballemi me kohë të vështira dhe duhet të kalojmë përmes tyre... Ne luajmë lojë kishash dhe luajmë lojë Krishterimi. Dhe nuk jemi aspak të vetëdijsëm se jemi besimtarë të vakët. Duhet të paguajmë një çmim për besimin. Lexo 2 Timoteut 3:12: «Të gjithë ata, që duan të jetojnë me perëndishmëri në Krishtin Jezus do të përndiqen.» Kisha ka qenë shumë më e dliirë në vendet ku ka pasur më shumë presione... gjithçka që dua të them është që të jemi gati.¹⁶

Jo të provojmë fuqinë tonë, por dashurinë e Tij të çmuar

Përgjigjja e kësaj thirrjeje është një hap rrënjësor i Hedonizmit të krishterë. Ne nuk e zgjedhim vuajtjen, sepse kështu na është kërkuar, por sepse ai që na e ka kërkuar e përshkruan vuajtjen si shtegun drejt gëzimit të përjetshëm. Ai na bën me shenjë që të shkojmë në bindjen tonë ndaj vuajtjes jo për të treguar

forcën tonë të përkushtimit ndaj detyrës, as të zbulojë energjinë e vendimit tonë apo të dëshmojë masën e tolerancës sonë në vuajtje, përkundrazi, ai do të manifestojë si përmes besimit të një fëmije, vlerën e pafund të premtimeve të tij të gjithëkënaqshme. Moisiu zgjodhi të keqtrajtohej bashkë me popullin e Perëndisë se sa të gëzonte për njëfarë kohe në dëfrimet e mëkatit... sepse i kishte sytë nga shpërblimi. (Hebrenjve 11: 25,26) Prandaj themi që bindja e tij lavdëroi Perëndinë e hirit dhe jo vendimin e tij për të vuajtur.

Thelbi i Hedonizmit të krishterë

Ky është thelbi i hedonizmit të krishterë. Në kërkimin e gëzimit përmes vuajtjes, ne lartësojmë burimin e vlerës së gjithëkënaqshme të gëzimit. Zoti vetë ndriçon si rrezja në fund të tunelit të dhimbjes. Nëse nuk e transmetojmë që ai është qëllimi dhe themeli i gëzimit tonë në vuajtje, atëherë domethënia e vërtetë e vuajtjes sonë shuhet. Sepse kuptimi është ky: Perëndia është fitim. Perëndia është fitim. Perëndia është fitim. Qëllimi kryesor i njeriut është të lavdërojë Zotin. Bëhet më e vërtetë në vuajtje se kudo tjetër që *Zoti është më shumë i lavdëruar në ne kur ne jemi më shumë të kënaqur në Të*. Ndaj dhe lutja ime është që Fryma e Shenjtë do të derdhë në njerëzit e vet në mbarë botën pasionin për epërsinë e Perëndisë në të gjitha gjërat. Dhe lutem që Ai do ta bëjë të qartë se kërkimi i gëzimit në Zotin, pavarësisht çdo lloj dhimbjeje, është një dëshmi e fuqishme e vlerës më të lartë dhe gjithëkënaqshme të Perëndisë. Dhe le të bëhet e vërtetë që, ndërsa «përmbushim atë që mungon në mundimet e Krishtit» gjithë njerëzit e botës do të shohin dashurinë e Krishtit dhe do të lartësojnë hirin e Tij në gëzimin e besimit.

Shënime

1. Riçard Vurmbrand, «*Të arrish drejt Lartësive*» (Bartlesville, OK:Libri i sakrificës së gjallë, 1992), Kopertina e Pasmae.
2. Cituar nga Filip Jansi (Philip Yancey) në «Zjarr i ngrirë», *Krishterimi i Sotëm*, Tetor 5, 1984, fq. 109.
3. Marvin Vinsent, I.C.C., Letrat drejtuar Filipianëve dhe Filemonit (Edinburgh: T. & T. Clark, 1897), fq. 78.
4. Jozef tson (Joseph Tson), «Një Teologji e Vuajtjes», Një broshurë e padatuar e Shoqërisë Misionare Rumune , P.O. Box 527, Wheaton, IL, 60189-057, fq. 4.
5. Stefan Neil (Stephen Nei), «*Një Histori e Misionit të Krishterë*» (Harmondsworth, Middlesex: Penguin Books Ltd., 1964), fq. 43,44.
6. Cituan në «Vuajtja e *Polikarpit*», në dokumentet e kishës së krishterë, Henri Betenson (Henry Bettenson), ed., (London: Oxford University Press, 1967), fq. 10.
7. «Vuajtja e *Polikarpit*,» fq. 9,10.
8. «Vuajtja e *Polikarpit*,» fq. 11.
9. «Vuajtja e *Polikarpit*,» fq. 12.
10. Xhorxh Otis i Riu (George Otis, Jr.), *I Fundit i Gjigantëve: Heqja e velit të Islamit dhe Kohët e Fundit* (Grand Rapids: Librat e Zgjedhur, 1991), fq. 261,263.
11. E cituar në Jozef Tson (Joseph Tson), «NJë Teologji e Vuajtjes», fq. 1.
12. Shih shembujt te Xhon Pajper «*Le të Gëzohen Kombet*»: «*Epërsia e Perëndisë në misionet*» (Grand Rapids: The Baker Book House, 1993), fq94–96. Shih gati të gjithë librat e Riçard Vurmbrandit, si për shembull: «*Të torturuar për Krishtin ose «Nëse do të ishte Krishti, a do t'ia jepje mbulesën tënde?» ose «Besimi fitimtar.» Burime të tjera duke përfshirë «Të thirrur për të vuajtur, të thirrur për të triumfuar nga Herbert Shlosberg (Herbert Schlossberg) dhe Zoti mbretëron në Kinë nga Lesli Lioll (Leslie Lyall).*
13. Jozef Tson (Joseph Tson), «Një Teologji e vuajtjes», fq. 2.
14. «Një teologji e vuajtjes», fq. 3.
15. Riçard Vurmbrand, «Të përgatitesh për Kishën e Fshehtë», në *Ditari i Pagëzimit*, Vol. 5, No. 4, Verë, 1985, fq. 50.
16. Vëlla Andre (Andrew), «Rrëfimet intime të Perëndisë,» një intervistë me Majkëll Madlin (Michael Maudlin) në *Krishterimi i Sotëm*, Dhjetor 11, 1995, fq. 46.

Shërbesat e Etura për Perëndinë


SHEP është një shërbesë burimore e Kishës baptiste të Betlehemit në Mineapolis, Minesota. Ne jemi për t'ju ndihmuar që ta bëni Perëndinë thesarin tuaj. Për këtë qëllim kemi krijuar me qindra burime ndihmëse. Shumica e inventarit tonë konsiston në librat dhe kasetat e Dr. Xhon Pajper. Veç kësaj, kemi krijuar programin e fëmijëve të fokusuar në Zotin, organizime konferencash dhe koordinimin e programit të konferencave të Xhon Pajperit. Jini të lirë të na pyesni mbi politikën tonë "Gjithçka që mund të ofroj". Na kontaktoni për të marrë një katalog falas:

(888) 346-4700 www.desiringgod.org

Zoti është më shumë i lavdëruar në ne kur ne jemi më shumë të kënaqur në Të.

Ky është thelbi i asaj që ne e quajmë Hedonizëm të krishterë: në kërkimin e gëzimit përmes vuajtjes, në lartësojmë vlerën e gjithëkënaqshme të Burimit të gëzimit tonë. Zoti vetë ndriçon si rrezja në fund të tunelit të dhimbjes. Nëse nuk e transmetojmë që ai është qëllimi dhe themeli i gëzimit tonë në vuajtje, atëherë domethënia e vërtetë e vuajtjes shuhet. Sepse kuptimi është ky: Perëndia është fitim. Perëndia është fitim. Perëndia është fitim. Qëllimi kryesor i njeriut është të lavdërojë Zotin. Bëhet më e vërtetë në vuajtje se kudo tjetër që *Zoti është më shumë i lavdëruar në ne kur ne jemi më shumë të kënaqur në Të*. Ndaj dhe lutja ime është që Fryma e Shenjtë do të derdhë në njerëzit e vet në mbarë botën pasionin për epërsinë e Perëndisë në të gjitha gjërat. Dhe lutem që Ai do ta bëjë të qartë se kërkimi i gëzimit në Zotin, pavarësisht çdo lloj dhimbjeje, është një dëshmi e fuqishme e vlerës më të lartë dhe gjithëkënaqshme të Perëndisë.

(Përshtatur nga I Etur për Perëndinë: Meditimet e një të Krishteri Hedonist, Përvjetori i dhjetë i botimit të zgjeruar (Sisters, OR: Multnomah Books, 1996), fq. 238.)





3

Parimet e persekutimit *Për studim dhe njohje*

Milton Martin



E redaktuar dhe e rishikuar. E përdorur me lejen
e Shërbesave të Misionit të Milton Martinit
Shërbesat e Misionit të Milton Martinit
P.O. Box 1567
Route 2, Box 2624
Belton, TX 76513
(254) 933-9339

Funksionimi i Kishës

(Mateu 16:18)

- I. Krishti themeloi Kishën e Tij dhe e porositi të vazhdonte punën e Tij. (Mateu 16:18; 28:18–20)
 - A. Nëse ndërtesat e kishave tona do të mbyllen ndonjëherë, a do të përbënte kjo fundin e Krishterimit?
 - B. Kishat e para nuk kishin tempuj ose ndërtesa.

- II. Kisha e parë u persekutua rëndë! Si u përgjigjën ata?
 - A. Ata takoheshin nëpër shtëpi. (Veprat 5:42)
 - B. «Të krishterët (besimtarët)e thjeshtë» ndanë besnikërisht dëshminë e tyre. (Veprat 8:1,4)
 - C. Ata shfrytëzuan çdo rast dhe mundësi për të dëshmuar dhe shpallur të vërtetën. (Veprat 16:12,13)
 - D. Ata mësuan dishepujt. (Veprat 11:25,26)
 - E. Ata u shoqëruan bashkë ndërsa shërbenin. (Veprat 2:46,47)
 - F. Ata adhuruan në çdo mundësi dhe rrethanë. (Veprat 16:23–25)

- III. U zbatuan mënyrat alternative të të adhuruarit, të të shoqëruarit dhe të të dëshmuarit.
 - A. Ishin të përhapura kishat-shtëpi. (Romakëve 16:3–5; 1 Korintasve 16:19)
 - B. Të krishterët e persekutuar dhe kishat e «paregjistruara» përdornin festimet e ditëlindjeve, dasmave dhe funeraleve për t'u mbledhur si një trup i Krishtit.
 - C. A mund të sugjerosh forma ose mënyra të tjera?

- IV. Disa mënyra që Satani i përdori për t'i shkatërruar të krishterët dhe kishat gjatë persekutimit.
 - A. Satani përdori izolimin si një mjet kundër kishave.
 - B. Satani përdori ndjenjën e fajit dhe sulmin si armë kundër kishave.

1. Satani është «akuzuesi i vëllezërve.»
2. Akuzat e Satanit janë të vazhdueshme dhe s'kanë fund kurrë.
3. I ligu pret në vigjilencë për t'u hedhur në sulm sa herë që nuk rrëfehët ndonjë mëkat.
4. Duhet treguar më shumë kujdes për të mbajtur miqësinë dhe bashkësinë me Zotin. (1 Gjonit 1:8-10)
5. Lëndimet personale të pashprehura bëhen vërtet problem serioz, duke prodhuar «male» me probleme.
6. Satani bën të pamundurën që t'u shkaktojë të krishterëve «ndjenjën e fajit të rremë», pasi mëkati është falur. (Romakëve 5:1,2; 8:33,34)
7. Në vend që të dyshosh dhe të pyesësh «Pse?» thuaj, «Zot, çfarë do që të bëj?»

Të krishterët do të vuajnë persekutimin (1 Pjetrit 4:12-19)

- I. Premtimi për të vuajtur. (1 Pjetrit 2:21; 4:12; 1 Thesalonikasve 3:3,4; Veprat 14:22; 2 Timoteut 3:12; Marku 13:9,13; Filipianëve 1:29)
- II. Qëllimi i vuajtjes. (1 Pjetrit 4:12; «Prova e zjarrit.» Jobi 23:10; Psalmi 66:10)
 - A. Prova e besimit.
 - B. Kur diçka është e deklaruar, del nevoja për ta provuar në realitet.
 - C. Prova e thellësisë së besimit tonë.
 1. Çfarë mund të na bëjë të ndryshojmë apo të shmangemi nga rruga?
 2. Domethënia dhe masa e pengesave zbulon fuqinë e besimit tonë.

- III. Të marrësh pjesë në vuajtjet e Krishtit. (1 Pjetrit 4:13)
 E thënë fjalë për fjalë, i krishteri bën pjesë në vuajtjet e Krishtit. Jo në kryq, por me metodat e tjera të njerëzve.
- A. Zoti u mohua. (Gjoni 1:10,11)
 - B. Zoti u urrye. (Gjoni 15:24; Isaia 53:3)
 - C. Zoti e la shtëpinë e rehatshme të Atit të Tij. (Gjoni 3:16)
 - D. Zoti nuk kishte shtëpi të vetën.
 - E. Zoti nuk kishte para as të paguante taksat. (Mateu 17:27)
 - F. Zoti nuk kishte një shtrat të vetin.
 - G. Zoti nuk kishte askënd ta mbronte kur u akuzua padrejtësisht. (1 Pjetrit 2:22,23)
 - H. Zoti nuk kishte varr. (Isaia 53:9)
 - I. Zoti u bë i varfër.
 - J. Filipianëve 3:10; 1 Pjetrit 2:21; 4:1; Galatasve 2:20; 6:12,17; Veprat 5:41; Hebrenjve 12:2; 1 Thesalonikasve 2:2.
- Cili do të jetë reagimi ynë? (Hebrenjve 12:2)

- IV. Fuqia në vuajtje ose përmes vuajtjes. (1 Pjetrit 4:14)
 Fryma e Shenjtë prehet tek ata që vuajnë. Në Dhjatën e Vjetër, reja ishte një simbol i pranisë së Perëndisë. Reja njihej si lavdia e Zotit (1 Mbretërve 8:10,11). Po e njëjta lavdi qëndron mbi besimtarin përmes Frymës së Shenjtë kur ai vuan për Krishtin. Fryma vjen që të shërbejë-mbushë, mbrojë, mbështjellë, rrethojë, mbështesë, ndihmojë, fuqizojë, përkrahë dhe plotësojë atë që mungon dhe është e nevojshme. Kjo lavdi u pa te Stefani. (Veprat 6:5–8; 7:55,60). Sa më e errët është nata, aq më të ndritshëm janë yjet (2 Korintasve 12:9,10).

- V. Rreziqet në vuajtje. (1 Pjetrit 4:14–16)
- A. Ka dallim midis vuajtjes për Krishtin dhe vuajtjes për shkak të gabimit apo marrëzisë së dikujt.
 - B. Turpi. (Hebrenjve 2:11)


- C. Hidhërim në vend të gëzimit dhe falënderimit. (Eksodi 15:23,24; 16:2; 1 Thesalonikasve 5:16–18)
- VI. Pastrim përmes vuajtjes. (1 Pjetrit 1:7; 4:12)
- A. Vuajtja mund të përdoret për të pastruar, shlyer, rafinuar «mbeturinat.»
- B. Vuajtja në vetvete nuk mund të pastrojë. Vetëm Hiri i Perëndisë mund të prodhojë pastrim dhe rafinim, vuajtja vetëm sa na çon në njohjen e nevojës sonë të thellë.
1. Vuajtja na ndihmon të kuptojmë që asgjë nuk mund të arrihet me forcën tonë.
 2. Vuajtja na bën më të ndjeshëm ndaj mëkatit.
- C. Përmes vuajtjes, mësojmë të varemi plotësisht te Zoti. (2 Korintasve 12:9,10)
- D. Si do t'i përgjigjemi? Le t'ia besojmë Zotit shpirtrat tanë. (1 Pjetrit 4:19; Veprat 7:59; Luka 23:46)

Pjesa e vuajtjes në jetën e besimtarit

Vuajtja është normale për këdo qenie njerëzore. (Jobi 5:6,7). Edhe për një të krishterë është normale që të vuajë. (2 Timoteut 3:12; Veprat 14:22; 1 Pjetrit 2:21).

Ka disa nivele të persekutimit: presion, poshtërim, diskriminim, kërcënim, shpronësim ose dhunë fizike.

- I. Ide të gabuara që hasen rëndom.
- A. Vuajtja është ndëshkim për shkak të një gabimi a mëkati. (1 Pjetrit 4:19; 3:14; 4:16)
- B. Mendimi që njeriu nuk ka pse të jetë i brengosur. (1 Pjetrit 1:6)
- C. Mendimi që vetëm të krishterët vuajnë. (Zanafilla 3:16–19)
- D. Tërheqje e sëmure në lidhje me vuajtjen.
- E. Frikë e paarsyshme për vuajtjen.

- 
- II. Çfarë na mëson Bibla për vuajtjen.
- A. Të krishterët supozohet që të vuajnë. (Gjoni 15:18–21; 17:14; 1 Gjoni 3:13)
 - B. Vuajtja mund të jetë vullneti i Perëndisë për ne. (1 Pjetrit 4:16; 2:21)
 - C. Vuajtja në jetën e një fëmije të Perëndisë ka një qëllim. (1 Pjetrit 1:6,7; 2 Korintasve 12:7–10)
 - D. Ne duhet të vuajmë për hir të drejtësisë. (Mateu 5:10; 1 Pjetrit 4:15)
 - E. E konsideron vuajtjen të drejtë. (Mateu 5:10–12; Luka 6:22,23)
 - F. Vuajtja na lidh më shumë me Perëndinë. (Romakëve 8:16–18; Kolosianëve 3:1–3)
 - G. Nuk ka pse të kemi trup në lidhje me vuajtjen. (1 Pjetrit 4:16; Hebrenjve 13:12,13)
 - H. Duhet të ndjekim shembullin e Krishtit. (1 Pjetrit 2:19–25)
 - I. Duhet të reagojmë ndërsa vuajmë ashtu si Zoti. (Mateu 5:38–48; Romakëve 12:14,17–21; 1 Pjetrit 2:21–23)
 - J. Ne mund të jemi fitimtarë. (Gjoni 16:33)
- III. Të përgatitesh për vuajtjen.
- A. Mendoje që është normale. (1 Pjetrit 4:12; Filipianëve 1:29)
 - B. Njih mësimet e Fjalës së Zotit. (Filemonit 3:10; Romakëve 6:3–5; Gjoni 8:31,32)
 - C. Bindu në Krishtin. (Gjoni 15:4)
 - D. Dorëzoju çdo ditë Frymës së Shenjtë. (Efesianëve 5:18; 4:30)
 - E. Çlodhu në vullnetin e Perëndisë. (Efesianëve 5:17; Hebrenjve 4:1,9–11)
 - F. Inkurajo vëllezërit ndërsa vuani bashkë. (Kolosianëve 3:16,17; Efesianëve 5:19–21)

Mënyra të ndryshme se si sulmi mund t'u vijë kishave.

- I. Fokusi i persekutimit. (Gjoni 15:18–21; Kolosianëve 1:24–27) Sulmi ka qenë dhe përherë do të jetë kundër Zotit tonë.

- II. Gjuha e Mundësit.
 - A. Fjalët shpotitëse të një fituesi – «ia del.» (Zbulesa 2:7,11,17,26; 3:5,12,21)
 - B. Sekretet e mundjes. (Zbulesa 12:11)
 1. «Përmes gjakut të qengjit» (Zbulesa 12:11a)
(Vëreni studimin mbi rëndësinë e gjakut.)
 - a. Paqe me Perëndinë.
 - b. Paqe me ndërgjegjen tonë.
 - c. Fuqi në jetën.
 - d. Kjo armë është e humbur:
 - 1) Me teologji liberale – jo gjakun.
 - 2) Me teologji liberale – jo kryqin.
 - 3) Me predikime të lehta – jo fuqinë.
 2. «Me fjalën e dëshmisë së tyre.» (Zbulesa 12:11b)
 - a. Satani përpiqet të na grabisë fitoren duke na bërë që të mos flasim ose deklarojmë dëshminë dhe besueshmërinë tonë.
 - b. Gjithashtu ka edhe «një armik të brendshëm.»
 - 1) Ndarja brenda kishave tona.
 - 2) Frika.
 - 3) Mosbesimi.
 - 4) Mungesa e dashurisë.
 - 5) Përqendrimi te gjërat dhe çështjet se sa të njerëzit dhe shpirtrat.
 - c. Mungesa e kujdesit për familjet tona.
 - d. Plane dhe projekte që nuk janë sipas vullnetit të Perëndisë.
 - e. Çdo gjë tjetër që çekulibron jetët tona.
 3. «Dhe (ata) nuk e deshën jetën e tyre deri në vdekje.» (Zbulesa 12:11c)


- a. Kompromisi nuk është pjesë e fjalorit.
- b. Shembujt e të krishterëve që kanë vuajtur.
- c. Nuk është e përfshirë vetëm jeta materiale, por edhe ambiciet, të drejtat, pozita.

III. Shenja të përgjithshme.

Persekutimi nuk është diçka e përcaktuar për çdo vend, qoftë komunist apo nën regjime të tjera totalitare. Megjithatë, janë disa shenja të përgjithshme se si fillon persekutimi.

- A. Kufizime në ungjillëzim.
 1. Të krishterët nuk lejohen të udhëtojnë ose të zgjedhin punësimin.
 2. Të gjitha programet e krishtera në radio dhe televizion hiqen nga qarkullimi.
 3. Çdo takim fetar jashtë kishës është i ndaluar.
 4. Duhet të sigurohet leja për adhurimin. S'mund të ketë takime të tjera përveç atyre të përcaktuara.
 5. Spiunë ose të infiltruar nga ana e qeverisë janë të pranishëm në të gjitha takimet e shërbesës.
- B. Importimi i Biblave dhe literaturës së krishterë është i ndaluar.
 1. Materialet e printuara nuk konsiderohen të rëndësishme.
 2. Ka raste kur Bibla është zëvendësuar me të njëjtën kategori me materialet pornografike.
- C. Misionarët e huaj dëbohen nga vendi.
 1. Përmes ligjit e kufizojnë klerin në nivel lokal.
 2. Përmes ligjit i ndalojnë të huajt të punojnë në vend. Në raste të tjera, mund të lejohen vetëm turistët me një afat kohor të kufizuar ose me udhëtim të kufizuar në disa zona të caktuara.
 3. Përmes kërcënimeve dhe dhunës së drejtpërdrejtë kundrejt të huajve.
- D. Udhëheqësit e krishterë kërcënohen dhe diskriminohen rëndë.

1. Posta është e censuruar dhe pastorët janë të kufizuar në temat e predikimeve të tyre.
 - a. Hiqet licenca në rast se përmendet ndonjë gjë politike nga katedra e kishës.
 - b. Pastorët mbahen të kufizuar përmes kërcënimeve se do u merren fëmijët nga shteti.
2. Pastorëve nuk u lejohet të shpenzojnë gjithë kohën e tyre për të shërbyer.
 - a. «Ata duhet të bëhen njerëz produktivë të shoqërisë.» Kjo do të thotë se ata duhet të ushtrojnë njëkohësisht dy profesione.
 - b. Mund të pranohen në punë të atilla, që u marrin gjithë kohën dhe energjinë.
3. Pastorëve nuk u lejohet të vizitojnë anëtarët e kishës apo të shpërndajnë literaturë të krishterë.
4. Në kisha është e ndaluar të mbahen makina shkrimi, kompjutera ose pajisje printimi.
5. Pastorët mund të manipulohen nga taktika frikësuese.
 - a. Ata mund të thirren për t'u marrë në pyetje.
 - b. Ata mund të shtrëngohen të marrin pjesë në kurse të ndryshme «indoktrinuese» të organizuara nga qeveria.
 - c. U bëhen oferta të veçanta «tunduese» për t'i joshur.
 - 1) Kjo mund të jetë në formën e privilegjeve të veçanta.
 - 2) Mund të jetë në formën e aprovimit të fëmijëve në universitet, gjë për të cilën të krishterët janë të kufizuar.
 - d. Shtëpitë e tyre mund të bastisen nga kontrolle të palajmëruara.
 - e. Shërbesat mund të dynden nga prania e një numri të lartë të nëpunësve qeveritarë.
6. Pastorët mund të caktohen me punë në zona të largëta dhe të vetmuara të vendit.

- 
- a. Qëllimi është që t'i izolojnë nga të afërmit dhe të krishterët e tjerë.
 - b. Mund t'u caktohen punë të rëndomta poshtëruese.
7. Pastorët arrestohen dhe «riedukohen.»
- a. Kjo mund të përfshijë torturën.
 - b. Mund të turpërohen publikisht.
 - c. Kundër tyre jepen akuza dhe dëshmi të rreme.
- E. Kishat janë të detyruara të regjistrohen.
1. Të gjithë udhëheqësit e kishës duhet të aprovohen.
 2. Të gjitha predikimet duhet të shkruhen dhe të rishikohen nga individë ose departamente para se të tregohen publikisht.
 3. Fjalimet duhet të nënshkruhen para se pastorët t'i predikojnë. (për shembull: «Asnjë përpjekje s'duhet të bëhet për të ungjillëzuar të pashpëtuarit.»)
- F. Denominacionet janë të detyruara të shkrihen.
1. Numri i denominacioneve është i kufizuar.
 2. Gjithçka vihet nën kontrollin e Këshillit të Përgjithshëm Kombëtar.
 3. «Krijohet» një kishë tërësisht kombëtare.
- G. Mundësitë e edukimit arsimor dhe profesional për të krishterët janë të kufizuara.
1. Vetëm anëtarët e grupeve të caktuara të rinjsh janë të lejuar të shkojnë në universitet.
 2. Asnjë prej të krishterëve nuk mund të marrë profesionin doktor, avokat, profesor ose punonjës social.
 3. Të krishterët nuk kanë mundësi zgjedhjeje në edukimin apo punësimin e tyre.
- H. Edukimi fetar për të miturit deri në moshën 18 vjeç është i ndaluar.
1. Shkollimi në shtëpi nuk lejohet.
 2. Të rinjtë e krishterë janë të detyruar të ndjekin orë «edukimi të veçantë» mbi ateizmin, evolucionin, seksin dhe «alternativa të tjera jetese.»

3. Prindërve që thyejnë ligjin u merren fëmijët nga shteti.
- I. Të krishterëve nuk u lejohet të ndihmojnë njëri-tjetrin. Kur anëtari i një familjeje arrestohet, pjesa tjetër e familjes humbet disa «të drejta» ose «privilegje.»
1. Kjo mund të përfshijë të drejtën për kujdes shëndetësor, mundësi strehimi apo ushqimi.
 2. Familja izolohet duke mos i lejuar shoqërimin me besimtarët ose familjarë të tjerë.
- J. Kishat mbyllen.
1. Ndërtesat e kishave vihen në dispozicion për përdorime të tjera.
 2. Të krishterët «caktohen» në vende të largëta si mundësi izolimi.
 3. Të krishterët e kanë të ndaluar të jenë në kontakt me besimtarë të tjerë.
- IV. Shumë të krishterë janë të bindur që nuk ka për t'u ndodhur atyre.
- A. Për ndonjë arsye ata besojnë se janë të përjashtuar.
 - B. Edhe pse ka disa lloj interpretimesh për fjalën «ngazëllim», nuk është rasti për t'u justifikuar. Nuk kemi të drejtë të besojmë që Zoti na ka shkarkuar nga persekutimi.
- V. Mësime aktuale për besimtarët.
- A. Lut u si kurrë më parë për kombin tënd dhe udhëheqësit e tij. (1 Timoteut 2:1-4; Romakëve 13:1-7)
 - B. Vendos të jesh fitimtar për Krishtin. (Zbulesa 12:11)

**Disa forma të mundshme si
mund të shfaqet persekutimi.**
(1 Pjetrit 2:19-24)


Vuajtja është pjesë e jetës së çdo besimtari. Ka të paktën 31 mënyra të mundshme që dikush mund të vuajë.

1. Për hir të drejtësisë. (Mateu 5:10; 1 Pjetrit 3:14)
2. Shpifjet (raporti i të ligut). (Psalmi 31:13; Jobi 19:18; 55:12–14; Luka 6:22)
3. Turpi. Sikleti, çnderimi ose opinion i keq. Njësoj si vetë Zoti kaloi ndërsa ishte në tokë, i quajtur si një fëmijë jashtë martese; i kryqëzuar publikisht lakuriq. (Hebrenjve 13:13; 11:26)
4. Akuza të rreme. (Psalmi 35:11; 27:12; Mateu 5:11; Luka 23:2,5,10; Marku 14:55–60; Veprat 6:13; 16:19–23; 26:2,7)
5. Kurthe përmes mashtrimit, grackave, dredhive, të gjitha mënyrave për të akuzuar. (Danieli 6:4,5; Luka 11:54; Mateu 10:16–18)
6. Objekt komploti. (2 Samuelit 15:12; Zanafilla 37:18; 2 Korintasve 11:32; Veprat 9:23)
7. Objekt talljeje. (Psalmi 42:3)—për t'u neveritur, përqeshur, tallur, të vënë në lojë
(Jobi 12:4; Mateu 27:29,31,41; Veprat 2:13; 17:18,32; Hebrenjve 11:36)
8. Të tradhtuar – pabesisht. (Mateu 24:10; Luka 21:16; Psalmi 41:9)
9. Të përbuzur – për t'u neveritur, për t'u shpërfillur, për t'u konsideruar të pandershëm.
(1 Korintasve 1:28; 4:10c)
10. Të urreyer nga familja. (Mateu 10:21,34–36; Mikea 7:6; Luka 21:16)
11. Të urreyer nga njerëzit. (Luka 21:17; Mateu 10:22; Jobi 19:19)
12. Shpifje mbi karakterin, përgojime, raportime të liga.
(Psalmi 31:13; Jobi 19:19; 1 Pjetrit 2:12; 1 Korintasve 4:13)
13. Të frikësuar edhe nga njerëzit më të afërt. (Veprat 9:26)
14. Subjekt të provave të veçanta. (1 Korintasve 4:9–14; 2 Korintasve 11:23–28)
15. Të burgosur. (Luka 21:12; Veprat 4:3; 5:18; 12:4; 16:24; 2 Korintasve 6:5; 11:23c; Hebrenjve 11:36b)
16. Të rrahur. (Veprat 5:40; 16:23; 2 Korintasve 6:5; 11:24; Mateu 10:17)

17. Të kundërshtuar. (Veprat 13:45)
18. Të vënë kundër të tjerëve. (Veprat 6:12; 13:50; 14:2,19; 19:23,25,26, 29; 21:27)
19. Të akuzuar para autoriteteve. (Veprat 18:12; Mateu 10:17,18)
20. Të kërcënuar. (Veprat 4:18,21; 5:40)
21. Të përzënë me gurë. (Veprat 7:58,59; 14:19; 2 Korintasve 11:25; Hebrejve 11:37)
22. Pikëllime. (2 Timoteut 3;11; Psalmi 34:19)
23. Dëbime. (Veprat 13:50; Gjoni 16:2a)
24. Të rraskapitur, lodhje ekstreme. (2 Korintasve 11:27)
25. Të uritur dhe të etur.. (2 Korintasve 11:27; 1 Korintasve 4:11)
26. Tabloja. (1 Korintasve 4:9; Veprat 9:16; 20:23; 21:11; Hebrejve 10:33a)
27. Vuajtje fizike. (1 Korintasve 4:11; 2 Korintasve 6:4; Filipianëve 4:12; Hebrejve 1:37)
28. Mundime. (Luka 21:16; Veprat 7:59; 12:2; Gjoni 16:2)
29. Pikëllime. (2 Timoteu 1:8; 4:5; Mateu 24:9; Psalmi 34:19; 2 Korintasve 4:17; 6:4; Hebrejve 10:32,33; 11:25,37; Kolosianëve 1:24; 1 Thesalonikasve 1:6; 3,7; Jakobi 5:10)
30. Skamje. (2 Korintasve 6:10; Filipianëve 4:12)
31. Humbje e pronës dhe e të mirave materiale. (Hebrejve 10:34b)

Sugjerime të domosdoshme për të fituar mbi persekutimin.

- I. Drejtuesit shpirtërorë të krishterë sipas Dhjatës së Re. (Veprat 14:21,22; Titi 1:5)
 - A. Drejtuesit nuk ishin krenarë për pozitën e tyre. (1 Timoteut 3:6; 1 Pjetrit 5:3)
 - B. Drejtuesit ishin shërbëtorë të vërtetë. (1 Pjetrit 5:2; Gjoni 13:14–17)
 - C. Drejtuesit u njëjtësuan me njerëzit e thjeshtë.


- 
- D. Drejtuesit ishin njerëz me integritet dhe ndershmëri, të dalluar jo vetëm nga të krishterët, por nga të gjithë.
 - E. Drejtuesit dalloheshin për vlerën e veçantë të guximit, gjë që i bënte të besueshëm.
- II. Zgjidh të qëndrosh me dishepujt. (2 Timoteut 2:2)
- A. Përzgjidh një numër të caktuar besimtarësh-të zgjedhur për të qenë dishepuj. (Luka 6:12)
 - B. Kalo kohë me ta. (Marku 3:14)
 - C. Mësoji përmes shembullit tënd. (1 Korintasve 4:15,16; Filipianëve 4:9; Gjoni 13:14–17)
 - D. Jepu udhëzime të thjeshta dhe të qarta. (Veprat 20:26,27)
 - E. Realizimi i përgjegjësive.
 - F. Mësoju përgjegjësinë dhe ndërto në ta karakter. (1 Timoteut 4:12–16)
 - G. Ji përkrah tyre çdo ditë. (Efesianëve 1:16; Filipianëve 1:3–6; Kolosianëve 1:3)
- III. Familjet tona duhet të jenë të sigurta.
- A. Sigurohu që çdo besimtar ka pranuar Krishtin si Zot dhe Shpëtimtar. (Kolosianëve 1:9–13; 2 Korintasve 13:5; Romakëve 8:1–14)
 - B. Parapërgatiti për stuhinë që mund të vijë herët a vonë mbi ta. (Ligji i Përtërirë 6:4–9,20–25; 11:18–21; 30:2; Fjalët e urta 6:20–24; Jozueu 24:14,15)
 - C. Grumbullo pjesë nga shkrimi dhe materiale të tjera të krishtera të kuptueshme për çdonjërin në familje.
 - D. Mos harro asnjëherë të ndash për të varfërit. (Romakëve 12:9–18; 13:8; 15:1; 1 Korintasve 16:1; Veprat 20:35; Galatasve 6:2)
- IV. Kërko mënyra dhe metoda të ndryshme për t'u kujdesur për ta dhe për të vazhduar dëshminë në Krishtin. (Mateu 16:18)
- A. Mbajti të rinjtë të gjallë dhe aktivë.

- B. Mëso çdo gjë në lidhje me vuajtjet e të tjerëve dhe takoji personalisht. (Hebrenjve 13:3)
- C. Trego dashuri të sinqertë duke u kujdesur për të gjithë, sidomos në kohë nevoje; për shembull në kohë skamjeje, sëmundjeje, vdekjeje. (Mateu 25:35–40; 5:43–45; Jakobi 1:27; 2 Timoteut 1:16–18; Romakëve 12:20)
- D. Kujdesu për çdo hidhërim që zë vend në zemër. (Romakëve 12:14,17,19,21; Mateu 5:38–48)
- E. Mos iu kthe të keqes me të keqe. (Mateu 5:44; Luka 23:34; Veprat 7:60; 1 Korintasve 4:11–13; 1 Pjetrit 2:23)
- F. Lutu për armiqtë e tu. (Mateu 5:44)

Nata do të vijë kur askush nuk do të punojë (Gjoni 9:4)

Pavarësisht deklaramëve që janë bërë, janë ende edhe mbi 40 kombe «të mbyllura» ndaj predikimit të ungjillit. Të tjera vende janë në rrezik të madh të humbjes së lirisë së besimit. Ç'bëhet me shpirtrat e këtyre vendeve? Jeremia 8:20 bëhet thirrja dhe dilema e tyre. Ne duhet «t'i bashkohemi punës së Zotit –ndërsa ka ende ditë.» (Gjoni 9:4).

- I. Duke pasur parasysh fjalët e Krishtit..
 - A. Çfarë ka dashur të thotë Ai me fjalën «natë»? Mungesa e Krishtit është e barabartë me «natën» (Errësira është mungesa e dritës).
 1. Kur njerëzit kundërshtojnë ungjillin dhe kauzën e Krishtit është «natë.» (Marku 5:17)
 2. Kur feja nxitet nga zemërimi, tërbimi dhe i kundërvihet Zotit, atëherë bëhet «natë.» Krishti u kryqëzua nga judenjtë fetarë. (Mateu 27:20–25)
 3. Kur mëkati lejohet në jetën e besimtarit dhe «fle» aty i parrëfyer dhe i pafalur, është «natë.» (1 Gjonit 1:5,6)

- 
4. Kur Krishti të kthehet për të vetët, «nata e përjetshme» do të vijë për shumicën (Mateu 24:30,31)
- B. Çfarë domethënieje ka fjala «punë»?
1. Bindje ndaj vullnetit të Perëndisë do të thotë «të bësh punën e Tij.» (Gjoni 9:4)
 2. Kur e lejojmë Krishtin të punojë në dhe përmes nesh – kjo do të thotë të bësh «punën e Tij» (Mateu 5:15,16)
- II. Si mund të vijë nata kur askush nuk punon?
- A. Fuqitë e errësirës punojnë për të sjellë errësirën në botë dhe veçanërisht në disa zona të caktuara. (Efesianëve 5:11; 6:12)
Këto mënyra janë: haminizmi laik, lëvizje njerëzore si Epoka e Re, adhurim ndaj fuqive politike, kulte të rreme, imoralitet dhe perversitet.
- B. Satani e mbjell farën e errësirës në zemrat, kishat dhe shoqërinë. (Mateu 13:24–28)
- III. Pse mund të vijë nata kur askush nuk është në gjendje të punojë?
- A. Është e natyrshme që nata vjen pas ditës.
- B. Jetojmë në një terren të pafund ligësish dhe Bibla tregon që e keqja ka për t'u rritur dhe për t'u bërë më pushtuese. (2 Timoteut 3:13)
- C. Një dritë e dobët dhe e zbehtë dhe të krishterë të vakët nuk mund të ndikojnë në këtë botë. (Mateu 6:22,23; 5:13–15; Zbulesa 3:15,16)
- D. Gjatë periudhës në errësirën shpirtërore, mëkati nuk shihet si mëkat dhe madje as gabimi si gabim (periudha e pushtetit të moralit të përkryer të vetvetes). (2 Timoteut 3:1–9; 4:3,4)
- IV. Çfarë duhet të bëjmë?
- A. Përfito nga drita e ditës.

1. Duhet të hyjmë aty ku dyert janë të hapura ose të «mbyllura» (Duhet t'ua japim ungjillin sa më shumë njerëzve që mundemi, me sa më shumë efektivitet dhe brenda një kohe sa më të shkurtër.)
 2. Shquani fushat që janë gati për korrje (Fryma e Perëndisë përgatit zemrat në zona të caktuara dhe në një kohë të caktuar.)
 3. Dallo zonat «e hapura dhe tolerante» dhe përfito për t'i përgatitur për ungjillin në rrethana të caktuara. Për shembull, Pali shkoi në fillim në sinagogat e çdo qyteti për t'i ndërtuar në të kuptuarit për Perëndinë dhe Shkrimet. (Veprat 13:5,14,15; 17:1-3; 18:2,4; 19:8)
 4. Ji i pamëshirshëm me kultet dhe çdo «teori» që del në fushën e misionit.
- B. Mos e komprometo ungjillin e pastër për çfarëdolloj besimi social a kulturor apo qoftë edhe për mbjelljen e një kishe.
- C. Është koha të veprosh! (Një proverb afrikan thotë: «Vrapo ndërsa dielli të djeg»)
1. Le t'ia dorëzojmë veten kërkimit të Zotit përmes lutjes dhe agjërimit. (Isaia 55:6,7; Psalmi 2:6,7)
 2. Duhet të shenjtërojmë veten dhe të heqim dorë nga të gjitha mëkatet e vetëdijshme. (Isaia 1:16,17; Jeremia 4:14; Romakëve 12:9; GJoni 17:17)
 3. Ec në Frymën dhe fito shpirtrat! (Romakëve 13:13; Galatasve 5:25; Efesianëve 4:1; 5:15,16; Kolosianëve; 1:10; Filipianëve 2:14-16)

T'i kthesh provat në triumfe (Jakobi 1:2-12)

Predikime dhe mësim të famshme deklarojnë se jeta e krishterë është pa probleme.

Megjithatë, po ta shohim këtë biblikisht, do të gjejmë se Perëndia është autori i «shërbesave të çuditshme.» Përmes këtyre shërbesave Perëndia bën që të gjitha gjërat të bashkëveprojnë për mirë. (Romakëve 8:28). Bekimet mund të jenë të mbështjella në rreca mallkimi. Dhimbja është një maskë pas së cilës fshihet gëzimi i vërtetë. Përmes provave, mundimeve dhe vuajtjes Perëndia dëshiron të plotësojë diçka që në mënyrë tjetër do të ishte e pamundur për jetën tonë. Perëndia nuk humbet kurrë kohë, por përgjigjet në kohën e duhur. Perëndia është Sovran. Është vetë Perëndia ai që e lejon për shkak të mëkatit dhe ndëshkimit. Pikërisht nën këtë dritë, të krishterët duhet t'i konsiderojnë vuajtjen dhe provat si më se të natyrshme dhe normale për jetët e tyre. Dallimi midis të qenët i lumtur a i mjerë nuk ka të bëjë me ekzistencën a mungesën e problemeve apo telasheve, por me qëndrimin tënd në këtë situatë.

Dy mënyra kundërpërgjigjeje ndaj provave

1. Mënyra e Perëndisë – kundërpërgjigje që përmbush shumë gjëra për mirë
2. Mënyra e Botës —kundërpërgjigje materialiste që çon në lëndime, hidhërimë dhe vdekje të parakohshme.

Prano që këto rrethana nuk janë vetëm rastësi; Perëndia është nën kontroll.

1. Vijnë prej Perëndisë.
2. Janë të mira.

Perëndia parashikon që:

1. Të kthehen në triumf
2. Viktimat të bëhen fitimtarë.
3. Kryqet të shndërrohen në kurora.
4. Vuajtja është për kuptimin e lavdisë.
5. Beteja vjen si mënyrë e fitores.


Jakobi 1:2 – Llogaritja
 1:3 – Dallon
 1:4,9 – Lejon
 1:5,6 – Kërkon

Katër elementë të domosdoshëm për të fituar mbi provat.

1. Qëndrim i gëzueshëm (v. 2)
2. Qëllim i kuptuar (v. 3)
3. Vullnet i nënshtruar (v. 4)
4. Zemër që beson (v. 6–8)

I. Llogarite gjithçka si gëzim: Një qëndrim i gëzueshëm.
 (Jakobi 1:2)

- A. Pamja e parë përcakton rezultatin. Qëndrimi përcakton veprimin.
- B. Provat priten të ndodhin. (v. 2; 1 Pjetrit 4:12)
- C. «Kur bini në tundime të ndryshme.» (v. 2b) Të gjithëfarëlojshme dhe gjithëngjyrëshe. (Shembull: Si në qepjen e një jorgani me shumë pjesë. Kur e kthen nga pjesa e brendshme sheh vetëm ngjyra të zbehta dhe të papëlqyeshme për syrin. Kur e sheh nga pjesa e jashtme e dukshme, është kaq e dëshirueshme në pamje, me modelin, ngjyrat dhe qëllimin të përmbushur. Po kështu edhe Perëndia i rregullon përvojat dhe ngjarjet e jetës sonë me qëllim që besimi ynë të rritet dhe forcohet).
- D. Vlerat përcaktojnë vlerësimin.
 1. Nëse dikush vlerëson më shumë rehatinë se karakterin, provat nuk do të jepen për të përmbushur qëllimin e Perëndisë.
 2. Nëse dikush vlerëson më shumë anën materiale dhe fizike se atë shpirtërore, do të ndjehesh i mjerë gjatë sprovave.
 3. Nëse dikush vlerëson më shumë të tashmen se të ardhmen, provat do të prodhojnë hidhërim se sa përmirësim.

- 
- II. Dallon: Qëllim të kuptuar. (Jakobi 1:3)
- A. Besimi provohet gjithmonë. Nëse kurrë nuk është vënë në provë, ndoshta mund të jetë një shenjë se asnjëherë s'ka pasur besim shpëtues.
 - B. Perëndia e provoi Abrahamin që ta bekonte dhe të forconte besimin e tij përmes të ushtruarit.
 1. Perëndia provon për të treguar më të mirën.
 2. Satani provon dhe tundon për të treguar më të keqen.
 - C. Provat punojnë për ne dhe jo kundër nesh. (Romakëve 8:28)
 - D. Provat e përdorura siç duhet na ndihmojnë që të piqemi në besim. (Romakëve 5:3,4)
 1. Qëllim, durim, rezistencë, përgatitje, këmbëngulje, përshtatje (ngrihu, fillo, vazhdo, mos ndalo, mbaroje garën.)
 2. Durimi nuk është pranim pasiv fatalist i rrethanave. Është këmbëngulje kurajoze përballë vuajtjes dhe vështirësisë.
 3. Padurimi dhe mosbesimi shkojnë gjithmonë bashkë. (Hebrenjve 6:12; 10:36; Isaia 28:16) III. Lejo: Vullnet i nënshtruar. (Jakobi 1:4) Perëndia nuk punon te ne nëse nuk e lejojmë. Nëse përballim provat pa pasur vullnet të nënshtruar, atëherë qëndrimi ynë do të jetë egoist, i dobët, i papjekur dhe i neveritshëm.
- IV. Kërko: Zemër që beson. (Jakobi 1:5,6)
- A. Për çfarë duhet të lutemi? Urtësi. (Pse jo forcë dhe hir?)
 - B. Njohuria është informacion. Urtësia është njohuri e zbatuar.
 - C. Kemi nevojë për urtësi që të mos humbasim mundësitë që Perëndia na jep për rritjen dhe të mirën tonë dhe për lavdinë e Tij.
 - D. Perëndia i lejon gjërat që ne të ndërtohem, ndërsa Satani i përdor për të na rrënuar.

Të luftosh dyshimin dhe shqetësimin

(Filipianëve 4:7; Galatasve 3:23; 1 Pjetrit 1:5)

1. Lejoje paqen e Perëndisë të derdhet si një ujëvarë ripërtëritëse në zemrën dhe jetën tënde. (Filipianëve 4:7)
2. Refuzo çdo shqetësim dhe dyshim. (Filipianëve 4:6; Jakobi 4:7)
3. Kujdesu për mendimet; mendo në mënyrë të pastër dhe të drejtë. (Filipianëve 4:8)
4. Fokusoji mendjen dhe sytë në Zotin dhe gjërat që vijnë prej Tij. (Isaia 26:3; Kolosianëve 3:1–3; Mateu 6:33)
5. Përdor armë të mbinatyrshme në të gjitha betejat e mbinatyrshme. (2 Korintasve 10:4–6)
6. Vish armaturën e Perëndisë. (Efesianëve 6:10–18)
7. Ec në besim! (Mateu 6:25–34; 7:7–11; 17:20; 21:22; Marku 11:22–24)
8. Ec në Frymë. (Galatasve 5:16–26; Romakëve 6:14–23; 8:1–13)
9. Mbështete sigurinë vetëm te Perëndia. (Hebrenjve 3:6,12–14;6:11,12; 10:19–23,35–39)
10. Hidhi të gjitha shqetësimet mbi Zotin. (1 Pjetrit 5:7)

Shpërblimi për vuajtjen e krishterë

(1 Pjetrit 4:13)

1. Lavdi në qiell. (2 Korintasve 4:17,18; 1 Pjetrit 5:1,10,11)
2. Shpëtim i përjetshëm. (2 Korintasve 1:7; Romakëve 8:17)
3. Krishti është bërë i njohur (2 Korintasve 4:11)
4. I kemi përkushtuar jetët tona për jetët e të tjerëve. (2 Korintasve 4:12)
5. Hiri i Perëndisë është shfaqur. (2 Korintasve 4:15)
6. Një garanci që Perëndia do të të gjykojë me drejtësi. (2 Thesalonikasve 1:4,5)
7. Do të mbretërosh me Të. (2 Timoteut 2:12a)
8. Fryma e lavdisë qëndron në Të. (1 Pjetrit 4:14)

9. Lavdia i është dhënë Perëndisë. (1 Pjetrit 4:16)
10. Arsye për gëzim. (1 Pjetrit 4:13,14)

**Shembulli i shtatëfishtë
i Krishtit për vuajtjen.**
(1 Pjetrit 2:21–24; 3:14–17)

1. Vuajtjet. (1 Pjetrit 2:21; Mateu16:24; 1 GJonit 2:6)
2. I Pamëkatë. (1 Pjetrit 2:22; Isaia 53:9)
3. I padjallëzuar (1 Pjetrit 2:22); Djallëzi.
4. Të duash kur të përqeshin. (1 Pjetrit 2:23; Isaia 53:7; Romakëve 5:3; 12:14; Mateu5:44–48; Jakobi 1:2–4)
5. Durim ndërsa kërcënohesh (1 Pjetrit 2:23; Romakëve 12:12; Luka 21:19)
6. Të heqësh dorë nga Perëndia. (1 Pjetrit 2:23; 4:19; Luka 23:46). I vendosur për kauzën e Tij; t'ia besosh Perëndisë.
7. Drejtësi (1 Pjetrit 2:24); I drejtë, I paanshëm, I saktë.

**Disa mësimë në përgatitjet për persekutimin;
këshilla për shërbëtorët dhe skllëverit.
Paralajmërimë biblike
për nëpunësit dhe punonjësit**

Efesianëve 6:5–8; Kolosianëve 3:22–25

1. Bindju padronit në çdo gjë. (Efesianëve 6:5; Kolosianëve 3:22)
2. I përgjegjshëm – me frikë dhe druajtje. (Efesianëve 6:5; Kolosianëve 3:22) Në gjithçka – të kesh druajtje nga Perëndia (jo në zgjedhjen e çfarë na pëlqen dhe çfarë jo; as të bëjmë atë që na pëlqen dhe të refuzojmë të kundërtën.)
3. Jo të shërbesh për t'u vënë re. (Efesianëve 6:6a; Kolosianëve 3:22c)
4. Të bësh vullnetin e Perëndisë. (Efesianëve 6:6c; Kolosianëve 3:22c)

5. Nga zemra. (Efesianëve 6:6d; Kolosianëve 3:22d) Me zemër plot.
6. Me vullnet të plotë – me gëzim dhe hare. (Efesianëve 6:7)
7. Nëse miratohet nga Zoti. (Efesianëve 6:8; Kolosianëve 3:24,25) Zoti do të ta shpërblejë. (Galatasve 6:7–9)

Titi 2:9,10

1. Ji i bindur ndaj padronit. (Titi 2:9a) Kënaqe me gjithçka. (Titi 2:9b)
2. Mos i kthe përgjigje! (Titi 2:9c) Mos e kundërshto; mos lejo që të bëjë figurë të keqe.
3. Mos vidh. (Titi 2:10) Mos grabit ose mos mashtro; si me kohën, me cilësinë e punës dhe as mjeshtërinë e zanatit. (Luka 16:10) Të tregosh përpikëri dhe besnikëri në të gjitha gjërat, qoftë të mëdha a të vogla. (Luka 16:10)


1 Pjetrit 2:18–20

1. Bëhu qytetar. (1 Pjetrit 2:18a) Respekto, ji i përgjegjshëm, përgjegjës, i nënshtruar, i kufizuar, i vënë nën pushtetin e autoritetit.
2. Me gjithë frikë. (1 Pjetrit 2:18b) të kesh respekt ose të pranosh pozitën e tjetrit.
3. Të vuash në mënyrë të padrejtë. (1 Pjetrit 2:19,20) me durim; jo të vësh në diskutim vuajtjen ose mundimin..
4. Ndiq shembulin e Krishtit. I thirrur për të ecur në gjurmët e Krishtit.(1 Pjetrit 2:21–23)

Natyra Shpirtërore e Betejës sonë.

(Efesianëve 6:12; 2 Korintasve 10:3,4)

Fitorja është jona vetëm përmes Krishtit. (Romakëve 8:32,37; 1 Korintasve 15:57). Është e vërtetë që në botë ka shumë beteja, dukshëm disfata, pengesa, dyer të mbyllura, dështime shpirtërore dhe sigurisht edhe vdekje. Sidoqoftë, më poshtë jepen disa parime që duhet t'i kemi parasysh për të pasur inkurajim:

- 
- I. Perëndia vazhdon t'i ketë gjërat nën kontroll me sovranitetin e Tij. (Isaia 40:15; Danieli 2:20–22; 4:35; Jobi 12:14–23; Psalmi 75:6,7; 76:10; Jeremia 27:5–7; Fjalët e urta 1:24–31; Hebrenjve 13:8)

 - II. Perëndia s'ka dështuar kurrë me premtimet e tij.
(2 Korintasve 1:20; 2 Pjetrit1:4)
Janë më shumë se shtatë mijë premtime në Bibël – çdonjëra i përgjigjet çdo nevoje të besimtarit. (Jozueu 21:45; 23:14; 1 Mbretërve 8:56; Hebrenjve 6:13–18; Veprat 7:5; 2 Peter 3:9. Premttime që kanë lidhje me këtë. Hebrenjve 2:3; Isaia 30:18; Psalmi 34:8; Fjalët e urta 16:20; Jeremia 17:7,8)

 - III. Fitorja është e sigurt për shkak të urdhrimit të Zotit.
Për çdo urdhërim që Zoti ka dhënë, bashkë me të ka dhënë hir të mjaftueshëm për ta kryer dhe përmbushur qëllimin deri në fund. (2 Korintasve 9:8; 12:9; Efesianëve 3:20)
Zoti ka premtuar për kishën e bindur:
 - A. Fuqinë e Tij – Autoritetin (Mateu28:18)
 - B. Praninë e Tij (Mateu 28:20)
 - C. Përgatitjen e Tij (Filipianëve 4:13–19)

 - IV. Fitorja është e bazuar edhe në ardhjen e dytë të Zotit
(2 Thesalonikasve 2:8)
Në lavdi me vetët. (Zbulesa 1:5–8; 19:11–16; Filipianëve 2:9–11; Efesianëve 1:19–22; Romakëve 16:18; 11:3–5; Jobi 4:3–9; Psalmi 91:14–16)

Nuk ka për të ndodhur këtu


1. Si reagueshan njerëzit ndaj mesazhit të Noes?
(Mateu 24:37–39)
2. Çfarë tha Pjetri kur Jezusi i tregoi se do të vuante dhe do të vdiste së shpejti? (Mateu 16:21,22)
3. Si e kundërshtoi Jezusi këtë? (Mateu 16:23)

4. Çfarë tha Jezusi në një rast tjetër në lidhje me vuajtjen që po afronte? (Mateu 26:31)
5. Si reagoi Pjetri? (Mateu 26:33–35)
6. Çfarë ndodhi kur gjithçka që ishte thënë u bë reale? (Mateu 26:69–75)
7. Pse e mohoi Pjetri besimin e tij?
8. A ishte rast unik ky i Pjetrit?
9. A njeh shembuj të tjerë kur njerëz të tjerë janë gjendur përballë situatave të njëjta?
Nga Bibla:
Nga diku në botë:
10. Çfarë thotë 1 Thesalonikasve 5:3 për besimin e njerëzve, që mbështetet në asgjë dhe kjo mund t'u thyejë sigurinë?
11. Pjetri duhej ta mësonte këtë gjatë jetës së tij me Krishtin. Shpjego diçka në lidhje me këtë shembull. (Mateu 14:29–31)
12. Duke e lejuar veten të drejtohej nga rrethanat, Loti bëri zgjedhjen e gabuar.
 - A. Cila ishte kjo zgjedhje? (Zanafilla 13:10,11)
 - B. Cili ishte rezultati? (Zanafilla 19:15–26)
 - C. Pse nuk mendoi Loti asnjëherë për shkatërrimin e pashmangshëm të Sodomës dhe Gomorrës?
 - D. Si reagueshan dhëndurët? (Zanafilla 19:14)
13. Çfarë i ndodhi papritur njeriut të pasur në shëmbëlltysin e treguar nga Jezusi? (Luka 12:16–21)
14. Çfarë thotë Zoti se duhet të bëjmë në kohë fatkeqësie dhe persekutimi? (Luka 21:8–28)

Parime Biblike për persekutimin

1. Sipas Gjoni 15:18–21, cila është arsyeja për persekutimin e të krishterëve?
2. Si u forcuan dishepujt nga Pali dhe Barnaba? (Veprat 14:22)
3. Kundër kujt ishte drejtuar në të vërtetë persekutimi? (Veprat 9:4,5)

4. Sipas 2 Timoteut 3:12, a është persekutimi i përshtatshëm, i papërshtatshëm apo i pashmangshëm?
5. Jep disa arsye pse shumë të krishterë e braktisin Krishtin. (Mateu 13:20,21)
6. Cilat janë ato tri gjëra që Krishti prët prej nesh te Mateu 16:24?
7. Cilat janë ato tri gjëra që Zoti u premtonte atyre që janë të përgatitur për persekutimin? (Mateu 5:10–12)
8. Premtimet e Perëndisë pothuajse gjithmonë shoqërohen me një kusht. Shembull: Zbulesa 3:20.
Cili është kushti?
Cili është premtimi?
9. Përmend të paktën tre tekste të ngjashme.
10. Çfarë kushti e shoqëron premtimin e Perëndisë dhënë Izraelit në Ligjin e Përtërirë 11:22
11. Kur mund të varemi në premtimet e Perëndinë ndërkohë që kemi nevojë për:
A. Paqe (Isaia 26:3)
B. Stabilitet politik (1 Timoteut 2:1–3)
12. Çfarë qëndrimi duhet të kemi kundrejt atyre që na persekutojnë?
A. Mateu 5:44
B. Luka 23:34
13. Cilat ishin reagimet e Pjetrit dhe Gjonit kur u rrahën për shkak të besimit të tyre? (Veprat 5:41)
14. Cili ishte konteksti i lutjes së dishepujve kur po persekutoheshin? (Veprat 4:23–30)
15. Ç“lloj vuajtjeje përmendet në Romakëve 8:35–39?
16. Çfarë thotë Bibla për fitoren në Romakëve 8:31–39?
17. Përmend të paktën tre vargje që tregojnë se të gjithë të krishterët do të persekutohen.
18. Edhe pse persekutimi dhe konflikti do të rritet, fitorja është e sigurt? Pse?
A njëh ndonjë varg (ose vargje) që e provon një gjë të tillë?
19. Çfarë duhet të bëjë çdo i krishterë që të jetë fitimtar? (Efesianëve 6:10–18)

- 
20. Cila pjesë e armatimit të mungon në shumicën e kohës në jetën tënde personale?
 21. A do doje të sillje një ndryshim? Specifikoj!
 22. Te Zbulesa 12:11, përmenden tri mënyra për të dalë fitimtar mbi Satanin. Cilat janë?





Përmbajtja

Të përgatitesh për Kishën e Fshtë,

nga Riçard Vurmbrand 3

Të vuash: Sakrifica e Hedonizmit të Krishterë,

nga Xhon Pajper 37

Parimet e Persekutimit: Për studim dhe njohje,

nga Milton Martin 77